

27 prilli
Dhunuesit
e Ziadin Selës
pranojnë fajin

Fq.5



PROGRAME
MËSIMORE
Libra të rinj
për shkencat
dhe etikën

Fq.4



Sakrificë
për Kupën
e Botës

MODRIÇ

Fq.22



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3387 · E martë, 12 qershor 2018

18°C | 32°C

15 DEN



KOHA për
kulturë

Fq.12-15

FORUM

E vogla...!



Edhe jeta me vrap e me shumë para është e mundimshme, por edhe ajo e ngadalta e e fukarasë është e mundimshme. Mere si t'a marësh, qenka betejë çdo gjë e gjithmonë! Edhe i pari edhe i dyti megjithatë kanë një gjë të përbashkët: mendojnë për të nesërmen! Ajo, e nesmja vjen pandalë! E si na gjen se...? Jeta e të parëve mundimin e ka tek fenomenin e shtimitë paraja shton parane dhe bëhet më e madhe se nevoja individuale e familjare, prandaj shndrohet në INSTITUCION që kërkon...

Fq.10

RAMAZAN

Shëmbëllyra
e Profetit
Muhamed

Fq.18

RAJON

Finlanda,
vendi i më
të lumturve
në botë

Fq.17

RAJON

Qeveria
e luksit

Fq.16



NË PRITJE TË BISEDËS TELEFONIKE MES KRYEMINISTRAVE

KUSH DO TA THOTË FJALËN E FUNDIT PËR EMRIN?



Siç shihet nga agjenda e dy kryeministrave, edhe pas bisedës telefonike mund të mos publikohet dakordimi për emrin, por vetëm vullneti për zgjidhje pozitive. Kjo mund të ndodh pas takimeve jozyrtare që do të kenë kryeministri Zaev në Gjermani me kancelarin Angela Merkel më datë 13 dhe 14 qershor. Po në të njëjtën kohë, shefi i diplomacisë greke, Nikos Koxias, do të jetë në Moskë në takim me kolegun e tij rus, Sergej Lavrov

Fq.3

Kompensimet më të larta se tatimi personal

Shkup, 11 qershor - Oda Ekonomike e Maqedonisë kërkon nga Qeveria racionalizimin apo edhe anulimin e së paku një pjese të pagesave parafiskale që nuk janë tatime. Nga shoqata më e madhe e bizneseve në vend kërkojnë së pari përpilimin e një Regjistri të saktë të kompensimeve parafiskale dhe pagesave të tjera jotatimore, si dhe analizën e arsyeshmërisë së tyre në nivel lokal dhe qendror sipas veprimtarive të

ndryshme. Duke arsyetuar nevojën e uljes apo edhe anulimit të një pjese të këtyre kompensimeve që shpesh nuk arsyetojnë pagesën e tyre, nga Oda Ekonomike thonë se kompensimet e tilla parafiskale të vlefshme 250 milionë euro, jo vetëm që rëndojnë biznes ambientin, por si shumë janë edhe më të larta se niveli i tatimeve më të rëndësishme në shteti, si tatimi personal dhe ai në fitim...

Fq.6



EDITORIAL

SHQIPTARËT
NË KANDARIN E
LUHATSHMËRIVE

Emin AZEMI

Kryeministri Zaev dje ishte në Haraçinë. Ai shoqërohej nga disa ministra të kabinetit të tij. Ishite edhe ambasadori i BE-së në Shkup, Samuel Zhbogar. Gjithë këta burra kishin shkuar për ta nderuar një zonjë, kryetaren e komunës së Haraçinës, e cila i kishte ftuar ata për të hedhur gurëthemelin e objektit të ri të Komunës, i cili do të financohet (260.000 euro) nga Bashkimi Evropian si pjesë e Programit për investime në Komunitat Rurale. Siç u tha programi administrohet nga Banka Botërore ndërsa implementohet nga Ministria e Financave.

Në fjalën e tij, me këtë rast solemn, kryeministri Zaev tha se "Haraçina ka luajtur rol serioz në ndërtimin e një shoqërie për të gjithë pasi të gjithë e pranojmë se kjo komunë bashkë me disa komuna tjera rurale ishin harruar në të kaluarën". Ai u shpreh se duam të kemi jetë cilësore pa dallim nëse jetojmë në komunat e qytetit apo ato rurale.

Ende nuk e dimë se çka do të ndikojë në "jetën cilësore" të banorëve ky objekt administrativ, kur dihet se komunat si godinë as prodhojnë diçka, as ndryshojnë ritmet e punës dhe biznesit në këtë rajon. Sigurisht që stafi i kryetares së Komunës do ta shijojë komfortin dhe në të ardhmen nuk do të kenë nevojë të ndihen keq se po punojnë në një objekt të djersit e rrëzbitur nga koha e pakujdesia. Kryeministri ka zgjedhur një rrugë të lehtë për t'i shpërblyer mbështetësit shqiptarë të partisë së tij, duke investu në objekte administrative, për çka edhe ka pasur nevojë, që përveç lojalitetit të ngushtë partiak nuk e dimë nëse do të prodhojë edhe ndonjë efekt më të gjerë për komunitetin. Kjo rrugë ka edhe efekt publicitare, teksa nxjerr në pah një fjalë të dhënë në fushatë parazgjedhore dhe tani, ku përpos në Haraçinë, duhet të përmbushet ajo fjalë për arsye se siç tha kryeministri "Haraçina ka luajtur rol serioz në ndërtimin e një shoqërie për të gjithë".

Nga segmente të caktuara të shoqërisë shqiptare në Maqedoni, politikanët maqedonas ende perceptohen si faktorizues dominantë, pa të cilët nuk ngrohë dielli në oborret e varfra të shqiptarëve, sidomos kur një objekt komune bëhet simbol i "rrafshimit të dallimeve", por me kusht që vota të shkojë për një parti që po "korrigjon" gjithçka që s'kanë mundur të bëjnë partitë shqiptare.

Në funksion të strategjisë për të zgjedhur gjoja midis shiut e breshrit, disa megafon dhe reprezentantë të shoqërisë civile, që zakonisht flasin njëfarë gjuhe të unitarizimit të tejkaluar maqedonas, ua kanë imponuar votuesve shqiptarë edhe një alternativë që shkon përtej kampusit elektoral shqiptar, duke e prezantuar LSDM-në

si ventilin e vetëm ku mund të shfryhen frustrimet dhe pakënaqësitë e shqiptarëve. Përpjekja për ta paraqitur shoqërinë shqiptare pa alternativë politike e civile, ndërkohë që ajo është prezente dhe shumë aktive, e bënë edhe më problematike marrëdhënien që mund të krijojë politika maqedonase me një pjesë të shqiptarëve, duke ua hequr atyre akrepat e orës politike. Nëse ndodhë kjo, atëherë tiktaku i kohëmatjes për një pjesë të shqiptarëve në të ardhmen mund të trokas në ndonjë sahatkullë të Strumicës a Vallandovës, ndërkohë që brirët e politikës shqiptare mund të thyejnë rekorde absurd të brendapërleshjes për do funksione që rehatojnë individë, por jo edhe shqiptarët. Këta të fundit kanë nevojë të faktorizohen përmes projekteve urbane, sociale, kulturore e ekonomike të përfaqësuesve legjitimë të tyre, e jo përmes sponsorizimeve jeniçere që impiantet parapolitike i paketojnë si "produkte vendore", paçka se etiketat e tyre mund të jenë shtypur që moti në ofiqin.

Në defektet e këtij keq-drejtimi kanë shumë faj edhe forcat kryesore politike shqiptare, të cilat me sjelljet dhe qëndrimet e tyre, jo rrallë kanë lajthitur edhe faktorin politik maqedonas, tek i cili kanë injektuar një lojalitet blanko për shumë çështje, e sidomos për çështje të karakterit ndëretnik.

Logjika e segmenteve të caktuara të politikës shqiptare në Maqedoni për të zaptuar një copë pushtet në oborrit e kryeministrit maqedonas, ende pa ndodhur faktorizimi i vërtetë i shqiptarëve, ka degjeneruar kuptimin e përfaqësimit dinjitoz- institucional të tyre. Gara për t'i nxjerrë syrin njeri tjetrit dhe vrapi për të siguruar sa më shumë vota në favor të partisë së Zaevit, i bënë një pjesë të shqiptarëve të Maqedonisë do fare kopje të zbehta të sanço-pançove pa brekë, të cilëve do t'ua kishte zili edhe Servantesi po të ishte gjallë. Perceptimi i vetvetes si oborrtarë të vegjël me ambicie të mëdha për përfitime personale, i bën aparatçikët e caktuar të shoqërisë shqiptare edhe më të lexueshëm para publikut shqiptar, sepse përvoja dhe memoria kolektive ka siguruar një minimum standard mbamendjeje sa për të dalluar sinqeritetin nga dallavera, interesin publik nga ai personal.

Urojmë që Haraçina të del nga projektimet e ngushta partiake dhe të frymojë më shpërlyer me projekte zhvillimore që jo patjetër duhet të jenë produkt i ndonjë premtimi parazgjedhor që kënaq nevojat e një grupi të vogël njerëzish. Fundja askush nuk ua ka ndaluar edhe partive shqiptare të bëjnë ndonjë punë të hairit në zonat rurale, atje ku luhatshmëria politike ende matet me peshën e thesit të miellit.

AUTOSTRADËN E MBYLLËN, PO 10 MILIONË TURISTËT KU DO KALOJNË?

"Autostradën e mbyllën. Po 10 milionë turistet nga malet si kaçake do kalojnë? Thonë që priten 10 milionë turistë në Shqipëri këtë vit. Autostradën Tiranë-Durrës e mbyllën këta 'strategët' e turizmit pikërisht në startin e sezonit turistik. E padëgjuar kjo bëmë e fundit e këtyre. Po këta 10 milionë turistet nga do ti bien për të dalë në det. Nga kodrat e nga malet i bie, se rrugë tjetër nuk ka. Po mijëra shqiptarëve që duan edhe ata të bëjnë pushime pse jua nxijnë jetën xhanëm. Po atyre që merren me biznesin e turizmit e që duhet të bëjnë furnizime e të presin turistet pse i torturojnë. Pse ja humbasin biznesit gjithë këto para, po ekonominë kombëtare pse e dëmtojnë. Janë të paafte dhe kaq. Presim tani dëgjuesën e radhës të kryeministrit shkollëpak që tu shpjegojë njerëzve se sa mirë është t'i bësh gropën turizmit. Fol kryeministër fol se e bërë edhe Shvejkun që të harrohet. Vërtet kryeministër s'ke asnjë faj se ty s'të duhet gjë për çfarë flet vet", shkruan në profilin e tij në Facebook, kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili.



GJITHA DEVIJIMET SHTETNDËRTUESE TË KOSOVËS

"Një fenomen, që pa dyshim është duke e përcjellë këmbakëmbës procesin shtetndërtimit të Kosovës, është edhe ai i teprisë së politizimit apo tendencës së 'ngjyrit', të çdo gjëje që prodhoi në ndërkohë jeta sociale dhe ajo politike në 'betejat' e konsolidimit të institucioneve shtetërore dhe ridefinimit të kauzave reja demokratike.

Kur flasim për politizimin, zakonisht mendja na shkon te perceptimi për humbjen e sensit dhe kohezionit tonë politik për të krijuar institucione kredibile, që po prodhon përveç sjelljeve të devijante (krim kulminant, anomie, konflikte ndërgrupore e brendainstitucionale, shtim të interesave klanore dhe zbehje të atyre publike, fatëpajtimi të çuditshëm dhe 'gjumë dogmatik' të publikut, kur janë në pyetje interesat e përgjithshme qytetare) edhe konflikte e skandale me afera të matshme... I gjithë ky proces i fillimit të vetëkërkimit të shkaqeve në rastin tonë kosovar, mund t'u adresohet shumë faktorëve: psh. shpërnguljes nga një zonë rurale në një zonë urbane, marginalizimit të grupeve të caktuara, deprivimit social, krizës morale, anonimitetit...etj. Por, në të njëjtën kohë është evident edhe antipodi i këtij fenomeni, ai i apolitizimit. I cili sipas një gjykimi ende të paprerë sociologjik, është duke u bërë edhe një ndër shkaqet e kësaj gjendjeje të tepruar të 'ngjyrosjes' me indiferencën e tepruar ndaj veprimeve të partive tona politike, për kauzat kombëtare.

Perceptimi kësaj qytetar që nënkupton jo gjithherë edhe qëndrimet e publikut të gjerë, ato të shoqërisë civile, e sidomos ca mediave mercenare, pa dyshim që ngjallë dyshime për shkallën e gatishmërisë së emancipimit tonë politik.

Sipas kësaj logjike që amë shumë na imponohet si perceptim, fitohet përshtypja që kujdestar kryesor për gjitha këto vonesa, e nëpërkëmbje të qarta të institucioneve tona sociale e politike, janë politikanët matrapaza që pushtetin e përdorën ekskluzivisht për interesat e veta personale, e klanore..., e jo për kauza nacionale dhe shtetndërtuese", shkruan në FB, sociologu Fadil Maloku.

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KUSH ISHIN CERNOJEVIQËT?

Cernojeviqët ishin familje feudale me prejardhje shqiptare më pas e sllavizuar. Zotërimet e saj shtriheshin në Zetë fillimisht midis Budues e Tivarit dhe erdhën duke u zgjeruar drejt Lindjes. Një nga pinjollët e saj, Radiqi, arriti t'u marrë më 1393 Dukagjinëve për pak kohë qytetin e Lezhës. Ai hyri në luftë me Gjergjin II Strazimiri Balshën dhe u thye e u vra prej tij më 1396. Në fillim të viteve 40 të shek.XV në krye

të familjes së Cernojeviqëve në Zetë u përforcua pushteti i Stefanit, i cili ishte martuar me të motrën e Skënderbeut, Marën. Duke u ndodhur para sulmeve osmane, ai u lidh me luftën e sundimtarëve shqiptarë me Skënderbeun në krye dhe mori pjesë në Kuvendin e Lezhës më 1444. Këto lidhje vazhduan edhe në kohën e pasardhësit të tij Ivan Cernojeviqit që ishte martuar me të bijën e Gjergj Arianitit.



Shqiptarë janë konstruktivë në bisedimet për çështjen e emrit

Shkup, 11 qershor - Ish-presidenti i Kroacisë, Stipe Mesiq, në një bisedë për Agjencinë e Lajmeve Zhurnal, ka folur për bisedimet midis Shkupit dhe Athinës rreth çështjes së emrit, rolin e faktorit politik shqiptar të Maqedonisë në këtë proces, si dhe për angazhimet e Qeverisë Zaev për të ndërtuar një shtet për të gjithë qytetarët e Maqedonisë. "Gjithnjë është mirë kur dy shtetet bisedojnë. Problemin të cilin e ka Greqia me emrin Kushtetues të Maqedonisë është zgjatur shumë. Duke i pasur parasysh zhvillimet e përgjithshme në nivel global, mendoj se në raportet ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe çelsi i stabilitetit brenda këtyre shteteve dhe stabiliteti i rajonit është zgjidhja e këtij kontesti. Zgjidhja është në duart e Shkupit dhe Athinës zyrtare. Megjithatë është shumë e rëndësishme të ketë mbështetje të fuqishme nga bashkësia ndërkombëtare, që ky kontest të zgjidhet dhe të jetë i pranueshëm për dyja palët. Sinqerisht, shpresoj se ky kontest do të zgjidhet, dhe se kjo do të ishte në favor të dyja vendeve, por edhe për gjithë rajonin, i cili duhet të ecë përpara në integrimet euroatlantike", thotë për Zhurnal, Mesiq. Sipas tij, edhe faktori politik shqiptar është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në bisedimet për çështjen e emrit dhe se po luan një rol konstruktiv. "Faktori politik shqiptar në Maqedoni, është i përfaqësuar në institucionet e Republikës së Maqedonisë, si dhe në Qeveri. Sa po e ndjek situatën, shoh se politikanët shqiptarë në Maqedoni luajnë një rol konstruktiv kur janë në pyetje bisedimet për çështjen e emrit me Greqinë. Nga ajo që po e përcjell situatën në bisedimet me Greqinë rreth çështjes së emrit është i kyçur edhe zv/kryeministri Bujar Osmani. Nëse mirë më kujtohet, ai për këtë çështje disa herë e ka vizituar Athinën. Qeveria e tanishme e Republikës së Maqedonisë e kryesuar nga kryeministri Zoran Zaev, po jep sinjale pozitive në raport me fqinjët, rajonin dhe bashkësinë ndërkombëtare", thekson Mesiq. Ai në bisedën për Zhurnal, konstaton se politikat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë udhëhiqen nga slogani "Qeveri për qytetarët" dhe "Një shtet për të gjithë" dhe këtu po shoh se po dominon koncepti shtetëror. "Maqedonia është shtet multi-etnik dhe këtu është shumë me rëndësi që të vendohet balansi ndëretnik dhe harmonia e bashkëjetesës, dhe se një bashkësi etnike nuk duhet fare të ndjehet e lënë pas dore, por as të jetë e privilegjuar. Në këtë drejtim është duke punuar Qeveria e tanishme e Maqedonisë, dhe më duhet të pranojë, se ka arritur përparim të madh historik", vlerëson Mesiq.

NË PRITJE TË BISEDËS TELEFONIKE MES KRYEMINISTRAVE

KUSH DO TA THOTË FJALËN E FUNDIT PËR EMRIN?

Siç shihet nga agjenda e dy kryeministrave, edhe pas bisedës telefonike mund të mos publikohet dakordimi për emrin, por vetëm vullneti për zgjidhje pozitive. Kjo mund të ndodh pas takimeve jozyrtare që do të kenë kryeministri Zaev në Gjermani me kancelarin Angela Merkel më datë 13 dhe 14 qershor. Po në të njëjtën kohë, shefi i diplomacisë greke, Nikos Koxias, do të jetë në Moskë në takim me kolegun e tij rus, Sergej Lavrov



Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 11 qershor - Opinioni vendor si në Maqedoni ashtu dhe në Greqi të hënën kanë qenë në pritje të telefonatës së shumëpërfolur për zgjidhjen e çështjes së emrit mes kryeministrit të Maqedonisë, Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras. Se telefonata do të ndodh të hënën kanë lajmëruar edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme greke. Nga Qeveria e Maqedonisë deri në orën 16 kanë thënë për gazetën KOHA se ende nuk ka marrë lajmërim nga Qeveria greke. "Deri në këtë orë nuk kemi ndonjë lajmërim nga Qeveria greke, por presim që të ndodh telefonata. Nëse do të ketë bisedë në telefon mes kryeministrave, do t'i njoftojmë për çka është biseduar", tha Mile Boshnjakovski, zëdhënës i Qeverisë.

"Dita e sotme është kritike për bisedimet për çështjen e emrit dhe biseda e shumëpritur telefonike mes kryeministrave Aleksis Cipras dhe Zoran Zaev do të ndodh sonte, konfirmoi të hënën ministri i Punëve të Jashtme greke, Nikos Koxias, pas daljes nga rezidenca kryeministore. Ai shtoi se 'sot do të jetë biseda'. Në pyetjen për përmbajtjen e bisedës, Koxias u përgjigj se atë duhet ta tregojnë dy kryeministrat. Siç shihet nga agjenda e dy kryeministrave, edhe pas bisedës telefonike mund të mos publikohet dakordimi për emrin. Kjo mund të ndodh pas takimeve jozyrtare që do të kenë kryeministri Zoran Zaev në Gjermani me kancelarin Angela Merkel më datë 13 dhe 14 qershor. Po në të njëjtën kohë, shefi i diplomacisë greke, Nikos Koxias, do të jetë në Moskë në takim me kolegun e tij rus, Sergej Lavrov. Ndërkaq të hënën paradite nga Komuna e Haraçinës kryeministri Zaev dha shpresë përsëri për zgjidhjen të shpejtë pozitive të çështjes së emrit.

"Çdoherë mbahen komunikime në nivel të Qeverisë për të gjetur zgjidhje. Pasi të kemi bisedë telefonike, do ta informoj opinionin. Besoj se bëhet fjalë për momentet e fundit që të afrojmë qëndrimet ku do ta kumtojmë bashkë lajmin e mirë për qytetarët e dyja vendeve se ka marrëveshje, pa-

staj kalojmë në sqarimin me presidentin e shtetit, shefin e opozitës, me çka qytetarët dhe institucionet do të jenë ato që do të sjellin vendime, pra qytetarët në referendum që maksimalisht të mbështesin këtë marrëveshje dhe të hapim rrugët drejt NATO-s dhe BE-së", ka thënë Zaevi.

Ndryshe gjatë vikendit, të dy vendet nëpërmjet këshilltarëve kanë biseduar për çështje të caktuara të cilat janë të hapura dhe kanë arritur zhvillim. Pala e Maqedonisë ofron "zgjidhje kreative", të cilët e mbrojnë identitetin dhe gjuhën e shtetit. Pas bisedimeve të këshilltarëve, kryeministri Zaev, shefi i diplomacisë, Nikolla Dimitrov dhe këshilltari Dane Taleski plotësisht janë konsultuar për qëndrim të unifikuar për çështjet të cilat ende janë të hapura. Ndryshe, sipas mediave greke, kryeministri Zoran Zaev dhe ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, ende nuk kanë harmonizuar qëndrimet rreth pakos së propozuar për emrin e shtetit. Por nga Qeveria e Maqedonisë menjëherë i kanë hedhur poshtë këto zëra. Ministrin Nikolla Dimitrov e kanë shënjestruar me kritika të hënën edhe nga VMRO, konkretisht ish-ministri i Punëve të Jashtme, Antonio Milloshovski. Milloshovski ka theksuar se ministri i Jashtëm tanimë kërkon pozitë të re në Kombet e Bashkuara, në fakt sipas Milloshovskit, Nikolla Dimitrov nuk dëshiron ta mbarojë mandatin e tij si shef i diplomaci-

së maqedonase.

"Nuk e di nëse karriera e Nikolla Dimitrovit është në 'vijë të njëjtë' me atë të Zaevit, e cila varet kryesisht nga zgjidhja e çështjes së emrit. Por diplomatë nga Kombet e Bashkuara njoftojnë se ministri na plan afatgjatë nuk e sheh perspektivën e tij në Republikën e Maqedonisë. Megjithatë, koha do tregojë", shkruan Milloshovski në profilin tij në Facebook.

Nga ana tjetër, nga opozita greke nuk lëshojnë pe ndaj qëndrimeve të forta kundër përdorimit të nocionit "Maqedoni" më ermin e shtetit fqinj. Me këtë rast, kryeministri grek, Aleksis Cipras nuk arriti të sigurojë mbështetje nga lideri i opozitës greke për konsensus rreth negociatave të intensifikuara për emrin. "Nuk do ti ndajmë grekët për ta bashkuar Shkupin", deklaroi lideri i Demokracisë së Re, Kirijakos Mico-takis pas takimit me kryeministrin Cipras. Ai shtoi se zgjidhja për emrin nuk është vetëm çështje e politikës së jashtme, por është çështje serioze e lidhur me historinë greke dhe për "identitetin e grekëve". Mico-takis, i cili për momentin është në krye të partisë që ka mbështetje më të madhe nga qytetarët, e akuzoi Ciprasin për atë se nuk ka kërkuar nga Shkupi ndryshimi kushtetues si "kusht i domosdoshëm" për çfarëdo negociatave. Ai, gjithashtu porositi se dritarja për zgjidhje të mundshme është e mbyllur.

DEMOKRACIA E RE TË TREGOJË PËR CILAT EMRA ËSHTË DAKORDUAR NË TË KALUARËN

Demokracia e Re të tregojë cilat emra i ka propozuar në negociatat në të kaluarën dhe me të cilat tani pajtohet, kërkojnë nga Qeveria greke në përgjigje në deklaratën e zëdhënësës të partisë opozitare e cila e akuzoi për diplomaci të fshehtë. "Mbase Spirali është aq e shqetësuar për "diplomacinë e fshehtë", është koha të tregojë cilat emra i ka propozuar Demokracia e Re kur ka negociuar me IRJM-në? Dhe e cilin emër nga këto dakordohet sot?, komenton

zëdhënësi i Qeverisë greke dhe ministër pa portofol", Dimitris Xanakopoulos në deklaratën me shkrim. Siç lajmëroi paraprakisht korrespondentja e MIA-s nga Athina, nga Demokracia e Re opozitare, përmes zëdhënësës Maria Spirali e akuzon Qeverinë për diplomaci të fshehtë dhe se i mban qytetarët në errësirë dhe ka kërkuar që Ciprasi urgjentisht ta njoftojë Parlamentin për ngjarjet e fundit në bisedimet për emrin.

Deputetët do të duhet t'i përmbahen rregullave të reja të komunikimit, parimeve themelore të etikës, të kryejnë funksionin pa diskriminim, të udhëhequr nga interesi publik dhe të respektojnë personalitetin e çdo individi. E kundërta ka ndodhur në seancën e radhës, ku nuk kanë mundur replikat ofenduese mes deputetëve të mazhorancës dhe opozitës

Koha Evis HALILI

Shkup, 11 qershor - Me miratimin e Kodit të Etikës në seancën e së hënës në Parlament, deputetët do të duhet t'i përmbahen rregullave të reja të komunikimit dhe veprimt brenda institucionit, sipas rregullave të reja të shkruara. Qëllimi i Kodeksit është të ruajë dhe afirmojë dinjitetin dhe reputacionin e Parlamentit dhe të vetë deputetëve, por edhe të rrisë besimin e qytetarëve në vlerat themelore dhe integritetin e detyrës së deputetit.

E kundërta ka ndodhur në seancën e radhës ku nuk kanë mundur replikat ofenduese mes deputetëve të mazhorancës dhe opozitës. Kreu i Parlamentit Talat Xhaferi pas miratimit të Kodeksit i është drejtuar deputetëve duke thënë se në të ardhmen shpreson që diskutime të tilla si të kësaj seancë

SEANCË E PARLAMENTIT

DEPUTETËT NXJERRIN "LIBRIN E SHTËPISË" PËR KODIN ETIK



ce pa etike të mos përsëriten. Replikat ofenduese kanë nisur pas fjalës së mbajtur nga deputeti i LSDM, Tomosllav Tuntev dhe krahasimit të bërë prej tij kur ligjet miratoheshin në kohën e VMRO-DPMNE me procedura të përshtetura. "Ky është një hap i madh, pasi që nuk mund të presim nga askush që të respektojë institucionin e deputetit ose Parlamentit, në rast se me sjelljen e tyre vetë de-

putetët nuk e demonstrojnë se janë të denjë për respekt dhe nuk e dëshmojnë se arrijmë që t'i vëmë në zbatim vlerat universale nga aspekti moral, etik, profesional...", ka thënë Tuntev. Por sipas Dragan Danev, nga VMRO-DPMNE, Kodeksi etik nuk mund të rregullojë sjelljen e një deputeti, pasi sjellja varet nga formimi dhe kultura e tij.

"Me këtë Kodeks duhet të parandalohet gjuha e urrejtjes, për

shkak të së cilës në Parlament ndodhën shumë gjëra që nuk duhej të ndodhnin. Por paskam besuar kot se me këtë kodeks do të ndryshojë sjellja e deputetëve të VMRO-DPMNE", ka thënë Tuntev. Ndërsa deputeti i Bashkimit Demokratik për Integritim, Artan Grubi ka kërkuar që konsensusi i arritur gjatë përgatitjes së kodeksit të vazhdojë edhe gjatë miratimit të Rregullores, ligjeve të tjera dhe për

Planin 18-të të Qeverisë. Sipas Kodeksit, deputeti nuk duhet të ndërpresë deputetin në foltore, të japë komente nga vendi ose në çfarëdo lloj mënyre të ngjashme të devijojë rrjedhën e seancës. Po ashtu i ndalohet artikulumit i frazave dhe gjeesteve që ofendojnë deputetë ose bartës të funksioneve publike, nxisin urrejtjen, ndërsa detyrën duhet ta kryejë pa paragjykitime dhe diskriminim në bazë të gjinisë, racës, bindjeve politike dhe fetare, pozicionit shoqëror, duke respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut.

Për marrjen e masave në rastet e shkeljeve do të veprojë Komisioni për çështjet e mandateve dhe imunitetit, ku mes të tjerash kodeksi parashikon vërejtje për shkeljet e lehta dhe vërejtje publike për shkeljet e rënda.

Gjatë seancës parlamentare po ashtu u miratuan edhe vendimi për dërgimin e një përfaqësuesi të ARM në operacionin paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara "UNIFIL" në Liban, si dhe ligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës.

BZHA KA NDRYSHUAR DISA PROGRAME MËSIMORE

Libra të rinj për shkencat dhe etikën

Për momentin, nuk paralajmërohen ndryshime për lëndët e Historisë, Gjeografisë apo Arteve për arsimin e mesëm, librat e të cilëve janë kontestuese sidomos për shqiptarët për shkak të përmbajtjeve fyese

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 11 qershor - Për një javë resht, duke filluar nga sot - profesorë universitarë, ata të shkollave të mesme dhe të shkollave fillore mund të paraqiten për pjesëmarrje në komisionet që do të formojë Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) për ndryshimin e teksteve shkollore. Në thirrjen publike që MASH ka bërë me këtë rast, bëhet e ditur se komisionet do të formohen enkas për librat e Shkencave natyrore për klasat V dhe VI, Biologjinë e vitit të parë të arsimit gjimnaz, si dhe për Etikën për vitin III të arsimit gjimnaz si lëndë zgjedhore. MASH kërkon të marrë mendim nga profesorët e lëndëve përkatëse edhe atë nga të gjitha nivelet e shkollimit, pasi bëhet fjalë për ndryshimin e më tepër se 30 për qind të programeve mësimore të atyre lëndëve e të cilët

janë në proces të ndryshimit.

Për momentin, nuk paralajmërohen ndryshime për lëndët e Historisë, Gjeografisë apo Arteve për arsimin e mesëm, librat e të cilëve janë kontestuese sidomos për shqiptarët për shkak të përmbajtjeve fyese. Në MASH thonë se janë duke punuar edhe në këtë drejtim, pra të shqyrtimit të mundësive për korrigjimin edhe të këtyre librave, mirëpo vërejnë se për këtë duhet që paraprakisht të ndryshojnë programet mësimore përkatëse nga ana e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA). Kjo e fundit, si shërbim profesional për çështjen e programeve mësimore, i ka dërguar MASH-it javë më parë informacionin mbi ndryshimin e programeve mësimore për lëndën e Biologjisë, Shkencave natyrore dhe Etikës. Me këtë është hapur edhe rruga për vijimin e procesit, respektivisht për përgatitjen e thirrjes publike për

pjesëmarrje në Komision për dhënin e mendimeve për ndryshimin e 30 për qind të përmbajtjes së teksteve shkollore në lëndët e lartpërmendura, sikurse është e caktuar me Ligj. Në nenin 14 të Ligjit për tekste shkollore thuhet se "gjatë miratimit të Plan-programit të ri mësimor, ose nëse bëhet ndryshimi apo plotësimi i më shumë se 30 për qind e plan-programit mësimor, Shërbim pedagogjik shpall konkurs për libër të ri shkollor për lëndën përkatëse". Konkursi për libër të ri shpallet edhe për qëllime të ngritjes së cilësisë. Në alinenë 2 të po këtij neni thuhet se "për ngritjen permanent të cilësisë dhe modernizimit të librit shkollor të lejuar, pas përdorimit pesëvjeçar të librit nga botimi i parë, Shërbim Pedagogjik mund të shpallë konkurs të ri, sipas mendimit paraprak të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, Qendrës për Arsim dhe Aftë-



sim Profesional apo Qendrës për Arsimin e të Rriturve". Shërbimi Pedagogjik, sikurse definohet me Ligj, menaxhon anën teknike të botimit të librave të rinj, për dallim prej BZHA-së, e cila ka në kompetenca të veta çështje profesionale. Sakaq, roli i MASH-it sikurse dihet është politik. Në rastin konkret, të gjitha iniciativat për ndryshimin e programeve mësimore e për pasojë edhe të teksteve shkollore, nuk mund të nisin pa marrë dritë të gjelbër nga ministri i Arsimit. Formimi i Komisioneve për dhënin e mendimit lidhur me ndryshimin e teksteve shkollore konsi-

derohet i rëndësishëm pasi konstruksioni i librave do të varet pikërisht nga mendimet, sugjerimet dhe vërejtjet që do të japin anëtarët e komisioneve, në këtë rast mësimdhënësit e ftuar për pjesëmarrje në ato komisione.

Deri vitin e ardhshëm shkollor, ka shumë gjasa që përveç teksteve të reja shkollore nga Biologjia (viti i parë gjimnaz), Etika (viti i tretë) dhe Shkencat shoqërore (klasa V dhe VI) nxënësit të kenë tekste të reja në lëndët e Shoqërisë (IV), Informatikës (V), Gjeografisë (VII, VIII dhe IX) si dhe gjuhëve të huaja në arsimin e mesëm.

TË MËRKURËN EDHE NJË VENDIM PËR 27 PRILLIN



DHUNUESIT E SELËS PRANOJNË FAJIN

Dy të akuzuarit Gjorgjevski dhe Pavlleviski, të cilët paraprakisht ishin të akuzuar për veprën penale "tentim-vrasje" e tani për vepër "dhunë", para Trupit gjykues u shprehën se në tërësi pranojnë aktakuzën, ndërsa ndjehen fajtor për sulmin ndaj Selës dhe deputetëve tjerë

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 11 qershor - Rikualifikimi i aktakuzës në rastin Sela ndikoi që dy prej nëntë të akuzuarve ta pranojnë fajin për dhunën e ushtruar ndaj kreut të Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela. Ceo Gjorgjevski dhe Stojan Pavlleviski, të hënën në Gjykatën Penale të Shkupit u shprehën se ndihen fajtor për veprën e kryer dhe në tërësi i pranojnë detajet e përshkruara në propozim-akuzën e re. Veprimet dhe sulmin ndaj Selës në prill të vitit të kaluar, brenda hapësirës së Kuvendit të Maqedonisë, të dy të akuzuarit thanë se i kanë ndërmarrë në afekt të agresivitet dhe nervozes.

"Mendoj se u bë gjithçka e qartë me videon, e cila u prezantua nga prokuroria. Ndihem fajtor për veprën e kryer dhe e pranoj akuzën", tha i akuzuari Pavlleviski. Përdërisa ai dhe Gjorgjevski u deklarorin se janë fajtor për veprën penale "dhunë", gjykatësja Sllavica Andreevska i pyeti se pranimin e fajit e bëjnë vullnetarisht. Ajo po ashtu ua kujtoj për pasojat që mund t'i bar-

tin pas pranimit dhe shqiptimi të dënimit.

"Besoj se jeni të vetëdijshëm se me pranimin e fajit ju realisht pranoni edhe dëshmëpërblimin e kërkuar nga pala e dëmtuara. Duhet ta dini se të drejtë të ankesës mund të shfrytëzoni vetëm për lartësinë e dënimit, por jo edhe për përmbajtjen e akuzës. Mendoj se kjo çështje u është sqaruar nga avokatët e juaj", tha gjykatësja Andreevska. Dy të akuzuarit Gjorgjevski dhe Pavlleviski, të cilat paraprakisht ishin të akuzuar për veprën penale "tentim-vrasje" e tash për veprën "dhunë", para Trupit gjykues në GJPSH-së u shprehën se janë koshient për pasojat e pranimit të fajit, megjithatë ky është realiteti.

Plotësimin e akuzës në rastin Sela, prokurori Darko Jakimovski paraprakisht e arsyetoi se analiza dhe hetime shtesë mbi këtë lëndë, ndërsa kanë vërtetuar se Gjorgjevski dhe Pavlleviski, nuk kanë ndërmarrë hapa që e vërtetojnë akuzën për "vrasje".

Megjithatë, ai në fjalët përfundimtare për këta dy të akuzuar kërkoi shqiptimin e

dënimit me burg. "Nuk kontestohet fakti se për veprën që akuzohen dy persona e apostrofuat lartësia e dënimit është nga gjashtë muaj deri në pesë vite burg me mundësi për sanksionet alternative, siç është dënimi me kusht. Vlerësoj se dënimi me kusht në këtë rast do të ishte banalizim i gjithë peshës që e ka ky rast. Nëse në këtë mënyrë futen personat në Parlament dhe sulmojnë, parashtrahet pyetja a ekziston ndonjë objekt tjetër apo vend i cili është më i mbrojtur se ky", tha prokurori Jakimovski. Mes tjerash, ai theksoi se i akuzuari Pavlleviski është personi i parë që kalon kordonin e policisë dhe futet në sallën e shtypit në Parlament. Sjellja e dhunshme e të dy të akuzuarve, ai theksoi se është vërtetuar me dëshmitë e prezantuar në procedurën e deritanishme, gjegjësisht veprimet e dhunshme ato nuk i kanë ndërmarrë vetëm ndaj Ziadin Selës, por edhe ndaj të tjerë. Shqiptimi i llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit Ceo Gjorgjevski dhe Stojan Pavlleviski pritet të publikohet të mërkurën.

NINXHA I 27 PRILLIT DORËZOHET NË SHUTKË

Aleskanda Vasilevski-Ninxha, njëri ndër të akuzuarit kryesor për ngjarjet e 27 prillit të vitit të kaluar, pas gjatë muajve në arrati, të hënën është dorëzuar në polici dhe më pas me automatizëm është dorëzuar në Shutkë. Paraprakisht, policia arriti ta arrestoj edhe Mlladen Dodevskin, i cili ishte në arrati një kohë të gjatë. Aksioni policor i 28 nëntorit të vitit të kaluar nuk u realizua me sukses, gjegjësisht deri sot Ninxha dhe shokët që u

arrestuan kohë më parë, kanë qenë në arrati. Prokuroria për krim të organizuar 34 të akuzuar për 27 prillit i ngarkon për vepër penale "terrorizëm". Emri i Ninxhës, siç raportonin mediat maqedonase, lidhej edhe me arratinë e Goran Grujoskit dhe Nikolla Boshkoskit drejtë Greqisë. Sipas të dhënave të MPB-së, të akuzuar tjerë që nuk janë të kapshëm për policinë janë Dejan Davidovski dhe Mitre Pitropovski.

KRONIKË

Zhduket një grua në Kumanovë, familja kërkon ndihmë

Jagoda Serafimovska (66) nga Kumanova dje në orët e hershme të mëngjesit ka dalë nga Shtëpia për persona të moshuar "Zafir Sajto" në Kumanovë ku ka qëndruar. Familja e Serafimovskës kërkoi ndihmë nga qytetarët nëse e vërejnë ta paraqesin në stacionin e policisë ose të paraqiten në numrat e telefonit 078/334-392, 078/334-372. Gruaja e zhdukur ka probleme shëndetësore. Nga MPB-ja konfirmojnë se personi është denoncuar gjatë ditës së djeshme nga ana e kumanovarit S.S. Policia ndërmerr masa për gjetjen e personit. Përgjegjësit nga Shtëpia e Pleqve thonë se edhe ata ndërmarrin masa për gjetjen e gruas.

52-vjeçari i Llogovardit digjet nga zjarri

D.G (52) nga fshati Llogovardi, të Manastirit në mëngjesin e djeshëm e ka humbur jetën pasi në shtëpinë e, tij ka shpërthyer zjarr. Siç kumtoi MPB, nga zjarri që ka shpërthyer në orën 05.40 plotësisht është djegur edhe shtëpia. Zjarri është shuar nga ekipe të Njësisë Zjarrfikëse.

Gjendet 29-vjeçari i vdekur në një objekt në ndërtim në Shkup

Një trup i pajetë i V.C. (29) nga fshati Kosharë, Kriva Pallankë, është gjetur në një objekt ndërtimi në rrugën "Lublanska" në Shkup. Siç kumtoi MPB, rasti është denoncuar dje në orën 14.30 në Stacionin Policor Karposht nga ana e Ndihsës së shpejtë mjekësore. V.C. ka qenë i punësuar në firmën e cila ka kryer punime ndërtimore në objekt, ndërsa ka vdekur nga goditja elektrike derisa e ka komanduar vinçin. Trupi i V.C. është dorëzuar për autopsi.

Tre persona rrahin 21-vjeçarin

Të dielën mbrëma rreth orës 22, personi me initiale A.A. 21 vjeçar nga fshati Senakos i Gostivarit, ka paraqitur se derisa ka qëndruar ulur në ulësen afër shkollës fillore të fshatit, afër tij janë afruar personat A.K. I.Xh. dhe A.R. të gjithë nga fshati Senakos, ku pa asnjë shkak apo arsye, e kanë sulmuar duke e grushtuar dhe shkëlluar në pjesët e trupit dhe kokës derisa ka humbur vetëdijen. Janë duke u marrë të gjitha masat dhe aktivitetet për gjetjen e sulmuesve dhe zbardhjen e plotë të rastit. (U.H)

Shkup, 27 të lënduar në 15 aksidente

Shkup, 11 qershor - Njëzet e shtatë persona janë lënduar, prej të cilëve dy më rëndë në 15 fatkeqësi që ndodhën gjatë fundjavës në rajonin e Shkupit. Në shtatë fatkeqësi komunikacioni është shkaktuar dëm material. Më shpejtë se shpejtësia e lejuar kanë vozitur 200 shoferë, ndërsa 82 kanë vozitur nën ndikim të alkoolit. Janë përjashtuar

nga komunikacioni edhe 68 vozitës para se të përfitohen me të drejtën e patentë shoferit dhe nëntë vozitës fillestarë. Sipas buletinit të SPB-Shkup, gjatë fundjavës janë përjashtuar nga komunikacioni edhe 59 vozitës me patentë shofer të skaduar dhe 21 automjete të peregjistruara. Në mënyrë të parregullt të parkuar kanë qenë 208 vo-

zitet, ndërsa me automjetin e posaçëm janë mënjeluar 110 automjete. Njëmbëdhjetë vozitës kanë kaluar në dritë të kuqe në udhëkryq, ndërsa 43 kanë folur në telefon celular gjatë vozitjes. Sa i përket këmbësorëve si pjesëmarrës në komunikacion, gjatë fundjavës 22 kanë kaluar jashtë vendkalimeve për këmbësorë.

Në Maqedoni shkelen të drejtat sindikale

Bruksel, 11 qershor - Konfederata Ndërkombëtare e sindikatave në raportin e saj të fundit për shkeljen e të drejtave sindikale në botë, thekson se në Maqedoni "rregullisht shkelen" të drejtat e punëtorëve. Rezultatet e Indeksit për vitin 2018 për shkeljen e të drejtave sindikale, të përgatitur nga Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave, janë globalisht shqetësuese në gjithë botën dhe se "hapësira demokratike gjithkund po ngushtohet". Në Evropë, tre e katërta e shteteve e kanë shkelur të drejtën e grevës, ndërsa në Itali, punëtorët ishin të ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe kërcënimeve. Maqedonia bën pjesë në grupin e tretë ku "rregullisht shkelen" të drejtat e punëtorëve, së bashku me Shqipërinë, Bullgarinë, Gjeorgjinë, Moldavinë, Poloninë, Rusinë, Spanjën dhe Britaninë e Madhe. Maqedonia është renditur më keq se sa në vitet e kaluara, ndërsa në raportin theksohet se Qeveria "vazhdimisht refuzon të negociojë për marrëveshjen e përgjithshme kolektive për sektorin publik". Greqia fqinje është në mesin e vendeve më keq të renditura e kualifikuar si shtet "pa të drejta të garantuara për punëtorët", në një grup me Bjellorusinë dhe Ukrainën. Shumica e vendeve të BE-së janë në grupin e parë ku shkelja e të drejtave sindikale janë "sporadike".

Për një muaj, 249 leje për ndërtim

Shkup, 11 qershor - Në muajin prill të këtij viti janë dhënë 249 leje për ndërtim, që është për 3.9 për qind më pak në krahasim me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, publikoi Enti Shtetëror për Statistikë. Sipas lejeve të dhëna për ndërtim, vlera e parashikuar e objekteve arrin 6.214.781 mijë denarë, që është për 73.3 për qind më shumë në krahasim me muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Nga numri i tërësishëm i lejeve të dhëna për ndërtim 134 ose 53.8 për qind janë destinuar për objektet e ndërtimit të lartë, 44 ose 17.7 për qind për objektet e ndërtimit të ulët dhe 71 për qind ose 28.5 për qind për objektet për rikonstruim. Prej gjithsej 249 objekteve, te 161 ose 64.7 për qind si investitorë paraqiten persona fizikë, ndërsa në 88 ose 35.3 për qind objekte investitorë janë subjektet afariste. Në periudhën raportuese është parashikuar ndërtimi i 965 banesave, me sipërfaqe të tërësishme prej 62.340 m².

VIHET GURTHEMELI I PIKËS KUFITARE BELLANOC-STANÇIÇ

Kumanovë, 11 qershor - Është vendosur gurthemeli i pikës kufitare Bellanoc-Stançiç, pikë kjo që lidh Republikën e Maqedonisë me Republikën e Kosovës. Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë kryetari i Komunës së Likovës, Erkan Arifi, ministri i Ekologjisë, Sadul-

la Duraki, ambasadori i BE-së në Shkup, Samuel Zhbogar si dhe zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani nga ana e Maqedonisë, ndërkohë që nga Kosova pjesë ka marrë zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, si dhe kryetari i Gjilanit, Lutfi Hazi-

ri. Vendkalimi kufitar në Bellanoc ka kohë që pritët nga banorët e Komunës së Likovës, ashtu sikurse banorët e Gjilanit, ndërkohë që tashmë rruga është e asfaltuar në të dyja anët e kufirit. Nuk dihet saktësisht se kur do të përfundojnë punimet,

BIZNESI KËRKON RISHQYRTIMIN E PAGESAVE PARAFISKALE

KOMPENSIMET MË TË LARTA SE TATIMI PERSONAL

Kompensimet e tilla të vlefshme 250 milionë euro jo vetëm që rëndojnë biznes ambientin, por edhe si shumë-ato janë edhe më të larta mëdha se niveli i tatimeve më të rëndësishme në shtet, si tatimi personal dhe ai në fitim



Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 11 qershor - Oda Ekonomike e Maqedonisë kërkon nga Qeveria racionalizimin apo edhe anulimin e së paku një pjesë të pagesave parafiskale që nuk janë tatime. Nga shoqata më e madhe e bizneseve në vend kërkojnë së pari përpilimin e një Regjistri të saktë të kompensimeve parafiskale dhe pagesave të tjera jotatimore, si dhe analizën e arsyeshmërisë së tyre në nivel lokal dhe qendror sipas veprimtarive të ndryshme. Duke arsyetuar nevojën e uljes apo edhe anulimit të një pjesë të këtyre kompensimeve që shpesh nuk arsyetojnë pagesën e tyre, nga Oda Ekonomike thonë se kompensimet e tilla parafiskale të vlefshme 250 milionë euro, jo vetëm që rëndojnë biznes ambientin, por si shumë janë edhe më të larta se niveli i tatimeve më të rëndësishme në shtet, si tatimi personal dhe ai në fitim.

"Në vitin 2016, në totalin e pagesave në arkën e shtetit, pagesat e tilla marrin pjesë me 14 për qind që si shumë është më e madhe se vlera e tatimit personal prej 12 për qind dhe vlera e tatimit në fitim prej 9 për qind të paguar në arkën e shtetit. Nga ana tjetër, kjo shifër është afër shumës së akcizave prej 20 për qind që paguhet në arkën e shtetit. Këto kompensime që kanë trend në rritjes vitet e fundit, nuk ndih-

mojnë as krijimin e një biznesi ambientin të favorshëm për kompanitë dhe rritjen e investimeve vendore dhe të huaja. Andaj, ne kërkojmë së pari vendosjen e një Regjistri të këtyre kompensimeve për shkak se askush në shtet nuk ka një pasqyrë të qartë të pagesës së tyre, si dhe analizë të arsyeshmërisë së tyre në nivel lokal dhe qendror", thotë Aneta Trajkovska nga Oda Ekonomike e Maqedonisë.

Sipas saj, anulimi i një pjesë të këtyre kompensimeve dhe racionalizimi i tyre nuk është proces që mund të ndodh brenda nate, sepse një pjesë e tyre ndoshta edhe duhet të paguhet.

Megjithatë, nga Oda Ekonomike e Maqedonisë theksojnë se edhe zyrtarisht, para Qeverisë kanë ngritur iniciativë që në kuadër të reformave të paralajmëruara tatimore, të përfshihen edhe kompensimet parafiskale dhe jotatimore.

"Sistemi tatimor në Maqedoni ofron një hapësirë të pakufizuar që përmes akteve të ndryshme nënligjore, vendimeve të Këshillave Drejtues dhe mënyrave të ngjashme ligjore të vendosjen kompensime të ndryshme që vështirë kontrollohen. Andaj, edhe Ministria e Financave nuk mund të ketë një pasqyrë dhe kontroll të plotë ndaj këtij sistemi. Për këtë shkak, nevojitet që së pari sistemi i tenderëve publik të jetë më shumë i kontrolluar dhe

nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave, si dhe nevojitet që me Ligjin për të ardhurat dhe harxhimet publike të gjitha kompensimet shtesë që llogariten si të ardhura vetanake, në të ardhmen të llogariten si të ardhura në buxhet", thekson më tek Trajkovska.

Në ndërkohë, edhe anketa e fundit e Odës Ekonomike e Maqedonisë ka treguar se kompensimet e shumta parafiskale për shërbimet publike që nuk janë tatime, vështirësojnë punën e biznesit që lufton me pagesën e pagave, borxheve të ndryshme ndaj shtetit dhe partnerëve afarist. Harxhimet e tilla jashtë tatimeve që shpesh edhe nuk kanë kuptim, ose biznesi nuk fiton kompensim të vërtetë për pagesën e kryer, ngarkojnë kompanitë edhe me harxhime shtesë. Ato paguhet në nivele të ndryshme të administratës si kompensime për vendosjen e emrit të firmës, harxhime për pjesëmarrje në tenderë... Përkundër faktit se tatimet në Maqedoni për biznesin janë të ulëta, megjithatë mjaft kompensime i shkaktojnë harxhime të mëdha biznesit dhe e ngufasin punën e tij të përditshme. Ndër kompensimet e ndryshme jashtë tatimeve janë edhe kompensimet që vendosen nga pushteti lokal, nga Këshillat drejtues të agjencive apo ndërmarrjeve publike, si taksat e ndryshme komunale, administrative dhe gjyqësore etj.



megjithëse ka garanca se ditën do të hapet edhe vendkalimi kufitar punimet të kenë përfunduar, fitar.

Zaevi premtoi edhe rritjen e pagave për motivim shtesë në punë, për të shtuar se deri në vitin 2020, pagat e mjekëve specialistë do të rriten shkallë-shkallë, për të arritur në 100.000 denarë, ose 1600 euro

ZAEVI EDHE NJË PREMTIM PËR SHËNDETËSINË

PAGAT E MJEKËVE DERI NË 1600 EURO!



Koha Delvina KËRLUKLU

Shkup, 11 qershor - Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të bëjë çmos për të mbajtur mjekët e rinj në vend, respektivisht të parandalojë braktisjen e vendit nga kuadri mjekësor, deklaroi kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, në panel diskutimin "Investojmë në mjekë të rinj, e ardhmja e Shëndetësisë së Maqedonisë".

Kryeministri Zaev, tha se fatkeqësisht, në të kaluarën Maqedonia ka humbur shumë mjekë të talentuar dhe të arsimuar të cilët në kërkim të kushteve më të mira të punës, janë shpërngulur në vende të ndryshme të Evropës dhe botës. Ai tha se kjo praktikë duhet ndaluar, ndërsa mjekëve të rinj, dhe atyre të ardhshëm të pranishëm në panel diskutimin, u tha se vendi ka nevojë për praninë e tyre këtu. Qeveria e Maqedonisë, tha Zaev, ka miratuar një propozim-program për vitin 2019, dhe i njëjti ka të bëjë me edukimin e mjekëve dhe personelit mjekësor dhe për bashkëfinancim të specialistëve, të subspecializantëve dhe punonjësve shëndetësor në ordinancat private.

"Si rrjedhojë e zbatimit të këtij

programi, pacientët do të marrin shërbime mjekësore me standarde të larta, mjekët e rinj do të përsosin njohuritë e tyre, me çka diagnostifikimi i sëmundjeve do të bëhet në kohë. Për këtë, kemi paraparë mjete të mjaftueshme financiare nga buxheti i vitit 2019. Në mënyrë shtesë, në programin e punës së qeverisë 2017-2020, me një sërë masash garantojmë se do të kemi një sistem të qëndrueshëm për mbrojtje shëndetësore, të arritshëm, cilësor dhe afatgjatë", tha Zaev.

Kryeministri i Maqedonisë premtoi edhe rritjen e pagave për motivim shtesë në punë, për të shtuar se deri në vitin 2020, pagat e mjekëve specialistë do të rriten shkallë-shkallë, për të arritur në 100.000 denarë, ose 1600 euro.

"Me paga më të larta dhe me kushte më të mira për specializim dhe mësim praktik do të krijojmë atmosferë që të mos dëshironi ta braktisni vendin dhe të mbeteni në Maqedoni. Kjo është një dëshirë e jona, shpresoj të jetë edhe e juaja", tha Zaev, sipas të cilit vetëm në Shkup, ka mungesë prej 100 mjekësh, ndërsa në tërë territorin e Maqedonisë, ky numër është të paktën trefishi më i lartë.

Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, nga ana e tij tha se mbajtja e kuadrit mjekësor po bëhet fillimisht përmes rritjes së pagave, rritjes së pagesës për kujdestaritë, punës së natës dhe jashtë orarit të punës dhe rritjes së kuotave për specializim shtetëror. "Numri i specialistëve do të caktohet në bazë

të vlerësimeve në terren, konkursi për të cilin do të shpallet në shtator. Me paga më të larta dhe përmirësimin e kushteve të punës, synojmë një atmosferë në të cilën mjekët dhe kuadri tjetër mjekësor do të motivohen të qëndrojnë në shtëpi", tha Filipçe. Pas fjalimeve hyrëse, vijoi debati ku mjekët e rinj dhe specialistët kishin mundësi të bashkëbisedojnë me kryeministrin Zaev, ministrin e Shëndetësisë, Venko Filipçe, deputeten në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Meri Lazarova, kryetarin e Klubit të Mjekëve të Rinj, Nikola Brzanov dhe kryetaren e Shoqatës së mjekëve specialistë, Biljana Dodeva, për të gjitha shqetësimet që prekin angazhimin e tyre profesional.



Tevdovski optimist për rritjen ekonomike

Shkup, 11 qershor - Ministri i Financave, Dragan Tevdovski, shpreh optimizëm se rritja e ekonomisë do të lëvizë. Ai thotë se ka rezultate dhe se Qeveria do të bëjë gjithçka që ajo të intensifikohet. "Ne bëjmë stabilizim të gjendjes financiare, ndërsa pastaj dhe ta realizojmë atë që dëshirojmë, lëvizje të gjendjes ekonomike. Madje edhe treguesit tregojnë se në industri, bujqësia ka lëvizje, eksporti është i fuqishëm dhe do të bëjmë presion të vërtetë në ndërtimtarin, para së gjithash, në ndërtimin e ulët ku është problemi, tha Tevdovski duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve pas fjalimit në Konferencën në Shkup. Nga pushteti paraprak, siç tha ai, kjo Qeveri ka trashëguar probleme serioze si dokumentacion projektues dhe probleme të tjera të ndryshme. "Të gjitha institucionet janë përkushtuar në zgjidhjen e këtyre problemeve", theksoi ministri i Financave. Tevdovski potencoi se në vitet e kaluara rritja praktikisht ishte në bazë të atyre investimeve në përmendore, shelgje, fasada dhe të ngjashme, diçka, siç tha, që nuk i sjell mirë ekonomisë. Ai sqaroi se tani ka fillim të aktiviteteve serioze ndërtimore dhe se problemi kryesor është autostrada Kërçovë - Ohër, ku për një kohë të shkurtër duhet edhe atje të intensifikohen punët. Për atë deri kur do të rritet çmimi i naftës theksoi se ato janë lëvizje tregtare që nuk varen nga ne, por nga lëvizja e bursave botërore.

Ulet çmimi i karburanteve për 1.5 denarë

Shkup, 11 qershor - Karburantet nga mbrëmë në mesnatë do të ulen për 1.5 denarë për litër, vendosi Komisioni Rregullator për Energjetikë (KRRE). Me vendimin kryhet ulja e çmimeve rafinerike me pakicë të derivateve të naftës

mesatarisht për 3,35 denarë, gjegjësisht 2.27 për qind. Çmimi i ri i shitjes me pakicë të EUROSUPER BS-95 është 72 denarë për litër, EUROSUPER BS-98 do të shitet për 74, EURODIZEL (D-EV) për 63.5 denarë, ndërsa Vaji ekstra i

lehtë për amvisëri (EL-1) për 52.5 denarë për litër. Me vendimin e KRRE për 0,749 denarë për kilogram ulet edhe çmimi i shitjes së mazitot M-1 NS dhe do të arrijë 33.785 denarë për kilogram. Si arsye për uljen e çmimit me pakicë

të derivateve të naftës nga KRRE i theksojnë për 4.75 për qind çmimin më të ulët mesatar të naftës së papërpunuar në tregun botëror në 14 ditët e kaluara dhe për 0,899 për qind të kursit më të lartë të dollarit në krahasim me denarin.

ANGJUSHEV PËR RITJEN E BPV-së

DERI NË FUND TË VITIT, 3.2 PËRQINDËSHI MUND TË REALIZOHET

Shkup, 11 qershor - Zëvendëskryeministri Koço Angjushev edhe krahas rritjes prej 0.1 për qind në tremujorin e parë, është optimist se deri në fund të këtij viti mund të realizohet rritja e parashikuar e BPV-së prej 3.2 për qind.

"Absolutisht jam i sigurt se arritja e rritjes prej 3.2 për qind është e mundshme deri në fund të vitit edhe krahas rezultatit të keq nga tremujori i parë. Dëshiroj të theksoj se në tremujorin e parë kemi rritje në të gjitha segmentet e jetesës ekonomike përveç se në ndërtimin e ulët. Në bujqësi kemi rritje prej 6.5 për qind, në industri rritje prej 5.5 për qind, në tregtinë me



shumicë rritje prej 11 për qind, në ndërtimtarinë e lartë ka rritje prej dy për qind, ndërsa në ndërtimtarinë e ulët kemi rënie prej 40 për qind", tha Angjushev, duke u përgjigjur në pyetjen në Forumin për elektromobilitet në Fakulte-

tin e Makinerisë.

Ai theksoi se rënia prej 40 për qind në ndërtimtarinë e ulët është për shkak të vonësës në ndërtimin e autostradave Ohër-Kërçovë dhe Milladinovc-Shtip.

"Si qeveri ishim të drejtë para

vendimit që duhej ta sillnim, ndërsa kjo është a të vazhdojmë të implementojmë projekte të cilat janë të dëmshme për qytetarët nga aspekti financiar dhe janë teknikisht deri në fund të papërpunuara dhe të parregulluara dhe me këtë të gjenerojmë shpenzime që në fund do t'i paguajnë qytetarët, ndërsa në ndërkohë të tregojmë disa numra se ndërtohet ose të qëndrojmë t'i zgjidhim problemet, ndërsa pastaj t'i përfundojmë projektet", sqaroi Angjushev. Zëvendëskryemini theksoi se këto projekte gjithsesi do të përfundojnë, por siç tha, jo si deri më tani kur punët shtesë ishin me 56 për

qind dallim në çmim nga ajo që e paguan NP për rrugë shtetërore të realizuesit kryesor dhe atë që realizuesi kryesor ua paguan kompanive prodhuese të Maqedonisë.

"Çmimi i tillë është jologjik dhe mendoj se me hapin e tillë do të kursejmë shumë para. Vetëm deri më tani mbi 100 milionë euro kanë shkuar si dallim në çmime të cilat janë të pakuptimta dhe jologjike", potencon Angjushev dhe shtoi se në pjesën e ndërtimtarisë punët kanë lëvizur në drejtim të gabuar, tani ka arritur që kjo të stopojë dhe në periudhën e ardhshme aktivitetet ndërtimore do të rriten dukshëm.

**Republika e Maqedonisë
Institucioni publik qendra ndërkomunale
për punës sociale Strumicë**

Në bazë të nenit 101 të Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e RM nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 104/15, 150/15 dhe 51/18), Statutit të Institucionit publik qendra ndërkomunale për punës sociale Strumicë nenit 15 paragrafi 1 alineja 7, nenit 20 dhe nenit 21 dhe Vendimit të Këshillit drejtues për publikim të Shpalljes publike për zgjedhje të drejtorit numër 02-1724/3 të datës 08.06.2018, Këshilli drejtues i Institucionit publik qendra ndërkomunale për punës sociale Strumicë publikon:

SHPLLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të Institucionit publik qendra ndërkomunale për punës sociale Strumicë

- Kandidatët e interesuar krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - Te kenë të mbaruar arsimin sipëror shkalla e VII/1 e përgatitjes profesionale ose 240 kredi sipas SETK, të profileve arsimore në vijim: punëtor i diplomuar social, psikolog, pedagog, jurist, ekonomist, defektolog ose sociolog;
 - Të kenë minimum 5 (pesë) vjet përvojë pune pas diplomimit;
 - Posedim të një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: - TOEFEL IBT së paku 74 pikë, - IELTS - së paku 6 pikë, - ILEC (Cambridge Englis: Legal) - së paku niveli B2, - FCE (Cambridge English:First) - të dhënë, - BULATS - së paku 60 pikë ose APTS - së paku niveli B2 dhe
 - Të parashtrorë program të përgatitur për udhëheqje të institucionit.
- Neto pagesa është 27.677,00 denarë.
- Kandidati duhet të parashtrorë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me biografi të shkurtër;
 - Dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës sipëror - certifikatë ose diplomë;
 - Vërtetim për përvojë të punës pas diplomimit;
 - Certifikatë të shtetësisë jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - Dëshmi për posedim të certifikatës përkatëse të pranuar ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze dhe
 - Program për udhëheqje të Institucionit.
- Orari i kohës së punës: orët e punës në javë 40, orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte në mënyrë fleksibile me fillim prej ora 07:30 deri në ora 08:30 dhe mbarim prej ora 15:30 deri në ora 16:30.
- Dokumentet parashtrorë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.
- Shpallja publike zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.
- Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruar pas afatit nuk do të merren parasysh.
- Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme të parashtrorë deri te Këshilli drejtues i Institucionit publik qendra ndërkomunale për punës sociale Strumicë në arkiv ose në adresën, rr. "Leninova" nr. 84, Strumicë me shenjë (shpallje publike për zgjedhje të drejtorit).

VËREJTJE: Kandidati i cili do të zgjidhet për Drejtor deri më 01.09.2018 obligohet që të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES
Risto Bonev

KOMUNA E GOSTIVARIT
ОПШТИНА ГОСТИВАР
GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 23-1665/54
08.06.2018 vit
Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 и 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

L A J M Ě R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridik të përfshirë në hapësirën e Propozim ndryshimit dhe plotësimit të PDU-së për NJ.U. Qendër – A, Bllok 9, KK Gostivar 2 - Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizimin e :

**PREZENTIMIT PUBLIK
DHE ANKETËS PUBLIKE**

Rreth Propozim ndryshimit dhe plotësimit të PDU-së për NJ.U. Qendër – A, Bllok 9, KK Gostivar 2 - Komuna e Gostivarit për periudhën e planit 2017-2022, sipërfaqja e përfshirjes (21.770 Ha), që kufizohet në mes rrugëve:

- Nga ana veriore për Bul. "Goce Dellçev" dhe për kufirit me Bllok 8,
- Nga ana jugore për rrugës së re të projektuar " 25 " sipas PGJU-së të qytetit të Gostivarit,
- Nga ana lindore me shtegun hekurudhor Shkup - Kërçovë, dhe
- Nga ana perëndimore për rr."Beliçica ".

Prezantimi publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit respektivisht në sallën e Këshillit Komunal të Gostivarit dt. 18.06.2018 (e hënë) në ora 12.00.

Propozim ndryshimi dhe plotësimi i PDU-së për NJ.U. Qendër – A, Bllok 9, KK Gostivar 2 - Komuna e Gostivarit, do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit në afat prej 5 ditë pune edhe ate nga 18.06.2018 vit deri 22.06.2018 vit. çdo ditë pune prej orës 08.00-16.00.

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizëm, kurse në afatin e paraparë personat e interesuar juridik dhe fizik nga zona konkrete të përfshirë në Planin e shpallur në prezantimin publik mund të parashtrorë vërejtje me shkrim në fletat anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm.

Kryetari i Komunës
Arben Taravari



*Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup
Fakulteti filozofik*



Në bazë të nenit 172 dhe nenit 176 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2018), nenit 34 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" (Fleta universitare nr. 274/13 - tekst i pastruar), Dekani i Fakultetit Filozofik pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS

- Për zgjedhje të një (1) mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat mësimore shkencore: Metodika, Defektologjia, Ortopedagogjia, për kohë prej 5 (pesë) vjet.
- Për zgjedhje të një (1) mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat mësimore shkencore: Antropologjia filozofik, Aksiologjia, për kohë prej 5 (pesë) vjet.
- Për zgjedhje të një (1) mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat mësimore shkencore: Arsim, Defektologji (familje dhe invaliditet, edukimi special dhe familjet, familja dhe pengesat në zhvillim), për kohë prej 5 (pesë) vjet.
- Për zgjedhje të një (1) asistenti në titullin bashkëpunues për sferat mësimore-shkencore në vijim: Historia e llojit dhe gjinisë, Filozofia e llojit, për kohë prej 3 (tre) vjet.

Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Statutin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe Fakultetit filozofik në Shkup.

Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të parashtrorë:

- biografi të shkurtër /CV/,
- dëshmi për shkallë përkatëse të arritur të arsimit - doktor i shkencave (për pikat 1., 2., dhe 3.),
- dëshmi për shkallë të arritur përkatëse të arsimit - magjistr i sferës përkatëse (për pikën 4 të Konkursit),
- deklaratë për përmbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës,
- dëshmi për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- vërtetim për njohje të gjuhës së huaj në pajtim me nenin 170 të LMP (për pikën 4 të Konkursit),
- listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale, nga një kopje prej punimeve dhe formular të plotësuar Aneks 2 ndaj Raportit për zgjedhje në titull, të publikuar në ueb faqen e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (për pikat 1, 2 dhe 3 të Konkursit).

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" (Fleta universitare nr. 274/13 - tekst i pastruar).

Orari i punës së mësimdhënësit në titujt mësimor-shkencor është përcaktuar në pajtim me aktet e Fakultetit filozofik.

Bruto pagesa fillestare e mësimdhënësit për pikën 1 është rreth 56.294,00 denarë, Bruto pagesa fillestare e mësimdhënësit për pikën 2 dhe 3 është 48.561,00 deri më 61.818,00 denarë (varësisht në cilin titull mësimor-shkencor do të do të zgjidhen kandidatët e paraqitur në konkurs), ndërsa bruto pagesa fillestare për bashkëpunëtorin nga pika 4 është rreth 39.675,00 denarë.

Procedura e Konkursit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor dhe bashkëpunues zgjatë 6 muaj duke konsideruar nga dita e publikimit të konkursit.

Dokumentet parashtrorë në Fakultetin filozofik në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9a – Shkup, në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit.

Informacionet shtesë në telefonin 02 3116-520

Fakultetin filozofik në Shkup



Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor

Informacion mbi njoftimin e paraqitur për qëllimin e realizimit të projektit: "Parku i centralit të erës - Miravci"

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor informon publikun e interesuar se investitori SH.A. "Elektranat e Maqedonisë", me seli në rr. "11 Tetori" nr. 9, Shkup, ka dorëzuar një njoftim mbi qëllimin e realizimit të projektit dhe për të përcaktuar nevojën për vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedisin jetësor : "Parku i centralit të erës - Miravci".

Me këtë projekt, investitori synon të ndërtojë kapacitetet prodhuese të energjisë nga burimet e rinovueshme - era. Projekti do të jetë i vendosur në zonën e fshatit Miravci në komunën e Gjevgjelisë. Parku i centraleve me erë "Miravci" është planifikuar të përbëhet nga 12-15 turbina me erë, secila me fuqi nominale prej 3-4MW. Kapaciteti i përgjithshëm i parkut të centralit të erës do të jetë 50 MW.

Organi kompetent për vendim-marrje është Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Njoftimi i plotë për synimin e realizimit të projektit: "Parku i centralit të erës - Miravci" mund të gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor - www.moep.gov.mk.

Personat për kontakt:

Antonio Arsov – inxhinier përgjegjës i mjedisit jetësor, Sektori për Zhvillim dhe Investime, SHA ELEM- Drejtoria
rr. "11 Tetori" nr. 9, 1000 Shkup; tel: 02 31 49 213
e-mail: antonio.arsov@elem.com.mk

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
bul. "Goce Dellçev" nr. 8, 1000 Shkup

Biljana Petkovska – udhëheqëse e Sektorit të Mjedisit Jetësor
bul. "Goce Dellçev" pn. 1000 Shkup,
tel: 02-3251-466; e-mail: b.petkovska@moep.gov.mk

Aleksandar Petkovski – udhëheqës i Sektorit të Mjedisit Jetësor
bul. "Goce Dellçev" nr. 8, 1000 Shkup,
tel: 02-3251-466; e-mail: a.petkovski@moep.gov.mk

TETOVA I DËRGON VËREJTJET PUSHTETIT QENDROR

MINISTRIA E FINANCAVE TË REFLEKTOJË PËR LIGJIN E LOJËRAVE TË FATIT

“Mendoj se edhe komunat tjera do të motivohen të na mbështesin neve, Ligji është në përgatitje e sipër, arsyetimi dhe vendimi i Këshillit komunal të Tetovës ka një arsyeshmëri të madhe, kështu që jemi aktiv deri në ndryshimin përfundimtar të Ligjit dhe në të njëjtën kohë, të mbështesim aktivitetet qytetare, të cilët kanë për qëllim mos lejimin e kësaj veprimtarie e cila do të organizohet në vende ilegale”, tha Arifi



cila do të organizohet në vende ilegale”, tha Arifi.

Ajo është pyetur edhe për kërkesën e parashtruar nga ana e Lëvizjes anti-bixhoz. “Ju e dini se vendimi i Këshillit flet për 300 metërshin larg objekteve shkollore dhe të tjera të interesit publik. Por duhet që të merret parasysh fakti që në propozimet tona, ne kemi shkuar edhe më shumë pasi kemi marrë parasysh propozimet e qytetarëve dhe ajo që është e rëndësishme për ne është që definitivisht ky Ligj të pësojë ndryshime sa i përket distancës”, sqaroi kryetarja e Komunës së Tetovës. Sipas saj, deri më tash nuk ka patur asnjë iniciativë në Ministrinë e Financave që Ligji të pësojë ndryshime, prandaj edhe është kërkuar një gjë e tillë.

“Deri kur ne si komunë e kemi marrë këtë iniciativë, kjo as që ka qenë e paraparë në propozim-ligjin dhe të ketë ndikim edhe të autoriteteve lokale, sepse sipas Ligjit aktual, komunat nuk kanë patur ndonjë ndikim në këtë proces, ndërsa ne si komuna i vuajmë pasojat e këtyre veprimtarive. Prandaj edhe mendoj se iniciativa

që kemi filluar është e vetmja nga ana e Komuna e Tetovës dhe mendoj se duhet të përkrahet edhe nga komunat, institucionet e kështu me radhë”, theksoi Arifi. Ajo është shprehur optimiste se Ministria e Financave do të reflektojë dhe do të marrë parasysh kërkesat e qytetarëve të Tetovës.

“Presim që në periudhën ligjore, sa është periudha e diskutimit publik dhe në bazë të saj, Ministria e Financave të reflektojë në këtë drejtim”, tha shkurt kryetarja e Komunës së Tetovës. Përndryshe, kohëve të fundit në Tetovë u organizuan protesta kundër hapjes së kazinove, respektivisht asaj në Reçicë të Vogël, me çka edhe u arrit një sukses që të mos lejohet hapja e kazinosë. Por organizatorët kërkuar që kazinotë të mos hapen as afër shtëpive dhe të jenë 3 kilometra larg nga shtëpia e fundit. “Të hartohet Ligj që do të kërkojë të gjitha kazinotë, bastoret sportive dhe lojërat tjera të fatit të largohen 3 kilometra nga shtëpia e fundit e çdo vendbanimi. Konsiderojmë se Ligji i përgatitur nga Ministria e Financave është skandaloz dhe i pa-

pranueshëm, prandaj do ti dërgojmë letër të gjithë grupeve parlamentare me amendamente të përgatitura nga juristët tanë për të parandaluar sjelljen e Ligjit të hartuar nga Ministria e Financave”, theksuan ditë më parë nga Lëvizja Anti-bixhoz, e cila ka zhvilluar betejën kryesore për mos hapjen e kazinosë. Edhe Këshilli i Komunës së Tetovës ditë më parë kishte sjellë vendim ku kërkohej që komuna të përfshihet gjatë sjelljes së Ligjit për lojërat e fatit.

“Përveç pikave, të cilat tanimë veçse janë të parapara nga institucionet, ne vendosëm që atyre pikave të ju shtojmë edhe disa pika të tjera, për të cilat mendojmë se ia vlen të jenë si pjesë e Ligjit përkatës, i cili në të ardhmen pritet të sillt, domethënë planifikohet që distanca të rritet nga 100 metra sa është tani në 300 metra dhe aty të përfshihen domethënë më shumë institucione shtetërore si çerdhe, komuna, spitale, objekte fetare e kështu me radhë”, deklaroi kohë më parë kryetari i Këshillit të Komunës së Tetovës, Bekim Memeti.

Rrënimi i fabrikës, javën e ardhshme

Tetovë, 11 qershor - Ndonëse u paralajmërua se dje do të rrënohej objekti i ish-ndërmarrjes Nemetali në lagjen Bllok 4, megjithatë nuk filloi një gjë e tillë. Ta paktën kështu ishin dakorduar të premten banorët bashkë me autoritetet e Komunës së Tetovës që rrënimi i objektit të fillojë dje. Në vendngjarje në ora 11 ishin tubuar banorët, ndërsa i pranishëm ishte edhe udhëheqësi i Sektorit për Tokë Ndërtimore, Arsim Nuredini. Banorët janë informuar nga ana e Nuredinit se pronari i objektit që duhet të rrënohet ka shprehur dëshirë që vet të rrënojë objektin dhe ka kërkuar afat kohor prej disa ditësh. Pas kësaj bisede, banorët janë dakorduar që të presin deri pas përfundimit të festës së Bajramit që të fillojnë punët në këtë lagje. “Pronari që figuron i objektit vet ka shprehur dëshirën që të rrënojë, ngase ndoshta do të mund të përdorë material nga objekti, prandaj ai vet ka kërkuar kohë tre ditë dhe kjo nuk paraqet ndonjë problem për ne që të presim. Kontratat me firmën që do të rrënojë objektet është nënshkruar dhe javën e ardhshme kjo punë do të marrë epilog”, tha Nuredini. Nga ana tjetër, banorët janë pajtuar që punët të fillojnë pas festës së Bajramit. “Shpresojmë se kësaj radhe e kanë seriozisht dhe pasi që vet ishin në vendngjarje, e kanë parë situatën, pengesa nuk ka që të mos fillojnë punët. Prandaj, përdërisa kemi prituri deri më tash, do të presim deri javën e ardhshme”, theksuan banorët. Objekti është bërë pengesë kryesore që të mos hapet rruga dhe të përmirësohet infrastruktura në këtë lagje të Tetovës, e cila është lënë pas dore më shumë se një dekadë. Kjo lagje e re ndodhet në mes të fshatit Poroj dhe lagjes Drenovec në hyrje të Tetovës, ku në të kaluarën ka qenë e vendosur dhe ka funksionuar fabrika për prodhimin e tullave. (U.H)

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 11 qershor - Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, thotë se përmes Bordit të Njësisë të Bashkësisë së Vetëqeverisjes Lokale, ka dërguar në Ministrinë e Financave propozimin e Këshillit të Komunës së Tetovës që të mos lejohet hapja e kazinove në afërsi të shkollave dhe institucioneve tjera publike. Ajo tha se kjo kërkesë është shqyrtuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave. “Mendoj se edhe komunat tjera do të motivohen të na mbështesin neve, Ligji është në përgatitje e sipër, arsyetimi dhe vendimi i Këshillit komunal të Tetovës ka një arsyeshmëri të madhe, kështu që jemi aktiv deri në ndryshimin përfundimtar të Ligjit dhe në të njëjtën kohë, të mbështesim aktivitetet qytetare, të cilët kanë për qëllim mos lejimin e kësaj veprimtarie e

HARAÇINA ME OBJEKT TË RI KOMUNAL

Shkup, 11 qershor - Në Haraçinë dje ka filluar ndërtimi i objektit të ri komunal. Ndërtimi i objektit është financuar me 260.000 euro të siguruar nga Bashkimi Evropian, si pjesë e Programit për investime komunale rurale. Programin e administron Banka Botërore, ndërsa e zbaton Ministria e Financave.

Në shënimin e fillimit të ndërtimit ka marrë pjesë kryeministri Zoran Zaev, euroambasadori Samuel Zhbogar, ministri i Financa-

ve, Dragan Tevdovski, përfaqësuesit e Bankës Botërore, Bekim Imëri dhe kryetares së Komunës së Haraçinës, Milikije Halimi.

Me kërkesë të Qeverisë së Maqedonisë, Bashkimi Evropian u pajtua të sigurojë 15.5 milionë euro për zhvillimin e infrastrukturës rurale. Shuma e përgjithshme e programit, duke e përfshirë edhe bashkëfinancimin nga Qeveria është 20.667 milionë euro. Programin e implementon Ministria e Financave ndërsa i njëjti

administrohet nga Banka Botërore. Këto mjete u ndahen komunave në formë të granteve dhe duhet të kontribuojnë për përmirësimin e infrastrukturës në zonat rurale.

Në kuadër të këtij programi, Komuna e Haraçinës e fitoi të drejtën të shfrytëzojë grant të BE-së në shumë prej 195.000 euro për zbatimin e projektit për “Ndërtimin e objektit komunal në Haraçinë”. Projekti është bashkëfinancuar nga buxheti i



Maqedonisë në shumë prej 65.000 eurosh. Shuma e vlerësuar e projektit është 285.545 euro, por pas furnizimit të publikuar publik, e njëjta është zvogëluar për

241.975 euro, prej të cilave 181.482 euro janë financuar prej Fondeve të Bashkimit Evropian, ndërsa 60.493 euro prej buxhetit të Republikës së Maqedonisë. (R.K)

E vogla...!

Nga

Adelina MARKU



Edhe jeta me vrap e me shumë para është e mundimshme, por edhe ajo e ngadalta e e fukarasë është e mundimshme. Mere si t'a marësh, qenka betejë çdo gjë e gjithmonë! Edhe i pari edhe i dyti megjithatë kanë një gjë të përbashkët: mendojnë për të nesërmen! Ajo, e nesërja vjen pandalë! E si na gjen se...?

Jeta e të parëve mundimin e ka tek fenomeni i shtimitë para ja shton paranë dhe bëhet më e madhe se nevoja individuale e familjare, prandaj shndrohet në INSTITUCION që kërkon menaxhim. Ndoshta tek menaxhimi qëndron ngarkesa psikike apo...ajo që shkakton tollovinë tjera, frikën nga humbja, frikën nga shtimi, obligimin e shtum. Ndërsa fukaraja ka frikën ndryshe, ai/ajo mendon se a ka t'a ushqejë fëmijën të nesërmen që vjen! Kjo frikë ta çan zemrën tej e përtej! Kaq... Këtu yemra vuan, ajo që është më e dobta!

Por sa mendon i pasuri në të varfrin...?

Ndoshta përgjigja është po aq e thjeshtë... me sa duket për aq sa refuzon i varfëri të mendojë në të pasurin...! Janë këto dy botëra që nuk flasin e nuk e kuptojnë gjuhën e njëri tjetrit.

Por përse të Mëdhenjtë duan të kuptojnë një cop vendi si ky yni me kaq përkushtim? Ç'është ai dimension moral - t'a quaj e kam gabim, (nuk ka të bëjë me moralin, atëherë...), ç'qenka ai dimension etik - t'a quaj e kam gabim, (oh nuk ka të bëjë me etikën...), ç'qenka ajo që bën fukaranë të bëhet herë - herë qendër e vëmendjes ndërkombëtare dhe për t'a ndihmuar? Meqë do vite goxha i bëmë mes përpëlitjesh e përsiatjesh ballë-ballë me "ekskluzivitetet" e Maqedonisë, (shpesh biles edhe të trajtave markante), për gjeneratën time tanimë nuk është tabu të kuptuarit se vendi ku jetojmë është prodhim diplomacie dhe prandaj teren diplomacie, por prandaj edhe teren i lëshueshëm edhe për lojërë të shpejta e luftënxitëse që kontrollohen shpejt nga po ai që i shkakton e nxit ato! Pra, nuk ka të bëjë me trashëgimi prandaj ndoj' historie marrëdhëniesh ndërkombëtare, por ka të bëjë me një investim/pranim që është bërë nga bashkësia ndërkombëtare e i cili shihet të mbahet e të

mos shkojë në bankrot. Unë nuk ju vërtetova diçka që nuk e dinit apo, por e shkruaj publikisht nga-se origjina, pra aty ku filloi tregimi mbi këtë shtet- ka rrëndësi përgjatë rritës së tregimit. Ndërsa tani jemi në një fazë kur kuptojmë se duhemi shkëputur nga origjina që e kish gatuan politika e asaj kohe!... E se gjërat duhen funksionuar sipas një fillese të re të cilën poaq ndërkombëtarët e bëjnë të mbijetojë! Popullorçe: ia kanë marrë dorën! Meqë të gjitha elitat politike, qofshin të majtët, qofshin të djathtët, nuk ditën të mendojnë për fukaranë (për shtetin dhe votuesit) por vetëm për të krijuar Madhësinë instante të parave përmes vjedhjes e korrupsionit, ndërkombëtarët rikthehen dhe vendosin fukareshën para kushteve që duhet t'i plotësojë poaq instant sa ia bënë vjedhjen elitat politike të veta, e me qëllim për t'i ikur edhe kësaj here falimentimit! Dhe do shpëtojë edhe kësaj here, këtu nuk e vë asnjë dyshim biles, por ajo që më shpërfaqet si faktor shqetësimi është mos-pasja ide për zhvillim ekonomik të këtij vendi. Nuk është aspak i ri gjykimi se ekonomia e rënduar sjell subkulturë paraekonomike,

e atilla që lejon larjen e parave dhe prandaj edhe krijimin e vazhdueshëm të "pseudoinvestimeve" në gjëra të cilat nuk i përkojnë shoqërisë ku jetojmë. Ndoshta kështu duhet kuptuar projekti 2014 (... dhe ky jo si i vetmi perversion prodhimi instant për të dominuar tjetrin!), por edhe zëvendësimi i kulturës sonë shqiptare me trajta subkulturore, siç janë kohëve të fundit devijimi në arsim, submenaxhim institucionesh dhe në fe sidomos, tuj e leju interpretimin e fesë nga shtëpia e ndjesisë së shenjtë në ndjesi materialiste, ose siç e quajnë tanimë: fe politike.

Tani, për t'i dhanë ide bërjes politikë mjafton të dëgjosh bisedën e një tavoline familjare shqiptarësh ose të lexosh urimin për Natën e Madhe e që e pranova jo më larg se dje e ku miku më shkruan: "Urime Nata e Madhe, Zoti na e shtoftë drejtësinë dhe na e forcoftë Imanin tonë!"

Ia ktheva: "Faleminderit e kontribuofshi për kulturë e komb!" Ma ktheu përsëri e në emër të Zotit: "S'ka përse, Zoti na e shtoftë edhe më shumë kontributin tonë në këta dy çështje...!". Më forcoi bindjen kjo përgjigje se rrëshqitjen mund t'a kemi

lejuar vetë, e se po të njëjtën duhemi zhbamun e ndrequn vetë! Si laike që jam në lexime fetare por e fuqishme në besim ndaj Zotit, ndjeva grymje të ndërgjegjes sepse nuk kapja qartë spikamën e fjalës IMAN që më përcolli në uratë miku im besimtar. Nguta të gjej kuptimin dhe më ndriti koncepti që përcilte kjo fjalë: Imani është shqiptim me gojë, besim me zemër dhe të punuarit me gjymtyrë.

Padyshim besimi shtohet me bindje dhe vepra të mira në kuptimin tim dhe, që t'i kthehem diplomacisë e vendit ku jetojmë pa hyrë në dilemën hamletiane se a bëri mirë diplomacia që prodhoi këtë shtet ose jo ...do doja të vazhdoj tek dhënia ide politikës e ekonomisë përmes bërjes mirë ndaj vendit. Konstatimi se jemi prodhim diplomacie si shtet më hap kujtesën e cila ka arkivuar sa e sa intervenime pozitive diplomatike në vend, (e kur i referohem ndikimit diplomatik, i referohem diplomacisë së botës perëndimore!). Të gjitha intervenimet kanë qenë të spikatuna në kohë krizash të thella e kjo më bën të kuptoj se ky inercion ndikimi pozitiv i ndërkombëtarëve ndaj këtij shteti do vazhdojë

edhe më tej edhe më shumë gjatë biles. Por, " e keqja" e kësaj është tek varshmëria që krijojnë ata përmes ndikimit në shoqëri e vendimarrje vetanake! E vogla Maqedoni nuk e bën ndryshimin për të mirë vetë, ajo nuk ka besim të mjaftueshëm për të bërë këtë lloj ndryshimi, ndërkombëtarët këtë e dinë më mirë sepse vetë e kanë pjellë Maqedoninë apo,...dhe kur përsëri në gjuhën e Librit të Shenjtë do doja të gjej nevojën për faleminderim ndaj diplomacisë perëndimore, po citoj një hadith që thotë: "Kush prej jush shikon ndonjë të keq, atëherë le ta ndryshojë me dorën e tij. Nëse nuk mundet, le ta ndryshojë me gjuhën e tij. Por nëse përsëri nuk mundet, le ta ndryshojë me zemrën e tij, ndërsa ky është besimi më i dobët..."

E kur vjen tek zemra, tek ky besim i vagët e shumë emocionan, gjërat kthehen keq këtu tek ne...Ma e mira është që gjërat të fillojmë t'i ndryshojmë me dorën e gjuhën tonë tanimë..., sepse jeta në rrenën e madhe e vjedhjen e gjatë ka humbur kuptimin tanimë!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovska lok.14 - përdhese, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 11 qershor | Numri i parë i gazetës do të 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

HISTORIA E BISEDIMEVE POLITIKE NË MES PRISHTINËS E BEOGRADIT



Nga Jakup KRASNIQI

Qytetarët e Kosovës si dhe partitë politike edhe para Rambujesë e pas saj kanë qenë shumë të interesuar që të gjejnë zgjidhje politike me Serbinë. Që nga Bisedimet e Vjenës e sidomos pas Pavarësisë kanë qenë e janë të interesuar për t'i normalizuar marrëdhëniet ndërshtetërore me Serbinë. Por, pas pesë e më shumë vitesh të Bisedimeve të Brukselit jemi të bindur dhe besojmë fortë në bindjet tona, se mënyra se si kanë filluar bisedimet politike me ndërmjetësimin e Brukselit dhe sidomos se si janë udhëhequr e zhvilluar ato, vërshtirë se do të kemi normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Dhe për ketë faji nuk është në Prishtinë, por të politikave e vjetra të kimit e të gjenocidit të ushtruar nga Beogradi zyrtar dhe jo vetëm në luftën e fundit.

HISTORIA E BISEDIMEVE POLITIKE SERBI - KOSOVË

Kosova me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar e sidomos te vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit, ka zhvilluar bisedime dy herë. Dhe Serbia asnjëherë, deri me sot nuk i ka pranuar rezultatet finale të bisedimeve, ashtu si nuk po i pranon as këto të zhvilluara nën mbikëqyrjen e Brukselit zyrtar. Të cilat ishin të autorizuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, që të ishin bisedime teknike. Edhe në bisedimet e Brukselit të filluara si teknike e që përfunduan në bisedime politike, pala e Kosovës veç sa i ka thelluar kompromiset, duke hequr dorë nga të qenët palë e barabartë në bisedime. Dëshmi për ketë është fusnota (që e mohon pavarësinë) dhe të gjitha çështjet e brendshme të Kosovës që u biseduan atje. Me ketë veprim pala e Kosovës në bisedime ka shkelur vullnetin e qytetarëve të Kosovës të shprehur përmes përfaqësuesve të tij të zgjedhur në Kuvendin e Kosovës më 17 shkurt 2008.

I. Në bisedimet e para që janë zhvilluar në Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambujesë të Francës (shkurt - mars 1999), ku pala shqiptare pat bërë një kompromis goxha të madh. Arsyja e tij ishte se pala shqiptare donte të sakrifikonim për zgjedhjen politike e paqësore të luftës se filluar në shkurtin e vitit 1998 (e pranuar ndërkombëtarisht, se ajo kishte filluar vite më parë). Serbia edhe pas dy runde-



ve të bisedimeve të zhvilluara në Rambuje (shkurt '99) e Paris (mars '99), nuk e pat nënshkruar Dokumentin Përfundimtar të Marrëveshjes. Mos gatishmëria e regjimit të Millosheviqit për të nënshkruar Dokumentin përfundimtar të Marrëveshjes, Bashkësia Ndërkombëtare u obligua të kërkonte rrugë tjetër. Zgjedhja tjetër ishin Bombardimet e NATO-së në territorin e Federatës së mbetur Jugosllave (Serbi - Mal i Zi). Deri të një zgjedhje erdhi vetëm pas Bombardimeve 78 ditësh të NATO-së, të cilat nuk do të ndodhnin pa ndikimin e fuqishëm të SHBA, MB e më vonë edhe të vendeve të tjera anëtare të NATO-së. Pastaj vjen rezolutën 1244 e Këshillit të Sigurimit, në të cilën thuhet: Kosova është protektorat i OKB-së. Sipas kësaj rezolute OKB ka përgjegjësinë për administratën civile, kurse NATO për sigurinë në Kosovë.

II. Herën e dytë, bisedimet dy vjeçare (2006 - 2007) të zhvilluara në Vjenë. Bisedimet e Vjenës u zhvilluan nën udhëheqjen e emisarit special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, nga Presidenti i Finlandës Marti Ahtisari, me mbikëqyrjen e shteteve që e përbënin Grupin e Kontaktit (GK).

Pas bisedimeve të gjata dhe njerëzve special të angazhuar në pjesën e dytë të Bisedimeve (2007), një nga SHBA ambasadori (Frank Wisner), një nga BE-ja dhe ai ishte ambasadori gjerman (Wolfgang Ishcinger) dhe i treti nga Rusia i dërguari i posaçëm i Ministrisë së Jashtme Ruse (Aleksander Bozan - Kharchenko). Rusia ishte anëtare e GK dhe pjesëtare e bisedimeve të Vjenës që nga Deklarata e parë e GK e cila edhe e hap fillimin e bisedimeve. Deklarata nënvizonte se nuk ka kthim

para vitit 1999 dhe nuk ka bashkim me ndonjë vend tjetër. Pra orientimi ishte kah pavarësia. Edhe vazhdimi nga treshja e përmendur, palët i nuk ndryshuan qëndrimet e tyre.

Dokumenti Përfundimtar për Zgjedhjen e Statusit Përfundimtar për Kosovën, i cili ishte rezultat i atyre bisedimeve nuk ishte vullneti i shqiptarëve të Kosovës, natyrisht nuk ishte as vullneti i Serbisë. Dokumenti ishte i palës që i udhëhoqi bisedimet (Komuniteti Ndërkombëtar), pra ishte kompromis i ofruar nga shtetet anëtare të GK. Pa dyshim për shqiptarët ishte kompromis tepër i madh, por ama ishte kompromis për Pavarësinë e Mbikëqyrur të Kosovës dhe kjo ishte arsyeja që e pat pranuar pala e Kosovës. Komuniteteve pakicë e veçanërisht pakicës serbe ju dhanë shumë të drejta e fare pak obligime, mbase asfale. Ndonëse ai nuk përbënë më shumë se 5% në numrin e përgjithshëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Më 15 mars 2007 dokumenti i qe dorëzuar OKB-së nga zëvendësi i M. Ahtisarit, zoti Rohan.

Më 26 mars 2007: Martti Ahtisaari i dërgon raportin përfundimtar Këshillit të Sigurimit të OKB-së ku ai thotë se Kosova duhet të bëhet e pavarur.

Dokumenti Gjithpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës, ishte paraparë që Pavarësia e mbikëqyrur do të arrihej në KS, i cili do të shfuqizonte Rezolutën 1244 dhe me një Rezolutë ta njihje Pavarësinë e Kosovës, e cila automatikisht do të bëhej anëtare e OKB-së. Por, ky variant nuk shkoj, pastaj u zgjodh rruga tjetër që në koordinim me faktorin ndërkombëtar, Pavarësia të shpallej në Kuvendin e Kosovës dhe kjo u bë më 17 shkurt 2008.

Vlen të theksohet se para se të shpallej në Kuvendin e Kosovës, ajo që pranuar me 29 mars 2007 nga Parlamenti Evropian i cili miraton një rezolutë ku shprehet përkrahja për pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën. Me 490 vota pro, 80 kundër dhe me 87 abstenime. Ndërsa më 10 qershor 2007, Presidenti amerikan, George E. Bush, viziton Tiranën, në atë rast ai thotë se Kosova do ta marr pavarësinë. Po për ketë çështje Kryeministri i MB Toni Blair, para se të lëshoj zyrën e kryeministrit, thotë: "Jam krenar për rolin që Britania e Madhe ka luajtur për t'i dhënë popullit të Kosovës një të ardhme më të mirë".

Më pastaj, Serbia e dërgoi në GJND ankesën e saj për shpalljen e pavarësisë dhe në korrik të vitit 2010, mori përgjigjen se Pavarësia e Kosovës nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar. "Gjykata, rrjedhimisht, ka gjetur se Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit nuk i ndalon autorët e Deklaratës së Pavarësisë së 17 shkurtit, 2008, nga shpallja e deklaratës së pavarësisë nga Republika e Serbisë.

Prandaj, Deklarata e Pavarësisë nuk paraqet shkelje të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit", tha presidenti i gjykatës, Hisashi Owada. Pra "Gjykata konsideron se e drejta ndërkombëtare e përgjithshme nuk përmban ndalesë të zbatueshme për deklarata të pavarësisë. Rrjedhimisht, ajo konkludon se Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit të vitit 2008, nuk e shkel të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare".

III. Hera e tretë, Bisedimet e Brukselit filluan si bisedime teknike, pa asnjë arsyeje e konsensusi nacional këto bisedime u shndërruan në bisedime politike. Këto bisedime jo vetëm që nuk

(Përkujtues për vendorë e ndërkombëtarë, për raportet shqiptare e serbe në bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi)



kanë zgjidhur gjë, veçse shtetin e Kosovës dhe institucionet e tija i kanë bërë jo funksionale. Marrëdhëniet me Serbinë jo vetëm që nuk janë normalizuar, por disa herë vetëm sa janë acaruar. Kujtoni trenin nationalist serbe.

Këto bisedime e prodhuan Listën serbe në institucionet e Kosovës e cila nuk i mbron interesat e qytetarëve serb të Kosovës. Ata në institucionet e Kosovës mbrojnë interesat e politikës agresive të Beogradit e cila ka qëllim të prodhojë sa më shumë destabilitet e pasiguri. Në një situatë të tillë palës sonë (politikës shqiptare) si mbetet gjë tjetër veçse të kërkojë konsensus nacional për t'i sjell bisedimet në binare normale brenda vetvetes. Vazhdimi i bisedimeve nuk duhet të ndodhë pa u krijuar konsensusi nacional, si dhe ndryshuar si në formë e po ashtu edhe në përmbajtje - substanca e bisedimeve. Për të vazhduar këto bisedime, duhet një platformë e re dhe ekip i ri negociator. Ata apo ai që i ka sjell këto bisedime në ketë gjendje, nuk duhet të lejohen në asnjë mënyrë që të jenë pjesë e këtyre bisedimeve ose më se shumti të jetë pjesë ceremoniale e atyre bisedimeve.

Nuk ka asnjë dyshim, as pala e Kosovës e as ajo e Komunitetit Ndërkombëtar nuk e kanë gjetur gjuhën që do ta kuptonte politika zyrtare e Beogradit e cila nuk po mund të gjen forcë që të shpëputet nga shtrati i politikave agresive e gjenocidare të Millosheviqit. Politikë që nuk i qëndron me korrektësi asnjë marrëveshjeje. Gjithë historia e bisedimeve me Serbinë e tregon ketë.

(koha.net)

"TRADITA" E ORGANIZOI EDICIONIN E V TË LIDHJES SË PRIZRENIT

"LIDHJA..." SHËNOHET EDHE NË TETOVË

Tetovë, 11 gusht - Shoqata për kulturë dhe art "Tradita", dje e organizoi në Tetovë edicionin e V me radhë të manifestimit kulturor "Lidhja na bashkon", veprimtari kulturore që këtë vit përkoi me 140-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Manifestimin e shpalli të hapur kryetari i Shoqatës "Tradita", Selam Sulejmani, i cili para pjesëmarrësve tha se pas 140 vitesh, ne të gjithë së bashku, e risjellim në vëmendjen tonë kontributin e autoriteteve shqiptare të Lidhjes së Prizrenit, të cilët pas vendimeve të padrejta në kurriz të shqiptarëve në Kongresin e Berlinit, u mblodhën të vendosur dhe të bashkuar, për të luftuar në mbrojtje të interesave të kombit.

"Studiues të njohur të historisë, gjuhës, letërsisë dhe kulturës sonë, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit e vlerësojnë si ngjarjen më të veçantë në historinë moderne shqiptare, sepse sipas tyre e krijoi njësinë e tërësisë kombëtare dhe njësinë e shkollës shqipe. Në të njëjtën kohë është lëvizja që krijoi platformën historike, politike dhe kulturore për formimin e kombit dhe të shtetit shqiptar. Historia jonë na rrëfen se kjo ngjarje është ndër të arriturat më të mëdha të kulturës sonë kombëtare, sidomos kur dihen rrethanat historike të popullit shqiptar, robëria shekullore, lakmitë e shteteve fqinje, qëndrimi i qendrave evropiane të vendosjes, por edhe qëndrimi armiqësor i Portës së Lartë, theksoi Selam Sulejmani. Referatin kryesor për përvjetorin e Lidhjes së Prizrenit para pjesëmarrësve në manifestim e paraqiti historiani i njohur, prof.dr. Zeqirja Idrizi, ligjë-



Çmimi kombëtar "Ali Vishko" për vitin 2018 iu ndahet prof.dr. Reshat Nexhipit, me motivacionin për veprimtari jetësore dhe arritje të veçanta në fushën e shkencës, arsimit dhe kulturës shqiptare

ruet në Katedrën e Historisë të Universitetit të Tetovës.

Sipas profesor Idrizit, Lidhja e Prizrenit ishte lëvizja e parë shqiptare e organizuar në mënyrë administrative, politike dhe ushtarake që prej kohës së Skënderbeut. "Të detyruar nga rrethanat specifike të vitit 1878, shqiptarët thirrën një Kuvend Mbarëkombëtar, i cili synonte bashkimin e Shqipërisë. Pas firmosjes së Marrëveshjes të Shën Stefanit mes Rusisë dhe Turqisë, ku Shqipërisë nuk iu njoh asnjë e drejtë territoriale, dhe në pritje të Kongresit të Berlinit, i cili me shumë mundësi do t'i hiqte hartës shqiptare krahina të shumta, atdhetarët shqiptarë ideuan këtë mbledhje, ku do të shpallnin ndarjen përfundimtare nga sundimi osman. Lidhja e Prizrenit ishte lëvizja e parë e madhe e organizuar politikisht, administrativisht dhe ushtarakisht për të krijuar një rajon të bashkuar shqiptar qysh nga

dështimi i forcave të Skënderbeut në Mesjetë. Është etapa paraprake para Pavarësisë së Shqipërisë. Ajo është një nga përpjekjet më serioze për pavarësinë e vendit, jo vetëm për nga numri i përfaqësuesve që mblodhi, por edhe nga platforma ideologjike. Në këtë kohë dramatike për atdheun 1875 - 1878, kur atdheu kishte më tepër nevojë për me qenë, mendimtarë, politikanë, luftëtarë dhe poetë, pa humbur kohë për asnjë çast, vëllezërit Frashëri si ideologë u rreshtuan në Komitetin e Stambollit si organizatorë të mirë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Me përpjekjet e tyre Lidhja e Prizrenit mori një fuqi të re", deklaroi prof.dr. Zeqirja Idrizi.

Në referatin e tij, historiani Idrizi i theksoi edhe emrat e delegatëve pjesëmarrës në Kuvendin e Lidhjes së Prizrenit, në mesin e tyre edhe delegatë nga qyteti i Tetovës dhe më gjerë. "Më 10 qershor 1878

në Prizren të Kosovës, Kuvendi hapi dyert për të pritur delegatët, të cilët do të vinin nga të katërt Vilajetet e Shqipërisë: Shkodrës, Manastirit, Janinës dhe Kosovës. Unë po përmendi vetëm delegatët nga Tetova: Sheh Mustafë Tetova, Haxhi Sadik Tetova, Riza Fuati, Hasan pashë Derralla, Esat pashë Tetova, Mehmet Efendiu, Rexhep beu, ndërsa nga Gostivari: Haxhi Zylbehari", deklaroi prof.dr. Zeqirja Idrizi.

Në edicionin e V të manifestimit kulturor "Lidhja na bashkon", që u mbajt më 10 qershor 2018, në 140 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, për herë të katërt me radhë, Shoqata për kulturë dhe art "Tradita" e ndau Çmimin kombëtar "Ali Vishko", të cilin e ka themeluar në vitin 2014. Pas shpalljes së konkursit dhe shqyrtimit të propozimeve të arritura, Komisioni përkatës kishte vendosur që Çmimi kombëtar "Ali Vishko" për vitin 2018 t'i ndahet

prof.dr. Reshat Nexhipit, me motivacionin për veprimtari jetësore dhe arritje të veçanta në fushën e shkencës, arsimit dhe kulturës shqiptare.

Pas pranimit të Çmimit kombëtar "Ali Vishko", prof.dr. Reshat Nexhipi, këtë çmim e cilësoi të veçantë dhe kurorëzim të punës së tij, brenda të cilit qëndron biografia e tij tetëdhjetëvjeçare. Çmimin "Ali Vishko" deri më tani e kanë fituar edhe prof.dr. Avzi Mustafa (2015), prof.dr. Remzi Nesimi, tashmë i ndjerë (2016) dhe prof.dr. Tahir Zajazi (2017). Profesor Reshat Nexhipi aktualisht jeton dhe vepron në qytetin e Alfabetit të gjuhës shqipe, në Manastir dhe konsiderohet simbol i gjallë i këtij qyteti historik të shqiptarëve. Edicioni i V i manifestimit kulturor "Lidhja na bashkon" përfundoi me programin artistik, në kuadër të të cilit u interpretuan pika muzikore-artistike, nga Biondina Selami - në piano, Teuta Emini - në flaut dhe Shkelzën Pajaziti - në violinë. Vargjet me motive historike-kombëtare të shkruara nga poetë e shkrimtarë të njohur të letërsisë shqiptare, si Ali Podrimja, Bardhyl Londo dhe Mitrush Kuteli, i lexuan profesoret dhe gjuhës dhe të letërsisë shqipe, Zejnepe Alili - Rexhepi, Donika Baku, Muhabije Fejzuli dhe Valdeta Dulahi. Manifestimi kulturor "Lidhja na bashkon" u realizua me mbështetjen financiare të Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë dhe mbështetjen e Universitetit të Tetovës, Komunës së Tetovës, sipërmarrjeve të njohura shqiptare "Zgjimi Kompani" dhe "STR Komjuters".

Panairi i Prishtinës shkrin hartën e çmimeve letrare mes dy vendeve

Për pesë ditë në Prishtinë, libri shqip, në përpjekje për të ndërtuar marrëdhënien e tij delikate kur vjen puna te komunikimi, ndonëse për herë të parë duket se vjen një leksion në këtë vit jubilar, duke u reflektuar në hartën e ndarjes së çmimeve të këtij panairi... Është viti i 20-të që kryeqyteti i Kosovës, tashmë një institucion i konsoliduar i një "tregu" më të madh shqip për librin, por ende të pavlerësuar mes njëri-tjetrit, e sidomos politika.

Por nga reflektimet mediatike duket se edhe në Kosovë ashtu si në Shqipëri vazhdojnë të përcillen autorë me "porosi" duke gjeneruar gjithnjë e më pak çfarë është produkt letrar bashkëkohor, më evident. Në gjithë këtë përpjekje, or-



ganizatorët kanë njoftuar se në këtë edicion kanë marrë pjesë rreth 100 botues nga gjitha trevat shqiptare dhe diaspora, ndërsa botimet e reja kanë mbërritur në shifrën 1500 tituj të rinj. Mes këtyre shifrave një natë më parë, Panairi i 20-të

i librit ka vlerësuar letërsinë më të mirë mes dy vendeve, Kosovë e Shqipëri, çfarë kjo e fundit rrallë shfaqet me agjendë nga përtej kufirit, për ta marrë në konsideratë. Romani "Vegim" me autor Ardian Haxhajn, morri r çmimin për "Ro-

manin më të mirë" në edicionin e sivjetmë të Panairit të Librit "Prishtina 2018". Ky roman shpërfaq dhimbjen e njeriut përballë terrorit dhe kaosit. Është një refleksion për traumën kolektive të një shoqërie të rrënuar nga dhuna.

Juria, në përbërje të Behar Gjokës-kryetar dhe anëtarëve Abdullah Zeneli e Izet Sylja, dha këto çmime:

Çmimin për "Përkthimin më të mirë" ia ka ndarë Mal Berishës për përkthimin e librit "Naltësimi i Iskanderit".

"Autori i vitit", sa i përket letërsisë shqipe, është shpallur Adem Gashi për veprën "Drenusha e trembur dimrash", ndërsa sa i përket letërsisë së huaj, ky çmim i ka

tuar francezit François-Henri Désérable për veprën, "Njëfarë Z. Piekyliny", botuar në shqip nga shtëpia botuese "Buzuku".

"Çmimin special" e ka fituar aktori e shkrimtari Çun Lajçi.

"Letërsinë për fëmijë": Viktor Canosinajt.

"Çmimin për poezi": Majlinda Nana-Ramës me librin "Lulet e egra".

"Çmimin për kritikë e publicistikë": Ardian Vehbiut me librin "Fjalë për fjalë".

"Çmimin për vepër të veçantë": Ermira Gjonmaqit për librin "Përtej harrimit".

Stenda më e vizituar është shpallur ajo e shtëpisë botuese "Artini" nga Prishtina.

Dostojevski: Çfarë të bëjë romancieri me njerëzit ordinerë?

"Ka njerëz, për të cilët vështirë është të thuash ndonjë gjë të tillë, që t'i përfaqësojë njëherazi dhe tërësisht në pamjet e tyre më tipike dhe karakteristike. Këta janë ata njerëz, të cilët zakonisht i quajmë njerëz të "rëndomtë", "shumica" dhe të cilët, vërtetë përbëjnë shumicën e madhe të çdo shoqërie.

Shkrimtarët në romanet dhe novelat e tyre përpiqen në pjesën më të madhe të marrin tipa të shoqërisë dhe t'i paraqesin ata në mënyrë të figurshme dhe artistike, - tipa që në realitet hasen rrallë tërësisht dhe të cilët janë pothuajse më realë se vetë realiteti.

Para nesh ngrihet pyetja: çfarë të bëjë romancieri me njerëzit ordinerë, krejtësisht të rëndomtë, dhe si t'i paraqesë para lexuesit, që t'i bëjë ata diçka më interesante? Ata nuk duhen lënë kryesisht mënjanë në tregim, sepse njerëzit ordinerë janë në çdo çast dhe në pjesën më të madhe hallkë e domosdoshme në lidhjen e ngjarjeve të përditshme. Duke i lënë mënjanë ata, në këtë mënyrë do të prishim mundësinë për të realizuar një ngjarje, me një fjalë, prishim probabilitetin.




Të mbushësh romanet vetëm me tipa ose madje thjesht për interes me njerëz të çuditshëm dhe të pazakontë, do të ishte, e pamundur, dhe, besoj, dhe jo intere-

sante.

Sipas nesh, shkrimtari duhet të përpiqet të gjejë nuancë interesante edhe midis ordinerëve. Kur, për shembull, thelbi i disa njerëzve ordinerë pikërisht kur mbledhet në të zakonshmen e përhershme dhe të pandyshueshme të tyre ose, akoma më mirë, kur, pavarësisht përpjekjeve të jashtëzakonshme të këtyre njerëzve për të dalë me çdo kusht nga rrjedha e të zakonshmes, e rutinës, ata megjithatë përfundojnë në atë, që mbeten të pandryshuar dhe përjetësisht vetëm me rutinën, atëherë persona të tillë marrin tipikën e një lloji të veçantë, - të zakonshmen, e cila kurrsesi nuk dëshiron të mbetet ajo që është, dhe me çdo kusht kërkon të jetë origjinale dhe e pavarur duke mos pasur as mjete më të vogla për pavarësi.

Në të vërtetë, nuk ka gjë më të hidhur, se të jesh, për shembull, i pasur, nga familje e mirë, me pamje të hijshme, i arsimuar jo keq, jo pa mend, madje dhe shpirtmirë dhe në të njëjtën kohë pa pasur asnjë talet, asnjë veçori, madje asnjë tekë, asnjë ide tënden, të jesh krejtësisht "si të gjithë".



Pse "Alkimisti" i Paulo Coelho, pëlqehet kaq shumë?

Që nga momenti i botimit të tij, ky libër është ndër të preferuarit e shumë lexuesve. Mund ta gjeni në krye të listave me librat më të mirë. Në pak faqe Paulo Coelho ka pasur mundësinë të rrembejë zemrat e lexuesve dhe padyshim kjo vjen për disa arsye. Nuk ka të bëjë aq shumë fjalori i pasur i autorit, pasi në të gjitha veprat e tij vihet re ky detaj mjaft i rëndësishëm, sa ka të bëjë mesazhi i fuqishëm që përcillet përmes veprës "Alkimisti". Autori na tregon dëshirat më të rëndësishme që burojnë nga zemra e një njeriu. Ai është në vetvete një libër i thjeshtë, por me thënie dhe vërtetësi të shumta, aq sa një lexues e gjen veten duke nënvijëzuar dhjetëra fjali të preferuara në libër.

Të gjithë ne kemi pasione dhe dëshira, disa prej të cilave i fshehim nga sytë e botës për shkak të frikës se mund të na tallin, ose për shkak të frikës prej dështimit në rrugën e realizimit të tyre. Libri na tregon pikërisht se sa e rëndësishme është të ndjekim ëndrrat tona, pa e vrarë mendjen se çfarë mendojnë të tjerët rreth nesh. Është historia e njerëzve të ndryshëm, disa prej të cilëve e mundën frikën dhe ia dolën t'i realizonin ëndrrat e tyre dhe disa të tjerë u mundën nga presioni dhe jetuan një jetë në përpjekje për të ndryshuar sipas "rregullave" që bota kishte vendosur në vite. Gjithashtu libri trajton edhe disa parime universale që kanë ekzistuar që nga fillesa e botës. Këto janë më të rëndësishmet:

Ligji i tërheqjes: Në botën e Rumit, çdo gjë që ti je duke e kërkuar, është duke të të kërkuar edhe ty. Thjesht duhet ta kërkojë atë fuqishëm që ajo të vijë në jetën tënde.

Dashuria e vërtetë të lejon t'i ndjekësh ëndrrat e tua: Nëse ke përjetuar dashuri të vërtetë, ajo do të të presë edhe nëse ti largohesh. Nëse ka qenë thjesht një shkëlqim i momentit, ky libër do të të bëjë të kuptosh se nuk ia vlen të luftosh për të.


Riorganizon perspektivat: Jeta nuk do të të trajtojë përherë me përzemësi, pasi kjo gjë nuk është pjesë e natyrës së saj. Por nëse ti i ndryshon perspektivat në varësi të situatave që të ofrohen, ke për ta gjetur një mënyrë për t'ia dalë mbanë.

Perfeksioni është iluzion, mos prit për të: Nëse gjithnjë pret për momentin perfekt, për mënyrën perfekte, nuk ke për të arritur gjëkund. Fillo dhe bëje çfarë do. Edhe nëse gabon, mëso se gabimet janë mënyra më e fuqishme për të mësuar.

Frika është pengesa më e madhe, se gjithë pengesat e tjera. Pengesat që të vendosin njerëzit në këtë botë, nuk krahasohen me pengesat që ti i vendos vetes me mendjen tënde. Mos e lejo trurin tënd të të ndalojë për të bërë gjërat që ke dëshirë të bësh.

Libri "Alkimisti" nga Paulo Coelho është nga ata libra që ecin shpejt në të lexuar, ndaj jepi vetes një mundësi dhe lexoje. Në fund, nuk ke për t'u zhgënjyer.

Orhan Pamuk: "Romanet i kam të gjata, por unë do të flas shkurt"



Në fjalimin e mbajtur me rastin e dorëzimit të Çmimit Nobel në Letërsi apo edhe në dalje të tjera publike, Pamuk flet për eksperiencën e të qenit shkrimtar, për nevojën dhe vështirësinë që has në këtë profesion. Këshillat e tij janë konkrete, njerëzore dhe shumë larg absurdit dhe pesimizmit që haset te shumë shkrimtarë të tjerë. Ja çfarë thotë Orhan Pamuk për punën e shkrimtarit:

"Shkruaj sepse nuk mund ta duroj ndryshe realitetin, përveçse duke e ndryshuar".

"Shkruaj sepse kam frikë të jem i harueshëm".

"Shkruaj jo për të rrëfyer histori, por për të ndërtuar histori".

"Mbas çdo romani, është një shkrimtar i zënë pas dëshirës, që ta përfytyrojë veten si tjetërkush, është një krijimtari që po i dhunon kufijtë e vet".

"Të jesh shkrimtar, do të thotë të zbulosh me durim, përgjatë viteve, njeriun e

dytë, të fshehur, që jeton brenda teje, dhe një botë që pjell botën tonë të dytë".

"Të shkruash, do të thotë të përkthesh në fjalë këtë vështrim të brendshëm, të hysh në brendësi të vetes e t'i gëzoesh lumturisë së të hulumtuarit me durim e këmbëngulje të një bote të re".

"Për mua, e fshehta e profesionit të shkrimtarit nuk qëndron te ndonjë frymëzim me origjinë të panjohur, por te këmbëngulja dhe durimi".

"Për t'u bërë shkrimtar, duhet të kesh, përpara durimit dhe shijes së ndalimit të kënaqësive, një instikt për t'i ikur turmës, shoqërisë, jetës së rëndomtë, gjërave të përditshme e të përbashkëta për të gjithë dhe për t'u mbyllur në një dhomë".

"Besoj se letërsia është vepra më e çmuar që njerëzimi i ka dhënë vetes për të kuptuar vetveten. Letërsia është arti i dijes së të folurit për historinë tënde, si për historinë e të tjerëve, dhe për historinë e të tjerëve, si për vetë historinë tën-

de".

"Kisha një kureshtje të pangopur dhe universale dhe një etje të shfrenuar dhe naive për të mësuar. Nga ana tjetër, e ndjeja se jeta ime ishte e destinuar të mbetej e pakënaqur, pa disa gjëra që u janë dhënë të tjerëve".

"Të shkruarit dhe të lexuarit ishin pak a shumë, mundësi për të dalë nga një botë dhe për të gjetur ngushëllimin nëpërmjet diferencës, huajësisë dhe krijimtarive gjeniale të tjetrit".


"I kam ndjerë disa herë në vetvete ndjenjat e dashurisë e të urrejtjes që Dostojevski i ka provuar gjatë gjithë jetës së tij ndaj Perëndimit. Por ajo ç'kam mësuar vërtet prej tij, një burim i vërtetë optimizmi për mua, është bota krejt ndryshe nga ajo që ky shkrimtar i madh ka themeluar, duke u nisur nga marrëdhënia e tij e dashurisë dhe e urrejtjes me Perëndimin, por, duke e tejkaluar këtë marrëdhënie."

Beqir Musliu – letërsia emri i tij

Shkrimet e Beqir Musliut janë të një niveli të lartë dhe përdorin me mjeshtri të madhe metaforat dhe simbolet, andaj mund të quhet edhe shkrimtar i simboleve.

Me veprën e tij, mund të flitet për një rumbullakim të artit si tërësi (poezi, prozë, dramë, kritikë, publicistikë, etj.), duke i përthyer limitet tradicionale mes gjinive, llojeve, zhanreve letrare, që ai arrin te Vegullia, si dhe me romanin "Amullia", i cili priti ta shoh dritën vetëm pas një çerek jetë njeriu. Beqir Musliu gjatë viteve sa punoi, krijoi dhe editoi për revistën "Jeta e Re" me E. Mekulin, R. Qosjen, si edhe te "Fjala" e "Zëri i Rinisë", Prishtinë. Ai mbeti deri në fund një libër i hapur, përkundër asaj se iu muar për të madhe "formula e tij e një tipi më të mbyllur", ndonëse ishte e qartë se e shkruar në "kohë të pakohë".

Në çerekun e fundit të jetës së tij, ai i solli letrave shqipe edhe përmbledhjet me poezi "Sezamet" - '72, "Parabolla" - '76, "Darka e magjisë" - '78), romanet "Vegullia" - '79, "Mbledhësit e purpurit" - '82, sikur edhe tri të tjerat të shoqëruara me tetë dramat, përmbledhur në librin "Shtrigani i Gjell-hanit" - '89 dhe "Rrokullima" - '90. Megjithatë opus të gjer të art-jetë-shkrimit Ai, ka ndërruar vetëm dhomën me 11 qershor 1996, për të cilin jeton vepra e tij. Pas vdekjes Beqës, iu botuan edhe shtatë veprat e tij, njëra nga ato vepra është edhe përmbledhja me tregime të dala nga prozat tregimtare, "Kori i gjelave të vdekur", sipas përzgjedhjes dhe shijes artistike të atyre letrave që na i la në dorëshkrim, si borxh për t'ia botuar me amanetin e tij, nën përkujdesjen e Musa Ramadanit. Dhe, në mesin e atyre tregimeve është edhe "Arkivoli për Sadek Hadajatit", (Jeta e Re, 1996) në të cilin më së shumti reflektohet qenia e tij, krijuese, fati i shkrimtarit të përndjekur që fati i popullit të tij dhe kohës që jetoi. Qosja e ka pas cilësuar Musliun se: "Ai ishte nga të parët që bukurinë si kategori estetike e futi edhe korniza të errët ("Bukuria e Zezë" - '68)", duke i vënë bazat e një identiteti të përparuar të letrave shqipe. Shi për këtë, Rexhep Qosja me të drejtë e rreshtoi vazhdimësinë dhe këmbëngulësinë dhe frymëzimin e tij prej shëmtive dhe kategorive negative njeriun mund të vijë në përfundim se kjo vërtet, është bota reale dhe më afërt me prijen e tij krijuese ... Këtu duhet theksuar gjerësinë e problematikës, seriozitetin e meditimeve, shfrytëzimin e qëlluar të legjendave dhe të simbolikës kombëtare, mjeshtërinë e organizimit kuptimor në ërgjithësi ("Sezam", R. Qosja) / Nijazi Ramadani



BEQIR MUSLIU

HAMAMI I GAZI MEHMET PASHËS

*Një dorë e padukshme më shoqëroi
Nëpër honet e bukurisë së fshehtë Tha
Ky është Hamami i Gazi Mehmet Pashës
Mund të hysh Mund të dalësh Mund të hysg
Të mos dalësh Të mos hysh Të mos dalësh
Kurrë Dora m'u ngri Nuk dija Cila ishte
Ajo dorë Ajo që më shoqëroi deri këtu
Apo dora ime Përse gjithë ajo ftohtësi
Kur aty janë larë zonjat më të bukura
Të Prizrenit që ende dëgjohe shushurima
E tyre dhe dihatjet deri në epshin e shfrenuar
Hamami është fshehur nën klepsidër
E Ç'bëri Gazi Mehmet Pasha në Hamamin e tij
Pa ëndërr se aty fshihej vdekja Aq e bukur
Në trajtën e një vashe të hyjnueshme Ishte
Larë me të Ç'ndodhi pastaj Në vend
Të këmishës së natës kishte veshur qefinin
Ishte kthyer në botën tjetër për t'i përkujtuar
Të gjitha ato që s'i përjetoi në këtë botë
Vdiq nga bukuria*

*Ç' Hamam i çuditshëm Këtu fshehtësia
Ndryn diçka të tmerrshme që s' mund të fshihet
As të thuhet me fjalë*

*Laju në këtë Hamam dhe dil i pastër në botë
Aty të pret Gazi Mehmet Pasha Që emër la
Këtu Që ta përkujtojmë me aq fshetësi
Ashtu siç na pret ky Hamam Eu
Gazi Mehmet Pasha Eu*

MBASLOJA E PRIZRENIT

*Unë jam në Prizren edhe kur s'jam në të
Ti më merr dhe m'i zhvesh rrobat The Të jesh
I pastër ma rregullon grimin dhe krejt atë
Që shkon me të Prizreni më mbeti matanë Them
Më kthejnë sërish aty ku isha Prizren Unë*

*Jam Ai Që (S) Jam Kur Jam Prizreni Imzot
Nga dora ime krijuan një statujë antike
Më lanë në Muzeum që e pushtonte qetësia Thanë
Këtu çdo gjë që (s) ishte Lojë vazhdon të jetë
Si diçka që shekujt e sfiduan nëpërmjet teje
Zbrit më poshtë Ja Ku Jam Në Prizren
Aty më ke edhe mua A nuk të thashë se unë jam Ai
Që (S) Jam Mund të më ngatërrosh me engjëllin tënd
Tekanjoz që shëtit në vend teje nëpër muret
E qetësisë Kërkon një afreskë që të gjason ty
Të mund të të shenjtërojë në mënyrën e vet
Vishni rrobat e mia të vjetëruara Dua ta shijojë
Bukurinë ashtu siç është Loja mbaroi
Edhe për një milienum të heshtjes Ajo që po
Ndodhë këtu është vetëm një variant i saj
Që njëherë ka ndodhur Ç' u bë Prizreni
Ai është në mua Thashë Prizreni*

(Prizren, 11 janar 1986)

MAZHI I PARË

*I rrethuar nga çdo gjë që s'është në këtë ditë
Përbirohet fare i pavërejtur
Midis sheshit e mbathin këmbët e zbathura
Të atyre që asnjëherë s'e hetuarn rrethimin
As aromën e trëndafilave që zihet ngadalë
Derisa majave të gishtave merr gjuhë lulëzimi
Mrekullitë hyjnë ta nxjerrin nga kornizat që s'e ka
Të cilën s'di përse nuk e ka Ose e ka përse s'di
Derisa matet me butësitë e veta të gurëzuara
Të cilat edhe në vete ka mundur t'i vrasë
Në shuplake i zbret dielli i zënë në kornizë rob
Për t'i ulur Orët e vona që kurdisin bukurinë
Sa thahet blerimi i murmë në fytirën time
Shirat e kthejnë verdhomë në mua kur zgjohem
Të krijoj ngjyrën për të mbaruar imazhin
Në të cilin balta ka zënë t'i çelë zogjtë magjikë
E të vërshojë qytetin që e kam vetëm në shuplakë
T'i fus në vargonj mbretëritë e zgjebosura
në Fushë
Kur fare i pavërejtur përbirohet përmes syve të mi
Nga çdo gjë që s'është në këtë ditë të rrethuar.*

“SHQIPËRIA DHE “TOKAT E LIRUEME”, 1939-1946”

Në Tiranë, historiani Romeo Gurakuqi sapo ka botuar studimin e tij shumëvjeçar, “Shqipëria dhe Tokat e Lirume 1939–1946”. Libri bazohet në mijëra dokumenta amerikane e britanike, italiane e gjermane, të lëna pas dore nga historiografia komuniste. Ai përshkruan me detaje Shqipërinë e Luftës së Dytë dhe instalimin e regjimit komunist në Tiranë me ndihmën e komunistëve jugosllavë. Studimi tregon një mori ngjarjesh tragjike që ndodhën në Kosovë e Çamëri dhe që shkaktuan ndarjen e tyre të dhunshme nga Shqipëria.

Ky studim voluminoz autorit i kanë marrë 8 vite punë, 5 nga te cilat në mënyrë të pandërprerë. Këtë libër, thotë autori, ua kushtoj brezave shpresëhumbur, etërve tanë, intelektualë dhe patriotë, të cilëve iu mohua atdheu, iu privua liria, iu vodh jeta, heronjve të disidencës që s’i lanë të jetojnë për t’na rrëfyer dhe dëshmuar tragjedinë që përjetonte Shqipëria... Kopertina është realizuar nga Jozef Martini



ndërsa faqosja: Meritan Spahija. Shtëpia botuese Jozef, Durres”.

Kjo monografi ka në fokus të shqyrtimit, Historinë e Shqipërisë dhe të “Tokave të Lirume” gjatë periudhës së viteve 1939 – 1946, dhe ndahet në tre faza studimore: 1. Periudha e pushtimit nga Italia Fashiste; 2. Periudha e pushtimit gjerman; 3. Periudha e pasqirimit, ose e vendosjes së regjimit të terrorit komunist. Studimi mbyllet me ngjarjet në Shqipëri dhe për Shqipërinë gjatë vitit 1946.

Vepra është një rishkrim dhe kritikë e trajtimeve të deritanish-

me të kësaj periudhe të Historisë së Popullit Shqiptar, duke ofruar fakte të reja, një dokumentacion të ri, interpretime të reja, këndvështrime origjinale dhe metodologji bashkëkohore të hulumtimit, bazuar mbi parimin e kryqëzimit të dokumentacionit të ardhur nga jo më pak se dy burime të pavarura. Punimi është i bazuar krejtësisht mbi burime arkivore, ku veçohen National Archives në Londër, National Archives në SHBA, Arkivi Qendror i Shtetit e Republikës së Shqipërisë, Archivio Storico Diplomatico del Ministero

degli Affari Esteri (Romë), Archivio Centrale dello Stato (Romë), Ufficio Storico dello Stato Maggiore dell’Esercito (Romë) etj.

Studimi përfshin historinë e shtetit shqiptar dhe të “Tokave të Lirume” (trojeve etnike shqiptare jashtë kufirit shtetërorë të vitit 1921), si dhe historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare për Shqipërinë, në harkun kohor 1939-1946. Përcaktimi “Toka të Lirume” është një term i kultivuar kryesisht nga politika fashiste italiane, por i bazuar në një realitet ndarjeje territoriale të trevave të banuara nga shqiptarët dhe mbi një aspiratë historike të nacionalizmit shqiptar. Ai term nënkuptonte Kosovën, Çamërinë, Malësinë, Ulqinin, Tivarin, Anën e Malit, Krajën, Dibrën, Tetovën, Gostivarin, Shkupin, Strugën. Pas muajit prill të vitit 1941, ky bashkim u bë një realitet dhe jeta politike, ekonomike, kulturore dhe sociale shqiptare, u zgjerua në një hapësirë shumë më të gjerë në Ballkan. “Shqipëria dhe “Tokat e Lirume”, 1939-1946 është

një histori e jetës dhe e fatit të shqiptarëve në vitet e Luftës së Dytë Botërore dhe në 15 muajt pasues të kësaj kohe dramatike, të cilat për këtë komb qenë edhe më tragjike, nga pikëpamja e humbjeve njerëzore dhe shkatërrimit të perspektivës së bashkimit dhe europianizimit.

Studimi është një përpjekje për themelimin e një të Kaluare të Re mbi Luftën e Dytë Botërore në tokat shqiptare, një punë e nisur me objektivin e dhënies së një kuptimi të plotë dhe të gjithanshëm të revizionimit historik. Në këtë proces autori ka ndjekur një Hartë të Kuptimeve të Historisë së Shqipërisë, për këtë periudhë aq të debatuar. Kjo hartë do t’i shërbejë lexuesit, kurikulës shkollore, dhe do të mundësojë procesin e legalizimit dhe nderimit të personazheve të lëvizjes për liri, do të përmirësojë ndjekjen e proceseve rehabilituese, njëlloj siç kanë vepruar të gjitha vendet e tjera të europianizuara dhe histori të ngjashme.

“100 vjet vetmi”: si e rindërtoi Marquezi gjenezën e një kontinenti?

Kur Gabriel Garcia Marquez shkroi “Njëqind vjet vetmi”, ai rimagjinoi gjenezën e kontinentit të tij. Kjo pati ndikim të vërtetë politik.

Përpara “Njëqind vjet vetmi”, Amerika Latine kishte disa ngjashmëri me vendin e imagjinuar të përshkruar në paragrafin e parë të romanit: “Bota ishte kaq e re, sa që shumë gjëra nuk kishin emra, dhe në mënyrë që t’i tregojë, ishte e domosdoshme të drejtoje gishtin”. Kontinenti, sigurisht, që nuk ishte një vend i ri kur Gabriel Garcia Marquez shkroi romanin e tij të vlerësuar: autorët e njohur si Kronistët e Indive, gjatë shekujve të XV-të dhe XVI-të kishin ndërmarrë detyrën e përshkrimit të tokës; ata emërtuan gjërat e panjohura ndërkohë që i shihnin për herë të parë. Shumë dekada më vonë, Marquezi u nis për një Zbulim të dytë të Amerikës.

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 20-të, Amerika Latine kaloi përmes një periudhe plot konvulsione. Disa vende – si Kili, Kolumbia dhe Meksika – po përballëshin me paqëndrueshmërinë, diktaturat dhe dhunën politike. Kjo çoi në ndryshime sociale të mprehta e shpesh edhe konfuze, përfshirë Revolucionin Kubanez, të drejtuar nga Ernesto Che Guevara dhe Fidel Castro. Kur Marquezi ishte në fazat e para të sagës së tij të pakufij, ai u tërhoq shumë nga kthesa e ngjarjeve në Kubë. Ajo që e goditi atë më shumë ishte mundësia reale për një rend të ri për vendet në këtë pjesë të hemisferës, larg nga presioni dhe kërkesat e Shteteve të Bashkuara.

Shumë intelektualë – Mario

Vargas Llosa, Jean-Paul Sartre, Albert Camus dhe Simone de Beauvoir, mes të tjerësh – ndanin të njëjtin entuziazëm si ai. Sidoqoftë, në vitet që pasuan, pjesa më e madhe e tyre u zhgënjyën dhe e distancuan veten nga modeli kuban. Por është e pamohueshme që revolucionin pati një ndikim madhor në tonalitetin e “Njëqind vjet vetmi”: ai i dha Marquezit shpresë për fatin e Amerikës Latine.

Duke shkruar kryeveprën e tij, pavarësisht, nuk ishte e lehtë. Në atë kohë, ai po jetonte me Mercedesin, gruan e tij dhe dy djemtë e tyre, Rodrigon dhe Gonzalon në qytetin e Meksikës. Ata ishin larguar nga Kolumbia për shkak se Garcia Marquez nuk ndjehej rehat me qeverinë e krahut të djathtë të vendit të tij. Ai po jetonte jashtë vendit – përpara se të vendosej në Meksikë, ai qëndroi në Karakas, Paris dhe Barcelonë – ndërkohë që nanuriste ambicjen për t’u bërë një romancier me famë botërore.

Por, familja kishte vështirësi për të mbijetuar me rrogën e tij të ulët si korrespondent ndërkombëtar për një numër revistash e gazetash në gjuhën spanjolle. Librat e tij të mëparshëm kishin qenë mjaft të vlerësuar, por dështim nga ana e shitjeve. Marquezi e dinte se kishte në dorë një histori të madhe, por thjesht nuk po gjente dot rrugën e duhur për romanin epik që kishte në mendje.

Ekzistojnë shumë legjenda – të cilat në vazhden e jetës së tij, ai nuk u kujdes kurrë t’i konfirmojë apo mohojë – për atë sesi e gjeti frymëzimin dhe sesi e tejkaloi ngërçin e


shkrimtarit që e kishte përndjekur. Varet se kë zgjedh të besosh. Një prej tyre është ai në biografinë e mrekullueshme të Gerald Martin: “Ai u nis së bashku me familjen për pushime plazhi në Akapulko, një ditë rrugë në jug. Në mes të rrugës, ai ndaloi makinën – një Opel i bardhë i 1962-it me sedilje të kuqe – dhe u kthye pas. Vepra e tij e ardhshme i kishte ardhur papritur. Për dy dekada, ai kishte tërhequr e shtyrë për ta nxjerrë rrëfimin për një familje të madhe në një fshat të vogël. Tani ai mund ta shihte në mendje me qartësinë e një njeriu, që duke qëndruar përpara skuadrës së pushkatimit, e sheh jetën e vet në një moment të vetëm”.

Sipas Martinit, Mercedes e anuloi menjëherë pushimin e fundjavës. Ata u kthyen në shtëpi dhe ajo i tha të niste të shkruante. Ajo do të kujdesej për shpenzimet e jetës familjare sa kohë ai ishte i fokusuar tek romani i ri. Kështu veçoi: ai e injoroi realitetin dhe shkroi – sunduar nga personazhet që kishin qenë duke pëshpëritur historitë e tyre në veshët e tij që kur ai ishte një fëmijë i vogël – për tetë muaj rresht. Ajo që erdhi më pas, tashmë është rrëfyer aq shpesh sa mërzhitesh. Saga e familjeve Macondo dhe Buendía u bë menjëherë një klasik modern, shpesh krahasuar me veprat e Servantesit dhe Shekspir. “Është libri që përcaktoi jo vetëm letërsinë e Amerikës Latine, por letërsinë e pikël”, shkroi Ilan Stavans, akademiku i njohur i kulturës latine në Shtetet e Bashkuara, i cili pretendon se e ka lexuar librin 30 herë. Garcia Marquez nuk ishte

as historian e as sociolog. Ai ishte një rrëfimtari natyral. Ai mund të shihet si një prizëm. Ai ishte në gjendje të konvergojë një sasi të jashtëzakonshme informacioni dhe ta shndërronte atë në një mitologji të re. Kjo ishte mjeshtëria e “Njëqind vjet vetmi”: ai mori nga burime të ndryshme për të krijuar një lindje alternative, hiperbolike të kulturës së Amerikës Latine. Dhe duke bërë këtë, ai e ri-interpretoi natyrën e saj.

Gabo – siç e thërrisnin miqtë dhe familja – po ashtu zotëronte aftësinë të tregonte këto histori si nuk e kishte bërë kush më parë. Ai huazoi hapin dhe ritmin nga Valledupar, një muzikë tradicionale folklorike nga qyteti Valledupar, të cilat i kombinoi me mjetet e narrativës gazetareske. Garcia Marquez ishte po ashtu një reporter fantastik dhe këto aftësi ai i ndërthuri në prozën e tij. Kush ka punuar me të, e njeh mjaft mirë aftësinë e tij të jashtëzakonshme për të shndërruar hallet e jetës së përditshme në rrëfime magjike.

“Njëqind vjet vetmi” është një alegori e fuqishme e identitetit amerikano-latin. Historia, vendosur në një periudhë kohore prej një shekulli, eksploron shumë prej çështjeve kryesore në historinë e trazuar të rajonit: kuadilzmin (lidhshin e një njeriu të fortë), maçizmin, kryengritjet, pushtetin, epidemitë dhe dhunën politike. Por pavarësisht materialit të dendur social, Garcia Marquez e paraqet atë me humor dhe me një gjuhë të hollë e poetike. Dhe pas asaj që mund të jetë një afresk konfliktesh



sociale, ai ishte në gjendje të shohë bukurinë që shtrihet në gjithçka. Ashtu si ai tha vetë në fjalimin për çmimin e tij Nobel: “Pavarësisht shtypjes, plaçkitjes dhe braktisjes, ne përgjigjemi me jetë. As përmbytjet e epidemitë, uria apo kataklizmat, apo madje as luftërat e përvetshme shekull pas shekulli, nuk kanë qenë në gjendje të mposhtin avantazhin këmbëngulës të jetës mbi vdekjen”.

Ky portret mund të duket si karikaturë, por realizmi magjik ndërtohet mbi ekzagjerimin. Bota që Garcia Marquez krijoi është një pasqyrë e mrekullueshme në të cilën Amerika Latine është në gjendje të shohë të metat dhe virtytet e saj. Ashtu si ha edhe vetë në një intervistë me “The New York Times” në vitin 1988: “Mendoj se librat e mi kanë pasur ndikim politik në Amerikën Latine për shkak se kanë ndihmuar në krijimin e identitetit të Amerikës Latine; ndihmuan që latino-amerikanët të bëhen më të vetëdijshëm për kulturën e tyre”. Dhe tek kjo vetëdijë qëndron edhe pushteti i tij. /Përgatiti: Juli Prifti/

Në fillim të 2019-ës, do ta kemi armatën më të fuqishme në rajon



Qytetarët e Serbisë së shpejti do të mund të shohin sa të fuqishme e kemi shtrinë, sa më të fortë dhe sa më të mirë sesa diku, ka thënë kryetari i Serbisë, Aleksandar Vučić duke vizituar një shkollë ushtarake. Që në fillimin e vitit do ta kemi ushtrinë më të fuqishme në rajon, ka thënë Vučić, përcjell televizioni publik serb. Ai ka shtuar se Serbia tash investon shumë në ushtrinë e vet. Sipas tij, gjatë tri vjetëve të fundit buxheti ka qenë më shumë se 650 milionë euro në vit.

“Ne sot investojmë shumë më shumë, buxheti ynë ushtarak nuk është më 650 milionë euro, por shumë më shumë, për shkak se ne nga burime të tjera i ndajmë edhe 350 milionë euro shtesë, prandaj llogarisni se buxheti ushtarak ynë është 1 miliard ose më shumë se 1 miliard euro në vit”, ka thënë Vučić.

“Në fillimin e vitit të ardhshëm do t'i kemi 14 aeroplanë MIGË më modernë nga brezi i katërt, avionë luftë të brezit të katërt, helikopterët H-145 të blerë nga Gjermania e Franca e etj.

Qëndrimi për vizitë zyrtare në Shqipëri i një zyrtari nga Kosova, me një shpenzim ditor prej 209 eurosh bëhet më i leverdishëm sesa ai në Kanada, ku pavarësisht distancës, zyrtarët parashihet të paguhen me 180 euro në ditë. Kurse në një vend tjetër, në Evropë, si në Austri apo Danimarkë, qëndrimi brenda një dite për një zyrtar kosovar është 198 euro, respektivisht 179 euro, kurse në Gjermani 255 euro, përderisa në Australi 160 euro. Ndërkaq, mëditjet që kalojnë shumë prej 320 eurosh janë ato në Itali, Japoni dhe Izrael, ndërsa në Gjeorgji vizitat janë më shtrenjta, ku zyrtarët paguhen me nga 400 euro

Udhëtimet zyrtare jashtë vendit, mëditjet dhe numri i madh i të përfshirëve nëpër delegacione zyrtare, i kushtojnë buxhetit të Kosovës shuma të majme parash, që sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, përbën një luks më vete. Zyrtarët e shtetit më të varfër në Evropë edhe një dekadë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, vazhdojnë të shpagojnë me dokumentet e “siç quheshin dikur të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes”, që ishin hartuar dhe fuqizuar në kohën e administratës së Kombeve të Bashkuara, përkatësisht UNMIK-ut.

Për shkak të jotransparencës dhe mungesës së kontrollit të shpenzimeve, udhëtimet zyrtare dhe mëditjet, jo rrallë keqpërdoren nga zyrtarët, thonë përfaqësues të organizatave joqeveritare. Me paratë e buxhetit, këta zyrtarë, sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, marrin me vete këshilltarët, asistentët apo në disa raste edhe anëtarët e familjeve të tyre për t'i kryer obligimet zyrtare dhe për të “shijuar luksin”, duke u akomoduar nëpër hotele të shtrenjta në vende



QEVERIA E LUKSIT

të ndryshme të botës.

Njëherësh, për këto udhëtime, ata marrin edhe mëditje të mira nga buxheti, përkatësisht taksapaguesit e Kosovës. Artan Murati, analist nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë se është absurde që ende është në fuqi lista e mëditjeve e hartuar qysh në kohën e administratës së UNMIK-ut, në vitin 2004. Në bazë të kësaj rregulloreje, vlera e tarifave të mëditjeve për udhëtime zyrtare jashtë vendit, mëditjet janë më të larta për vizitat që bëhen nëpër vendet që shtrihen në hartën gjeografike më afër Kosovës. “Këtu mund të vërejmë diskrepancën e madhe në shumën e mëditjeve që marrin zyrtarët qeveritarë. Më tepër marrin mëditje për një udhëtim në Shqipëri sesa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Është absurde që shuma më e lartë e mëditjeve të jetë për në Shqipëri. Por, kjo është bërë enkas vetëm e vetëm për të përfutur sa më tepër, pasi numri i madh i takimeve deri më tani është zhvilluar në Shqipëri”, tha Murati për Radion Evropa e Lirë.

Në bazë të kësaj rregulloreje, qëndrimi për vizitë zyrtare në Shqipëri, me një shpenzim ditor prej 209 eurosh bëhet më i leverdishëm sesa ai në Kanada, ku pavarësisht distancës, zyrtarët parashihet të paguhen me 180 euro në ditë. Kurse në një vend tjetër, në Evropë, si në Austri apo Dani-

markë, qëndrimi brenda një dite për një zyrtar kosovar është 198 euro, respektivisht 179 euro, kurse në Gjermani 255 euro, përderisa në Australi 160 euro. Ndërkaq, mëditjet që kalojnë shumë prej 320 eurosh janë ato në Itali, Japoni dhe Izrael, ndërsa në Gjeorgji vizitat janë më shtrenjta, ku zyrtarët paguhen me nga 400 euro. Në këtë listë ende figuron edhe Jugosllavia, e cila tashmë nuk ekziston si shtet, ku parashihet mëditja prej 204 eurosh në ditë.

Duke marrë për bazë këto tarifa për mëditje, Qëndrim Bytyqi, zyrtar ligjor në organizatën joqeveritare “FOL”, thotë për Radion Evropa e Lirë se dokumenti i cili është hartuar në kohën e UNMIK-ut, gjithsesi duhet të ndryshojë. Përveç ndryshimit të vlerës së mëditjeve, ai thotë se duhet të specifikohet edhe arsyeja e pjesëmarrjes së zyrtarëve në udhëtime jashtë shtetit.

“Sepse ne jemi dëshmitar që në shumicën e rasteve këto mund të shfrytëzohen edhe për qëllime turistike dhe këto mbulojnë nga taksapaguesit. Prandaj, këto duhet të ndryshohen duhet të dihet saktë qëllimi i vizitës zyrtare dhe të caktohet numri dhe mos të shkohet numër aq i madh. Ka pasur raste kur në një delegacion kanë marrë pjesë deri në 60 zyrtarë, për të cilët janë shpenzuar mjete të mëdha nga buxheti, e të cilat kanë mund

të përdoren për projekte tjera më të mira”, tha Bytyqi. Ndryshe, edhe Auditori i Përgjithshëm, në një shkresë dërguar kryeministrit Ramush Haradinaj, ka kërkuar vëmendje për trajtimin me prioritet nga ana e Qeverisë të Udhëzimit Administrativ 2004/2007 për udhëtimet zyrtare. Ky udhëzues, sipas Auditorit të Përgjithshëm, nuk i përgjigjet kërkesave të kohës dhe si i tillë nuk kontribuon në menaxhimin e rregullt, të shëndoshë dhe të mirëfilltë të parasë publike. Sidoqoftë, përveç të drejtës së kompensimit material për mëditje gjatë udhëtimeve zyrtare, disa nga zyrtarët e shtetit, si domos deputetët e Kuvendit të Kosovës, krahas pagës mujore, marrin edhe të ardhura shtesë për pjesëmarrje në seancat dhe komisionet e Kuvendit, mbulimin e shpenzimeve për telefona dhe derivate të naftës dhe për punën në trupa të tjerë jashtë veprimtarisë së rregullt të tij.

Të 120 deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, përveç pagës mujore prej rreth 1500 eurosh në muaj, për dy seanca gjatë muajit, ata marrin 240 euro. Kurse, për pjesëmarrjen në mbledhjet e komisioneve parlamentare, fitojnë shtesa prej 160 eurosh. Kështu, si tërësi, të ardhurat mujore të deputetëve, përfshirë edhe mëditjet, arrijnë apo edhe e tejkalojnë shumë prej 2000 eurosh. (REL)

Serbia paradite me BE-në, pasdite me Rusinë

Nënkryetarja e Qeverisë së Serbisë Zorana Mihajloviq ka deklaruar se kjo qeveri nuk do ta ndryshojë drejtimin strategjik të vendit, e ai është Bashkimi Europian duke shtuar se të gjithë ata që e udhëheqin vendin, duhet ta dëshmojnë më qartë këtë politikë, transmeton Koha.net.

“Duhet t'i ikim situatës në të cilën para dite duam në BE e pasdite me Rusinë. Askush nuk na ndalon të bashkëpunojmë me Rusinë, askush asnjë serbi nuk mund t'ia marrë të drejtën që ta dojë Rusinë dhe të na detyrojë ta anu-

lojmë historinë. Por, udhëheqja e shtetit bëhet me kokë e jo me zemër. Rusia do të jetë gjithmonë në zemër, e koka do të jetë Europa, Perëndimi”, citon “blic” të ketë thënë Mihajloviq. Sipas saj, Serbia dëshiron kompromis për Kosovën, jo për shkak që të merret bileta për hyrje më të shpejtë në BE, por për shkak se nga zgjidhja e saj varet e ardhmja e Serbisë.

“Konflikti i ngrirë i Kosovës, do ta ngrijë Serbinë e cila nuk do të mund të zhvillohet. Zgjidhjen nuk do të na e sjellin as Rusia dhe as Amerika, atë duhet ta bëjmë vetë.

Ose ndoshta mund të presim që të na bjerë ndonjë gjë nga qielli derisa edhe serbi i fundit të largohet nga Kosova”, ka thënë Mihajloviq.

Ajo ka theksuar se në bazë të sjelljes së Vojislav Sheshelit mendon se ai po ia përgatit një të keqe kryetarit të Serbisë, Aleksandar Vuçiqit, transmeton Koha.net. “Po shikoj me vëmendje çfarë po bën Shesheli dhe nuk mund ta heq nga mendja se ai po ia përgatit një të keqe Vuçiqit. Sepse, si të interpretohen ndryshe provokimet e tij të rrezikshme nacionaliste dhe vizita që ua bëri vrasësve të Gjingji-



qit. Dhe tash i pret Legian e Zvezdanin për ta mbrojtur Kosovën! Atë që e ka mbrojtur Shesheli, ai

tash nuk jeton më në shtëpi të vet”, ka thënë ndër të tjera Mihajloviq.

Italia i mbyll portet për anijen e shpëtimit të imigrantëve

Një anije shpëtimi në të cilën gjenden 629 imigrantë është bllokuar në Mesdhe, pasi ministri i Brendshëm Italian, Mattteo Salvini, ka refuzuar lejen e zbarkimit. Salvini, lideri i krahut të djathtë, Liga, ka thënë se Malta duhet të pranojë anijen Aquarius, mirëpo deklaratat e tij janë kundërshtuar. Malta ka thënë se shoqata bamirëse, SOS Méditerranée, ka marrë imigrantët në ujërat e Libisë, që do të thotë se të njëjtit janë përgjegjësi e juridiksionit të Italisë. Italia është territori kryesor, përmes së cilit imigrantët kalojnë nga Afrika Veriore në Evropë. Partia Liga u ka premtuar votuesve gjatë zgjedhjeve të përgjithshme se do të ketë qasje të ashpër ndaj imigrimit. SOS Méditerranée, e cila drejton anijen Aquarius, ka thënë se ka mbledhur imigrantët në gjashtë operacione shpëtimi në bregun e Libisë. "Synimi ynë është t'i zbarkojmë në një port të sigurt 629 personat në bord, disa prej të cilëve janë në kushte të vështira, është cituat t'i ketë thënë agjencisë së lajmeve, Reuters, zëdhënësja e shoqatës bamirëse, Mathilde Auvillain. Agjencia për refugjatë në Kombet e Bashkuara u ka bërë thirrje "shteteve" të përfshira që të "gjejnë një zgjidhje për imigrantët, në mënyrë që ata të zbarkojnë në hapësirë të sigurt".

Finlanda, vendi i më të lumturve në botë



Vendi ku ka njerëzit më të lumtur në botë është Finlanda. Sipas hulumtimit të publikuar pak kohë më parë Finlanda zë vendin e parë si vendi më i lumtur në botë. Finlanda ka kaluar Norvegjinë për t'u listuar si vendi i parë më i lumtur në botë, thuhet sipas një raporti të Kombeve të Bashkuara. Raporti Botëror i Lumturisë theksoi gjithashtu edhe rënien e SHBA-së, me një krizë të obezitetit, abuzimit me substanca dhe depresionit. Studimi zbulon se katër vendet e para janë zënë nga vendet nordike, me Finlandën të parën dhe pas saj është radhitur Norvegjia, Danimarka dhe Islanda.

EVROPA DO T'I PËRGJIGJET SHBA-SË ME TË NJËJTËN MONEDHË EVROPA DO TË ZBATOJË KUNDËRMASA NDAJ TARIFAVE DOGANORE TË SHBA-SË PËR ÇELIKUN DHE ALUMININ



Kancelarja gjermane Angela Merkel shprehu të dielën në darkë keqardhjen për vendimin e papritur të Presidentit Donald Trump për t'u tërhequr nga deklarata e grupit G7. "Shpallja e tërheqjes, përmes një cicërime në twitter na bën sigurisht esëll si dhe pak të dëshpëruar" - tha Merkel në një intervistë për televizionin publik gjerman ARD pas samitit të G7 në Kanada. Ashtu si Kanada, Bashkimi Evropian po përgatitet për kundërmasa për tarifave doganore të SHBA-së për importet e çelikut dhe aluminin, tha Merkel.

Pas kthimit të saj në Berlin një zëdhënës i qeverisë kishte thënë se Gjermania është dakord me komunikatën për të cilën u diskutua në La Malbaie, të Kanadasë. Edhe Bashkimi Evropian reagoi pas tërheqjes së Trumpit. Një zëdhënës i Presidentit të Këshillit të BE, Donald Tusk, tha "Ne i përmbahemi komunikatës, siç është rënë dakord nga të gjithë pjesëmarrësit". SHBA-ja dhe gjashtë vendet e tje-

ra të G7 - përfshirë edhe aleatët kryesorë perëndimorë të Amerikës Gjermaninë, Francën, Britaninë dhe Kanadanë - arritën që pavarësisht dallimeve të thella mbi çështjet e tregtisë dhe ndryshimit të klimës, të bien dakord në samit në minutën e fundit për deklaratën përfundimtare prej tetë faqesh. Por pas kësaj Trumpi u tërhoq.

Trump e argumentoi në Twitter largimin e tij prej deklaratës përfundimtare - deri tani një hap unikal në histo-

rinë 40-vjeçare të G7 - me qëndrimin e presidentit kanadez Trudeau ndaj tarifave doganore amerikane për çelikun dhe aluminin. Trudeau tha në konferencën përfundimtare për shtyp, se tarifave doganore kundër BE-së dhe Kanadasë, që Trumpi i justifikon me ruajtjen e interesave amerikane të sigurisë, janë "disi ofenduese" dhe se Kanadaja, nga ana e saj, do të vendosë po ashtu tarifa më të larta doganore ndaj mallrave amerikane.

TRAMP DHE KIM DO TË BISEDOJNË PËR ARRITJEN E NJË PAQE AFATGJATË

Mediat koreanoveriore publikuan se lideri i Koresë Veriore Kim Xhong-un dhe presidenti amerikan Donald Trump do të bisedojnë për "mekanizëm të vazhdueshëm dhe afatgjatë paqësor" në Gadishullin Korean dhe denuklearizimin e Gadishullit Korean. Siç citojnë mediat, të dy liderët do të bisedojnë edhe për çështje të tjera me rëndësi për të dyja palët. "Trump dhe Kim do të takohen nesër në ishullin Sentosa të Singaporit. Kim në Singapor arriti së bashku me ministrin e Punëve të Jashtë Ri Jong Ho, ministrin e Mbrojtjes No Kvang Çol dhe motrën Kim Jo Xhong, njoftoi agjencia koreanojugore KCNA.

Sulmohet spitali i fëmijëve, 17 të vdekur



Të paktën 17 civilë humbën jetën si pasojë e sulmeve ajrore të avionëve luftarakë të regjimit të Bashar Al Asadit në Siri, ndaj një spitali të fëmijëve dhe vendbani-

me në "zonën e deescalimit" të Idlibit. Sipas njoftimeve të gazetarëve të Anadolu Agency në Idlib, avionët luftarakë të regjimit kanë shënjestruar vendbanimet civile

në disa fshatra të Idlibit.

Sipas informacionit të marrë nga burimet e Mbrojtjes Civile të Idlibit, edhe Spitali i Fëmijëve Nur në Teftenaz ka qenë shënjestër e bombave. Në këtë sulm humbën jetën 5 civilë prej të cilëve 3 fëmijë, ndërsa spitali u shkatërrua. Në sulmet në Teftenaz humbën jetën të paktën 13 civilë, në Ariha 2, ndërsa në Binnesh dhe Ram Hamdan nga një civil. Të plagosurit janë dërguar nëpër spitalet përreth për trajtim, ndërsa ekipet e mbrojtjes civile vazhdojnë punimet e tyre.

Ndërkohë në sulmin e mbrëmjes së ditës enjte në fshatin Zerdene të Idlib, kishin humbur jetën të paktën 42 civilë. Idlibi, nën

kontrollin e opozitarëve ushtarakë dhe grupeve të armatosura kundër regjimit në pjesën veriperëndimore të Sirisë, u shpall "zonë e deescalimit" në takimin e mbajtur më 4-5 maj 2017 në Astana. Pavarësisht kësaj, regjimi sirian dhe Rusia vazhdojnë të ndërmarrin sulme ajrore në rajon.

Ndërkohë, sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara (OKB), Antonio Guterres, ka theksuar se janë thellësisht të shqetësuar për sulmet ajrore të ndërmarrura ndaj Idlibit, ku civilët përbëjnë 60 për qind të popullsisë në Siri që janë zhvendosur për shkak të konflikteve si dhe për humbjet e jetëve të civilëve në mesin e të cilëve ka

edhe fëmijë. Në një deklaratë nga zyra e zëdhënësit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, rikujtohet se Idlibi është një rajon për pakësimin e tensioneve në kuadër të marrëveshjes së arritur në Astana, dhe nga vendet garantuese të marrëveshjes, Rusia, Turqia dhe Irani është kërkuar që të bëjnë presion që palët t'i përmbahen marrëveshjes. Po ashtu në deklaratë theksohet se më 7 dhe 8 qershor janë ndërmarrë sulme ajrore në fshatin Zerden në veri të Idlibit, dhe se sekretari Guterres u ka bërë thirrje palëve që t'i japin fund menjëherë sulmeve dhe konflikteve si dhe të mbrohen civilët dhe infrastruktura.



Nga Rexhep TORTE

Amër Halid në librin e tij më titull "Gjurmëve të të dashurit tonë" bën një prezantim lakmues të Profetit Muhamed duke pasqyruar e dëshmuar përvojën më të suksesshme për zhvillimin e një populli në historinë e njerëzimit. Profeti Muhamed u lind jetim, nuk dinte shkrim e lexim por brënda njëzet viteve e bëri një popull që ti udhëhiqte popujt e tjerë. Me ardhjen e Profetit Muhamed, me shpalljen e Kur'anit dhe me ardhjen e fesë Islame ndryshoi tërësisht në aspektin pozitiv Gadishulli Arabik, Afrika, Andaluzia (Spanja), Republikat Sovjetike. Feja Islame në Lindje arriti gjer te Muri Kinez. Pjesa tjetër e Europës jetonte në terrin mesjetar. Evropa zhvillimin e saj e bazoi në dijen dhe shkencat islame nga ku mësoi vlerën e lirisë, të të drejtës dhe të barazisë.

EZANI TUBON MILIONA MUSLIMANË NË NAMAZ, IFTAR DHE HAXH

Shumë figura botërore kanë përfunduar famën e tyre së bashku me vdekjen. Ndërkaq Profeti Muhamed vazhdon të mbetet i pranishëm edhe sot e kësaj dite. Thirrja e ezanit dhe e mesazhit të Profetit Muhamed sot jehon në xhamitë e mbarë botës. Ezani i xhamive mbledh miliona muslimanë me familjet e tyre rreth sofrës në muajin e Ramazanit. Qaben e Shenjtë gjatë Haxhit e vizitojnë miliona muslimanë.

Profeti Muhamed me misionin e tij vazhdon të jetë i pranishëm edhe pas vdekjes së tij. Ai mbetet shembull dhe udhërrëfyes në jetë, nëpërmjet dijes, planifikimit, politikës, paqes, fuqisë ushtarake dhe ekuilibrit mes të vërtetës dhe drejtësisë dhe mes mendjes dhe shpirtit.

Profetin Muhamed Allahu i Madhërishtëm e pajisi me të gjitha vlerat që i nevojiten njerëzimit gjer në Ditën e Kijametit. Dhe këtë e bëri brenda 23 viteve duke ia shpallur Profetit Muhamed Kur'anin hyjnor nëpërmjet Xhebrailit, që zgjati 13 vite në Meke dhe 10 vite në Medine.

Profeti Muhamed njihet si personaliteti më i lartë në historinë e njerëzimit me cilësitë e tija sepse nuk ishte hakmarrës, nuk e shkilte premtimin nuk gënjente dhe çdo hap e bënte mbi bazën e drejtësisë. Morali i Profetit Muhamed ishte Kur'ani.

Dy perandoritë më të mëdha të asaj kohe ajo Perse dhe ajo Romake u shkatërruan sepse atyre u mungonte drejtësia dhe Allahu i Madhërishtëm e dërgoi Profetin Muhamed që nga shkretëtirat e Mekës ta vendoste drejtësinë në

SHËMBËLLTYRA E PROFETIT MUHAMED



Profeti Muhamed me misionin e tij vazhdon të jetë i pranishëm edhe pas vdekjes së tij. Ai mbetet shembull dhe udhërrëfyes në jetë, nëpërmjet dijes, planifikimit, politikës, paqes, fuqisë ushtarake dhe ekuilibrit mes të vërtetës dhe drejtësisë dhe mes mendjes dhe shpirtit

KOHA E MREKULLIVE KISHTE PËRFUNDUAR, FILLONTE EPOKA E DIJES

çdo vend ku arriti feja Islame. Në Kur'an nuk gjen asnjë fjalë të vetme e cila nxit konflikte qytetërimesh.

Para lindjes së Profetit Muhamed gadishulli Arabik përbëhej nga fise që ishin në luftë të vazhdueshme me njëri-tjetrin. Bandidët plaçkitnin karvanet dhe merrnin robër të rinjtë dhe fëmijët duke i shitur në vendet tjera. Padrejtësia dhe frika sundonin kudo. Qabja ishte e rrethuar me 360 idhuj të ndryshëm. Gratë nuk kishin asnjë të drejtë. Asokohe bëhej edhe groposja për së gjalli e vajzave, ndërkaq në Egjipt Faraoni vriste fëmijët meshkuj.

Profeti Muhamed i edukonte edhe fëmijët që të jenë të lirë dhe krenarë për veten e tyre.

Lindja e Profetit Muhamed ishte e zakonshme nga nëna Amineja në kohën e shkatërrimit të ushtrisë të Ebrehas e cila i ishte vërsulur Qabes. Babai Abdullahu pasi ishte martuar me Aminën kishte udhëtuar me karvan pa e ditur se gruaja e tij është shtatzënë. Me tu kthyer për në Mekë në Medine sëmuret dhe vdes.

Muhamedi ishte Profeti i fundit që do të vinte në tokë. Asokohe në Mekë jetonin Kurrejshët të cilët e kishin zakon që fëmijët e porsalindur dy vite ti dërgonin në shkretëtirë ku i mëkonin gratë e fisit Benu Sad, mbi bazën e një shpërblymi me qëllim që fëmijët të zhvilloheshin fizikisht në natyrë dhe ajër të pastër. Meqë Muhamedi ishte jetim dhe i varfër që sëbashku me nënën jetonin te gjyshi, atë e mori

Halimja e cila nuk desh të kthehej duarbosh në familjen e saj Muhamedi i kaloi dy vitet si një fëmijë i mbarë dhe i shëndetshëm.

Fatkeqësitë e mësonin të kujdesej për veten duke u mbështetur në forcat e veta, të ishte serioz, të mësohej me përgjegjësi, vullnet dhe elasticitet në marrëdhënie me njerëzit duke u mësuar si të reagojë në situata të ndryshme. Në moshën 8 vjeçe i kërkoi xhaxhait ti mundësojë që të punojë duke kullotur delet sepse nuk dëshironte të jetojë në kurrizin e të tjerëve. Kullotja e deleve e pajisi që të ketë durim dhe dëshirë për bashkim. Në moshën 15 vjeçe e luti xhaxhain që ti mundësojë të merret me tregëti dhe të udhëtojë me karvanet tregtare, gjë që i mundësoi ti njeh më mirë problemet e jetës, njerëzit, shtetet e ndryshme dhe kulturat e tyre, si edhe mësoi edhe artin e luftës. Në moshën 25 vjeçe martohet me Hatixhen një grua e pasur dhe e suksesshme në tregëti, pasi kjo grua e kishte parë moralin madhështinë dhe vlerat e tij. Kjo martesë u kurorëzua me respekt të ndërsjellë. Vdekja e dy djemve të tyre ishte sfida e rradhës që Muhamedi të kuptojë se kjo botë nuk vlen gjë dhe se duhet jetuar për diçka më të madhe.

KUR'ANI UDHËRRËFYES PËR JETË TË LUMTUR NË KËTË BOTË DHE NË XHENET

Kur'ani është libri i fundit që erdhi nga Zoti nëpërmjet Profetit Muhamed. Kur lexon Kur'anin fjalët renditen dhe rradhiten në

vepër unike të madhërishtëme në dritën e krijuesit, dhe që nuk mund të krahasohet me tërë veprat të shkruara në gjuhën arabe.

Në shpellën Hira kur Muhamedi i mbushi 40 vite dhe pasi që kishte fituar përvojën e duhur familjare, edukatën për çështjen e jetës dhe ato sociale, si edhe përvojat ushtarake dhe vetëdijen e fuqishme për paqe duke mos përjashtuar mëshirën ndaj njerëzimit në përgjithësi. Këtu u bë takimi i parë i Muhamedit me Xhebrailin i dërguar nga Allahu dhe filloi shpallja e Kur'anit me fjalën "Lexo". Ky mesazh tregonte se koha e mrekullive ka përfunduar se tani fillonte epoka e dijes, e planifikimit dhe se kjo epokë fillonte me Profetin Muhamed dhe me popullin e tij. Muhamedi nuk dinte shkrim e lexim, por si i dërguar i Zotit ai po e mëson mbarë njerëzimin. Sipas tij namazi është shtylla e fesë Islame, ai është dritë dhe shërim për besimtarin.

Plani afatgjatë i Profetit Muhamed vijoi me gjetjen e burrave dhe të grave të suksesshme e të devotshme në shoqëri duke i shtuar përkrahësit e tij. Hatixheja, Ebu Bekri dhe djaloshi 10 vjeç Ebu Talibi ishin besimtarët e parë. Profeti Muhamed jobesimtarëve u fliste për Islam në gjuhën që ata e kuptonin dhe ky komunikim u tregua i suksesshëm. Armiqtë reaguan ashpër ndaj mesazhit të Muhamedit duke e quajtur "Poet", "Magjistari", i "Çmendur" dhe duke e fyer dhe torturuar edhe fizikisht. Megjithatë Profeti nuk u mposht

por vazhdoi rrugën e tij përkundër vuajtjeve, sepse Zoti e ruante dhe i falte durim. Siç vuante Profeti ashtu vuanin edhe shokët e tij, por Profeti i inkurajonte se Zoti do tu hakmerret për sjelljet e tyre dhe ashtu ndodhte. Muslimanët edhe pse keq trajtoheshin shprehnin qetësi dhe nuk revolttoheshin siç revolttoheshin Kurrejshët që torturonin dhe jetonin në kulmin e zemërimit. Muslimanët vazhdonin rrugën e tyre pa e thyer askënd dhe pa u hakmarrë, që fëmijët e torturuesve të mos kishin asnjë arsye për ta pranuar Islam duke thënë se "Zoti është më i madhi, nuk ka tjetër veç tij dhe se Muhamedi është i dërguari i tij". Profeti duke sakrifikuar për mesazhin e vërteta po triumfonte dhe njerëzit e kuptonin se nuk duhet jetuar vetëm për interesat personale. Në këto kohë ishin Kurrejshët e pasur por pa besimin e vizionin për të ardhmen, dhe muslimanët e varfër por të fuqishëm me besimin e tyre në Zot. Kjo i ngjante dyluftimit të monedhës false me atë të vërtetë. Profetit me zemër sfiduese, mëshirues dhe i butë Kurrejshët gjatë bisedave i thoshin se mesazhi yt është i rrezikshëm, se na ke përçarë dhe se ke ndarë babanë nga i biri. Profeti i ofrojnte pasuri, pushtet, apo gruan më të bukur, por ai i refuzonte dhe si përgjigje u lexonte pjesë nga Kur'ani. Kështu armiqtë e kuptonin se fjalët e tij nuk ishin poezi, magji, por të ëmbla dhe plot hijeshi.

(Nesër lexoni: Besa e madhe të Akabesë, vendimtare për Islam) (Nesër lexoni: Besa e madhe të Akabesë, vendimtare për Islam)

Ish-lojtari konfirmon qëndrimin e Hysajt te Napoli



Lajmet për të ardhmen e El-seid Hysajt janë kontradiktore ditët e fundit. Është folur shumë për një largim të tij nga Napoli dhe për një kalim të mundshëm në Angli, me shumë mundësi te Çells, bashkë me trajnerin Sarri. Por dikush i familjes napolitane garanton se Hysaj do të qëndrojë. Salvatore Banji, ish-lojtar i shquar i Napolit, aktualisht opionist, është shprehur i bindur se mbrojtësi shqiptar do të luajë sërish me fanellën e kaltër. "Do të qëndrojnë në ekip, si Hysaj, ashtu edhe Gulam. Po, ka mundësi që Napoli të marrë Lainer nga Salzburgu, nuk do të ishte një investim i keq. Trajneri Anceloti kërkon që çdo rol ta ketë të dubluar në ekip," – ka thënë mes të tjerash Banji në një intervistë për "Mattino".



Jakupi i argjendtë në Stamboll

Shkup, 11 qershor - Berat Jakupi ka fituar medaljen e argjendit në Karate Premier Ligën që u mbajt në Stamboll të Turqisë. Në finale, Berat Jakupi u mund nga karateisti i Iranit, Mahdi Holdabashi me rezultat 3-7. Ndryshe, edhe pse karateisti nga Gostivari nuk arkëtoi medaljen e artë, ai ka bërë lëvizjen më atraktive të turnirit të karatesë në Stamboll. Në rrugën deri te finalja, Jakupi mundi Medi Sesinën nga Franca, Meris Muhoviqin nga BeH, Ugur Aktashin nga Turqia dhe Pablo Zapata Arenas nga Spanja. "Faleminderit Zot për gjithçka. Medalje e argjendtë në 'Karate 1 Premier League Istanbul 2018'. Ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen dhe uratat", shkroi në Facebook, Jakupi. Ndryshe, kjo është medalja e dytë për Maqedoninë në garat e Karate Premier Ligës, pas medaljes së argjendit të Emil Pavlovit në Dubai.

SEFER SEFERI THOTË SE LËNDIMI I KRAHUT E SHTYU TË DORËZOHEJ

NUK JAM PENDUAR PËR LUFTËN, JAM I NDESHËM E BOKSIER I VËRTETË

"Nuk jam penduar. Unë jam luftëtar dhe nuk pendohem për luftërat që i bëj. Unë kam krenari, jam Sefer Seferi. Jam boksier i vërtetë. Jam burrë i ndershëm. Nuk më kanë nënvlerësuar. Ai ishte më i madhi dhe më i forti, këtë e diti e gjithë bota. Ai është i një tjetër niveli. Mendoj se mora vendimin e duhur. Pas ndeshjes krahun e kisha të bllokuar. E lëndova gjatë luftës", pohon Seferi



Boksieri shqiptar, Sefer Seferi, ka treguar arsyen prapa vendimit të tij për t'u dorëzuar pas raundit të katërt në duelin ndaj Tajson Furyt të shtunën mbrëma. Dueli i zhvilluar në "Manchester Arena" pa për fitues Furyn pa ndonjë befasi të madhe. Por, Seferi që filloi më mirë takimin duke kontrolluar përballjen me shpejtësinë, befasoi të gjithë me vendimin e tij për t'u dorëzuar pas raundit të katërt, raund kur edhe mori goditje nga Fury. Sipas Seferit, goditja ishte e fuqishme nga Fury, por ai pësoi një dëmtim në krahun e djathtë dhe kjo ja pamundësoi që të vazhdonte luftën sepse asgjë nuk mundi të bën-

te me të djathtën nga dhimbjet në krahun e djathtë. Ai thotë se vendimi që e mori ishte i drejtë. "Në fillim ka funksionuar mirë. Kam pasur lëvizje të mira. Ai ishte më i rëndë. Unë isha më i shpejtë dhe pata hapësirë për të goditur. Por, në raundin e katërt mora një goditje me të djathtën. Më pas më është bllokuar krahun dhe mora vendimin se nuk mund të vazhdoj më, diferenca ishte e madhe me Tajson Furyn. Me të majtën provova, por me të djathtën nuk shkonte. Nuk funksionoi asgjë. Dhe, mendoj se mora vendimin e duhur pas raundit të katërt. Nuk jam

penduar. Unë jam luftëtar dhe nuk pendohem për luftërat që i bëj. Unë kam krenari, jam Sefer Seferi. Jam boksier i vërtetë. Jam burrë i ndershëm. Nuk më kanë nënvlerësuar. Ai ishte më i madhi dhe më i forti, këtë e diti e gjithë bota. Ai është i një tjetër niveli. Mendoj se mora vendimin e duhur. Pas ndeshjes krahun e kisha të bllokuar. E lëndova gjatë luftës. Dhimbjet ishin të mëdha dhe me të përfunduar raundi i katërt doja që të përfundonte sa më shpejt kjo përballje sepse nuk munda ta lëviz më krahun", deklaroi Sefer Seferi për "Blick".

AKTIVIZIMI ME KOMBËTAREN JEP EFEKT

Manajn e kërkon Getafe

Ndonjëherë futboli është i çuditshëm, duhet pranuar, pa paragjykuar askënd. Sulmuesi i Shpresave, Rei Manaj, u grumbullua së fundi nga trajneri i Kombëtares kuqezi, Kristian Panuçi, madje luajti si ndaj Kosovës, ashtu edhe ndaj Ukrainës (titullar me këtë të fundit). Dhe duket se ky aktivizim ka dhënë efekt mjaft pozitiv, edhe pse lojtari në fjalë nuk bëri ndonjë gjë të madhe. Sulmuesit kuqezi i ka dalë emri te Getafe, në Spanjë. "Corriere

dello Sport", duke bërë një bilanc të lojtarëve të rinj të Interit, që mund të kalojnë në skuadra të tjera, përmend edhe Manajn, që ka përfunduar në radarët e skuadrës së La Ligas. Sezonet e fundit Manaj ka qenë i huazuar shpesh nga Interi, por me asnjë skuadër nuk ka mundur të shpërthejë. Sezonin e fundit ishte pjesë e Granadës në kategorinë e dytë në Spanjë, ndërsa tani duket se po i buzëqesh fati dhe mund të luajë në La Liga.



Berisha me skuadër të re

Portieri i përfaqësueses shqiptare, Etrit Berisha, do të luajë në një ekip të ri në sezonin e ardhshëm. Mediat italiane kanë bërë të ditur se pavarësisht paraqitjeve të tij shumë pozitive, Atalanta ka vendosur të shesë portierin shqiptar dhe brenda pak orësh është gjetur edhe sistemimi i tij, në një tjetër skuadër të Serisë A. Sipas të përditshmes "Secolo XIX" të qytetit të Xhenovës, portieri do të veshë fanellën e Sampdorias në sezonin e ardhshëm. Akordi mes palëve është arritur dhe të gjithë duken të kënaqur me këtë zgjidhje që i garanton Sampdorias një portier të fortë pas largimit të Vivianos, si dhe Berishës mundësinë e aktivizimit si titullar në një klub me emër. Marrëveshja është arritur dhe vetëm vizitat mjekësore, të cilat do të kryhen sot, ndajnë palët nga firma në kontratë dhe zyrtarizimi i këtij transferimi. Bashkë me Etrit Berishën, në Xhenova presin edhe Valon Berishën, i cili do të transferohet në radhët e klubit italian nga Salzburgu.



ROUSEJ, FEMRA E PARË QË HYN NË “HOLLIN E FAMËS”

Ceremonia e dorëzimit të këtij çmimi do të bëhet më 5 korrik në Las Vegas dhe ceremonia do të jetë “live stream” për fansat e këtij sporti. Lajmin e kanë konfirmuar drejtuesit e arteve marciale mikse, duke vlerësuar punën dhe arritjet e Rousej në këtë sport, një ikonë e dueleve në kafaz

Ronda Rousej ishte sportistja e parë amerikane që mori një medalje në Lojërat Olimpikë në sportin e xhudos dhe më pas u bë sportistja e parë femër që firmosi për UFC-në. Ishte e para që u regjistrua në një eveniment PPV (pay per view) në UFC, ishte sportistja e parë që arriti të vendoste rekorde nga PPV në artet marciale mikse, duke fituar 1 milionë dollarë nga shitja e të drejtave televizive. Më pas u bë kampione e botës në këtë sport, e padiskutueshme në peshën e saj, duke organizuar evente deri në 50 mijë shikues. Praktikisht, në sportin e MMA-së Ronda Rousej i ka bërë dhe arritur të gjitha. Për të gjitha

këto arsye e mjaft të tjera, Ronda Rousej ka hyrë në “Hollin e Famës” në sportin e UFC-së, duke u bërë e para sportiste femër që e arrin një vlerësim të tillë.

Ceremonia e dorëzimit të këtij çmimi do të bëhet më 5 korrik në Las Vegas dhe ceremonia do të jetë “live stream” për fansat e këtij sporti.

Lajmin e kanë konfirmuar drejtuesit e arteve marciale mikse, duke vlerësuar punën dhe arritjet e Rousej në këtë sport, një ikonë e dueleve në kafaz. Pavarësisht se ajo e mbylli karrierën me dy humbje dhe u largua nga MMA-ja pa asnjë titull, Ronda Rousej mbetet ikonë e UFC-së.



Fury sërish në ring pas 2 muajsh

Tajson Fury do të duelojë sërish më 18 gusht, dy muaj pas duelit të 9 qershorit, kur mundi me “KO” në raundin e katërt Sefer Seferin, sfidë që u zhvillua në Manchester. Lajmin e ka konfirmuar vetë boksieri britanik, që u rikthye në ring pas dy vitesh e gjysmë pushim, që kur në nëntor të 2015-ës pat mundur Vladimir Klitçko. Duket se Fury kërkon të rikuperojë kohën e humbur larg ringut por edhe të gjejë formën optimale, pasi peshonte 120kg para sfidës me Seferin. “Menaxheri im ka një detyrë të vështirë, të gjejë një rival tjetër për 28 gushtin, të një kalibri më të mirë, pasi synoj që të dueloj për titullin kampion sa më shpejt, mundësisht në fund të këtij viti. Ky është promovimi që

i bëj fansave të mi. Ndiem më formë të mirë dhe u kënaqa shumë që u riktheva në ring pas një kohë kaq të gjatë. Unë doja që dueli me Seferin të zgjaste edhe më shumë, por ai vendosi të tërhiqej”, u shpreh për mediat Tajson Fury. Fury pritet të duelojë më 18 gusht në “Windsor Park”, në Belfast, por ende nuk dihet emri i rivalit, ndërkohë që ish-kampioni i botës në peshën e rëndë synon të duelojë me Tony Bellew në fund të këtij viti. “Do të jem gati për duelin e 18 gushtit, një tjetër sfidë e mirë për të testuar veten dhe për të qenë gati për Bellew. Deri në fund të këtij viti do të zhvilloj 3 sfida, pasi në mendjen time është vetëm titulli kampion bote”, deklaroi Tajson Fury.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 34/14) neneve 156, 157, 158, 159, 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM 43/12; 145/12; 87/13; 164/13; 39/14 dhe 43/14), nenit 7, paragrafi 1 të Marrëveshjes kolektive për veprimtarë shëndetësorë të RM (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/06 dhe 60/10), Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës në IPSSH Shtëpia e shëndetit – Makedonski Brod, lajmërimin për njetet e siguruar financiare nga Ministria e financave me nr. 18-4414/2 të datës 18.04.2018, dhe pëlqimit për punësim nga Ministria e shëndetësisë me nr. 09-2797/2 të datës 02.04.2018 UD Drejtori D-r Zharko Simeski i IPSSH Shtëpia e shëndetit – Makedonski Brod publikon:

SHPALLJE PUBLIKE Për punësim

IPSSH Shtëpia e shëndetit – Makedonski Brod ka nevojë për punësim për kohë të pacaktuar të:

- A. Një (1) person në vendin e punës – doktor i medicinës
- B. Një (1) person në vendin e punës – doktor i stomatologjisë

Kandidatët e interesuar për paraqitje në shpallje duhet të përmbushin kushtet në vijim:

- Kushtet e përgjithshme
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- të jetë i moshës së rritur
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- të mos jetë të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

- A. Doktor i medicinës
 - Fakultet të mbaruar të medicinës
 - Provim të dhënë profesional – Posedim të Certifikatës licencë për punë
 - Njohjen e një prej gjuhëve të huaja (angleze, gjermane apo frënge)
 - Me dhe pa përvojë pune
- B. Doktor të stomatologjisë
 - Fakultet të mbaruar të stomatologjisë
 - Provim të dhënë profesional – Posedim të Certifikatës licencë për punë
 - Njohjen e një prej gjuhëve të huaja (angleze, gjermane apo frënge)
 - Përvojë të nevojshme të punës prej tre viteve

Së bashku me fletëparaqitjen, ndërsa si dëshmi për përmbushjen e kushteve, kandidatët duhet të paraqesin dokumentet në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter:

- Fletëparaqitje, biografi të shkurtë (CV)
- Certifikatë për shtetësi për të gjithë kandidatët
- Kopje të letërnjoftimit për të gjithë kandidatët
- Certifikatë (diplomë, vërtetim) për fakultet të mbaruar për kandidatit nën
- Certifikatë për provim të dhënë profesional
- Licencë për punë për kandidatët nën
- Deklaratë për njohje të gjuhës së huaj (angleze, gjermane apo frënge) për kandidatët nën
- Certifikatë për gjendjen shëndetësore për të gjithë kandidatët
- Dëshmi se nuk u është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për të gjithë kandidatët.

Kandidatët të cilët kanë mbaruar arsimin përkatës jashtë vendit duhet të posedojnë:

- Diplomë të nostrifikuar me arsim përkatës
- Dokument për ekuivalencë të notave, të dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Orari i punës është 40 orë në javë,

Neto pagesa fillestare do të paguhet sipas marrëveshjes kolektive për shëndetësi në shumë prej 26.000,00 denarë

-Afati për paraqitje në shpallje është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme parashtrihen në arkivin e IPSSH Shtëpia e shëndetit – Makedonski Brod ose si dërgesë rekomanduese përmes postës në adresën IPSSH Shtëpia e shëndetit rr. Vuk Karaxhiq nr. 2, me shenjë “për shpallje”

Përzgjedhja dhe zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në pajtim me nenet 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/2012). Drejtor UD D-r Zharko Simeski

Afati përfundimtar për paraqitje: 19.06.2018

Ishte një ditë perfekte

Sebastian Vettel shijon suksesin në Çmimin e Madh të Kanadasë, duke ia kushtuar të gjithin skuderisë Ferrari: “Sot ka qenë një ditë perfekte,—tha gjermani.—Një ditë e pabesueshme. Për mua është fitorja e 50-të në karrierë, por kryesorja është që fituam një pistë ku Ferrari e priste prej kohësh suksesin. Tifozët meritojnë të fitojnë. E di mirë sa i rëndësishëm është ky circuit për Ferrari dhe është dita më e mirë për të kujtuar dhe për t’i bërë homazhe të madhit Gilles Villeneuve”. Piloti i Ferrari ka folur edhe për renditjen e përgjithshme, ku kryesor me një pikë më shumë se Hamilton: “Rruga është ende e gjatë, sigurisht jam në një situatë më të mirë sesa mendonim, por jemi shumë shpejt për të folur për titullin. Për momen-



tin nuk shoh renditjen. Është një ditë që nuk do ta harroj kurrë dhe që i bën mirë historisë së lavdishme të Ferrari.”



Xhejms takime me 7 skuadra

Nga 1 korriku LeBron Xhejms do të jetë “free agent” (lojtar i lirë), duke e lënë të hapur të ardhmen e tij. Mediat amerikane bëjnë me dije se ylli i Klivlend Kavalirs ka planifikuar shtatë takime me përfaqësues nga shtatë skuadra të ndryshme, në të dyja Konferencat, para se të vendosë se me cilin ekip do të luajë sezonin e ardhshëm 2018-2019. Skuadra ak-

tuale, ajo e Kavalirs do të ketë përparësinë në këto takime, duke qenë e para që do të takohet me Xhejms, ndërsa skuadrat e tjera që kanë lënë takim në agjendën e basketbollit janë Golden Stejt, Boston, Filadelfia, Lejkers, Hjuston dhe Majami. Vetëm pasi të dëgjojë propozimet e të gjitha ekipeve LeBron do të vendosë për të ardhmen.

HIERRO HEDH DRITË MBI STOLIN E REAL MADRIDIT



"Ajo që ka bërë edhe si trajner me Real Madridin, ka qenë e mrekullueshme. Pas largimit të tij, askush nuk ka folur me mua për të trajnuar Real Madridin", pohon Hierro

Fernando Hierro është drejtori sportiv i kombëtares së Spanjës. Ai ka qenë kapiten i Real Madridit dhe është përfolur si një nga emrat e listës së gjerë për të zënë vendin e Zinedin Zidan në stolin e klubit të bardhë. Kjo është ajo që ai tha në një intervistë me "El Partidazo de COPE". "Çfarë zëvendësuesi më pëlqen më së shumti për Zidan? Nëse do të isha drejtori sportiv i Real Madridit do t'ju jepja një emër, por nuk jam i tillë. I kam telefonuar Zidanit për ta uaruar rreth

punës së shkëlqyer të tij. Ajo që ka bërë edhe si trajner me Real Madridin, ka qenë e mrekullueshme. Pas largimit të tij, askush nuk ka folur me mua për të trajnuar Real Madridin", u shpreh Hierro. Ai ka folur edhe për mardhëniet me kryetarin e Realit të Madridit, Florentino Perez. "Kemi një marrëdhënie të respektueshme, nuk më intereson nëse ata thonë se është e mirë, apo e keqe. Florentino më ka thirrur në situata shumë të vështira personale për

mua. Nëse ka një sukses te Real Madridi, unë do ta telefonoj dhe ta përgëzoj", shtoi më tej Hierro. Ndryshe, ish-futbollisti i Realit dhe i përfaqësueses së Spanjës ka folur edhe për marrëveshjen me seleksionuesin Lopetegui. "Përgjegjësia ime është t'i propozoj bordit të drejtorëve trajnerët. Unë nënshkrova për Julen edhe në fazat e mëparshme.

Ne përkohmë te Real Madridi dhe tek ekipi kombëtar, ndaj marrëdhënia jonë është fanta-

stike. Unë kam shijet e mia, por kurrë nuk i ndërhyj Lopeteguit për formacionin. Kurrë nuk u shqetësoj para ndeshjeve. Nëse Julen më pyet, do t'i them mendimin tim për diçka, sepse kjo nuk është tabu". Në fund Hierro ka folur edhe për Ramosin dhe Piken. "Pike dhe Ramos janë mjaft më të mirë se unë. Ata kanë personalitet, përvojë, cilësi dhe janë vendimtarë në të dyja fushat. Ato janë dueti qëndërmbrorës më i mirë në botë", përfundoi Hierro.

Asensio mendon largimin nga Reali



Marko Asensio po konsideron largimin nga Real Madridi, siç domos tani që për të është interresuar klubi i Liverpoolit, sipas shtypit britanik. Spanjollit kërkon të jetë në formacionin e "Los Blanco" për sezonin e ardhshëm, pasi ka lënë një përshlyetje shumë të mirë në "Bernabeu" gjatë sezonit të kaluar. Por nëse asnjë prej Cristiano Ronaldo, Bejll dhe Isko nuk largohet edhe për më tepër nëse Real merr Nejmarin, atëherë hapësirat e Asensio nuk do të jenë të mjaftueshme. Sipas "Diario Gol", kjo e ka bindur Asensio të hedh sytë nga Premier Liga, ku krahas ofertës së Çellsit, ajo e Liverpoolit duket më tërheqëse për spanjollin e talentuar. 22-vjeçari i ka thënë edhe shokëve të tij te kombëtarja e Spanjës që do të luajë në Rusi se tani ka ardhur momenti të jetë titullar në nivel klubesh dhe Real nuk ia garanton diçka të tillë. Liverpooli ka të ngjarë të paguajë rreth 70 milionë euro për të marrë atë që ish-trajneri i Real Madrid, Zinedin Zidan, e ka cilësuar si "mëngjarashi më i mirë në botë, pas Leo Messi."

De Gea refuzon të përjashtojë transferimin te Reali



David De Gea nuk po mendon të largohet nga Manchester Junajtedi për Real Madridin, këtë verë, duke këmbëngulur se fokusi i tij qëndron vetëm me kombëtaren spanjolle, te Kupa e Botës së Rusisë. 27-vjeçari ka qenë prej kohësh i lidhur me një lëvizje në kryeqytetin spanjoll dhe ishte afër përfundimit të një transferimi të tillë në 2015. "E ardhmja ime? Gjëja më e rëndësishme është Kupa e Botës dhe të mos mendojmë për ndonjë

gjë tjetër, që mund të devijojë vëmendjen apo të na shpërqendrojë,—u tha gazetarëve De Gea. —Duhet të jemi të fokusuar për të zhvilluar një Kupë Bote sa më të mirë. Shpresojmë se mund të shkojmë larg dhe të fitojmë". I pyetur nëse De Gea iu kishte thënë përfaqësuesve të tij për t'i mbajtur gjërat larg nga ai gjatë përgatitjeve të Kupës së Botës, portieri spanjoll tha: "Futbolli është futboll dhe një mijë gjëra mund të ndodhin, por unë jam

gjithmonë i qetë. Unë do të jem i njëjtë. Është e rëndësishme të fokusohemi dhe të jemi 100 për qind. Unë isha pak a shumë i fshehur përpara medias, sepse kishte një kohë që nuk jam trajtuar siç duhet prej tyre. Shumë njerëz kanë qenë të padrejtë me mua. Ata më kanë kritikuar, por pastaj më vonë e dinin se kishin gabuar. Ka shumë njerëz që nuk meritojnë të japësh intervista për ta. Asgjë tjetër", deklaroi De Gea.

Heness "vulos" të ardhmen e Levandovskit

"Sulmuesi i Bajern Muni, Robert Levandovski, nuk do të shitet dhe raportet e një çmimi prej 200 milionë eurosh janë të pakuptimta",—tha presidenti i klubit, Uli Heness. Levandovski, 29 vjeç, është i lidhur me një lëvizje larg gjigantëve të Bundesligës, pasi agjenti i tij tha muajin e kaluar se sulmuesi polak donte të largohej. Manchester Junajted dhe Çellsit janë shfaqur si destinacione të mundshme, ndërsa Real Madridi fillimisht është raportuar të jetë i interesuar, po ashtu. Mes raporteve që Bajern Muni donte të paktën 200 milionë euro për Levandovski, presidenti Heness i fshiu këto pretendime dhe tha se

sulmuesi nuk po shkonte askund. "Një çmim prej 200 milionë eurosh është i pakuptimtë,—tha ai për "Sky".—Robert nuk do të shitet, ai do të luajë me ne sezonin e ardhshëm. Gjithçka e thënë nga unë është e vërteta për këtë çështje". Levandovski, i cili është kontraktuar deri më 2021 me bavarezët, ka kaluar katër sezonet e fundit në "Allianz Arena", duke shënuar 41 gola në sezonin 2017-2018. Futbollisti do të jetë në veprim për Poloninë këtë verë, me kombëtaren e tij, teksa Polonia shihet si një nga favoritët në Grupin H të Botërorit të Rusisë, ku do të përballlet me Kolumbinë, Senegalin dhe Japoninë.



Refuzon rikthimin në vendlindje




Ander Herrera ka refuzuar mundësinë për t'u kthyer te Atletik Bilbao. Mesfushori spanjoll ka edhe një vit kontratë me "djajtë" dhe duke qenë se në qershor 2019 do të jetë i lirë nga çdo lidhje kontraktuale ai ka përfunduar në qendër të dëshirave të disa prej klubeve evropiane, kryesisht në La Liga. 28-vjeçari ndihet i lumtur në "Old Trafford" dhe ka ndërmend të luftojë për vendin e titullarit, pavarësisht se situata është komplikuar, sidomos pas blerjes së brazilianit Fred për 60 mi-

lionë euro. Gjithsesi, Herrera ka ndërmend të qëndrojë te Junajted, të paktën deri në janarin e ardhshëm, kur do të vendosë përfundimisht të ardhmen e tij. Kjo është arsyeja përse menaxheri i tij ka refuzuar çdo ofertë të mundshme. Krahas Bilbao, që dëshiron te rikthente në klub duke e bërë futbollistin më të paguar në historinë e tyre, edhe Atletiko Madrid kishte shfaqur një interesim për lojtarin, por mesa duket Herrera do të luajë deri në fund kartat e tij te ekipi i Hoze Murinjos.

ZBULON SAKRIFICËN E ÇMENDUR QË DO BËNTE PËR KUPËN E BOTËS

jam i lumtur që jam pjesë e këtij klubi dhe ky sukses që do të mbahet mend në histori. Por, unë do t'i këmbëja disa prej trofeve, që kam fituar me Real Madridin, me një sukses të madh me Kroacinë”, thotë Modriç

Luka Modriç këmbëngul që Real Madridi e ka merituar fitoren e Ligës së Kampionëve, por thotë se do t'i këmbente disa nga trofetë e tij me klubin e bardhë për lavdi në Kupën e Botës, me Kroacinë. Mesfushori ishte në zemër të skuadrës madrilene, që e mundi 3-1 Liverpuln, në finalen e Kievit, pasi të besuarit e Zinedin Zidan përfituan nga dy gabime fatale të portierit Loris Karius. Duke folur në ceremoninë e shpërblyeve të Bashkimit të Lojtarëve Kroatë, Modriç tha: “Duket se nuk mund të bëjmë pa dramë. Por, këtë herë kemi pasur rrugën më të vështirë, që kur kam mbërritur te Real Madridi. Mos harroni se për të mbërritur në finale të Çampionit kemi eliminuar me radhë kampionët francezë, kampionët italianë, kampionët gjermanë dhe pastaj Liverpoolin. Pra, me të vërtetë e merituar trofeun”, shprehet kroatë. 32-vjeçari pranoi se sezoni 2017-2018 nuk ishte i lehtë për Real Madridin, i cili e përfundoi në vendin e tretë të La Ligas, 17 pikë pas rivalëve të hidhur dhe kampionëve të Barcelonës. Dhe Modriç, i cili ka ngritur katër trofe të Ligës së Kampionëve, një titull të La Liga dhe një “Copa del Rey” me madrilënët, që kur u ba-



shkua me klubin mbretëror spanjoll në vitin 2012, zbuloi se do të hiqte dorë nga disa trofe të fituar me Real Madridin për një sukses ndërkombëtar me Kroacinë, në Kupën e Botës së Rosisë. “Ishte një sezon shumë i vështirë dhe i gjatë, në La Liga dhe “Copa del Rey” nuk luajtëm siç pritej nga

ne, – sqaron kroatë. – Në fund kemi fituar trofeun më të rëndësishëm, ndaj jam i lumtur që jam pjesë e këtij klubi dhe ky sukses që do të mbahet mend në histori. Por, unë do t'i këmbëja disa prej trofeve, që kam fituar me Real Madridin, me një sukses të madh me Kroacinë”, përfundoi Modriç.

CEREMONIA HAPJES SË BOTËRORIT

Nga “Fenomeni” te Uilliams, shumë surpriza në “Luzhniki”



Do të ketë shumë të ftuar specialë në ceremoninë e hapjes së Botërorit “Rusi 2018”, personalitete të sportit dhe jo

vetëm. “Fenomeni”, apo Ronaldo Nazario da Lima, do të jetë i pranishëm në këtë ceremoni. Të ftuar specialë në ceremoninë që do të mbahet ditën e enjte, në stadiumin “Luzhniki”, janë këngëtari britanik Robi Uilliams dhe sopranoja Aida Garifulina. Të dy do të performojnë para ndeshjes mes Rosisë dhe Arabisë Saudite. “Jam shumë i lumtur që do të kthehem të performoj në Rusi, – është shprehur Uilliams. – Kam bërë shumë në karrierën

time, por të hapësh Kupën e Botës, para 80 mijë tifozëve, ka qenë gjithmonë një ëndërr. Do të jetë diçka e paharrueshme”, tha Uilliams.

FIFA ka bërë me dije se ceremonia e hapjes së Kupës së Botës do të jetë shumë muzikale dhe do të zhvillohet gjysmë ore para ndeshjes së parë. “Nuk e kisha imagjinuar kurrë se do të isha pjesë e kësaj feste të madhe në vendin tim”, – ka thënë sopranoja Aida Garifulina.

ANGLIA “KOPJON” SKEMËN E ANTONIO KONTE

Me tri qendra në Botëror

Premier Liga ka shpenzuar disa vite për mbrojtjen me tri qendra. Ekipet atje po e përdorin gjithnjë e më shumë atë. Çëllsi i Kontes fitoi titullin me atë skemë dhe shumë prej tyre e panë si model atje. Venger, Guardiola, Murinjo, apo Kuman e kanë përdorur gjatë këtij sezoni. Dhe tani ekipi i Anglisë do të luajë, gjithashtu, me tri qendra në Kupën e Botës. “Kjo na lejon për të dhënë më shumë liri për lojtarët sulmues, ndaj mund të përdorim

mbrojtjen me tre, ose pesë, në varësi të gjendjes së lojës. Në të kaluarën ka pasur takime me shumë posedim, si kundër Islandës në Evropian, ku kemi humbur. Tani kemi më shumë gjerësi në anët kundër ekipeve që janë të mbyllura”, – shpjegoi Geri Kejhill për këtë çështje, një nga tri qendrat e prapavijës së Anglisë, bashkë me Stones dhe Ualker. Pikërisht, rasti i Ualker është i mrekullueshëm. Nga ana e djathtë

te Mançester Siti, tani luan në pozicionin e qendrës. “Nuk është një situatë e vështirë, por e çuditshme, – shpjegon Ualker. – Unë kam punuar gjithë jetën time për të shkuar në një Kupë Bote, si anësor i djathtë, mbrapa, kështu që kjo është diçka e re. Për vite me radhë nuk do të kisha luajtur në këtë pozicion, por Guardiola më ka mësuar shumë”, – përfundon ai. Në 10 ndeshjet e fundit, të luajtura nën drejtimin e trajnerit Gareth Saut-



gejt, Anglia ka pësuar vetëm tre gola. Përveç kësaj, “Tre Luanët” e mbajtën portën të paprekur edhe

ndaj Brazilit dhe Gjermanisë, dy favoritë për titullin në Rusi, si dhe nuk kanë humbur për një vit.

Brazili nuk di të dështojë, pas tyre vjen Italia



Islanda dhe Panamaja do të bëhen në Rusi, kësaj vere, vendet numër 85 dhe 86, që marrin pjesë në një fazë finale të Kupës së Botës në futboll. Për Brazilin, nga ana tjetër, do të jetë pjesëmarrja e tij e 21-të. Ose, çfarë është e njëjtë: është i vetmi vend, që ka qenë i pranishëm në të gjithë Botërorët e deritanishëm, që nga i pari, në vitin 1930. Nuk ka dështuar as edhe një herë për t'u kualifikuar në fazën finale të këtij kompeticioni madhor global. Është logjike atëherë, se “Selecao” drejton praktikisht të gjitha klasifikimet historike, duke filluar numri më i shumtë i fitoreve dhe golave të shënuar, deri te 5 tituj gjithsej. Pas brazilianëve vjen Italia, me 18 pjesëmarrje në Botëror, që nuk merr pjesë në “Rusia 2018”, sepse u eliminua në ditën e fundit të fazës kualifikuese, pas një barazimi 0-0 ndaj Suedisë. E treta është Argjentina, me 17 Botërorë të luajtur, dhe si vijon: Meksika (16), Spanja, Anglia dhe Franca (15). Lista e kombëtareve me 10 ose më shumë pjesëmarrje në Kupën e Botës mbyllet nga SHBA dhe Koreja e Jugut. Nga kjo listë, kësaj vere do të mungojë, përveç Italisë, edhe SHBA.

LISTA E KOMBËTAREVE ME MË SHUMË PJESËMARRJE NË BOTËROR:

BRAZILI	20 BOTËRORË
ITALI	18
ARGJENTINA	17
MEKSIKA	16
SPANJA	15
ANGLIA	15
URUGUAI	13
BELGJIKA	13
SUEDIA	12
GJERMANIA P.	11
ZVICRA	11
SHBA	10
KOREJA E JUGUT	10

DASHI 21. mars - 20. prill
Nuk duhet të ngrini zërin për t'ju dëgjuar të gjithë kur komunikoni me partnerin/en. Jini të qetë dhe të vendosur kur flisni. Beqarët pa u lodhur fare do e gjejnë princin e tyre të kaltër dhe do fillojnë një lidhje. Në planin financiar kënaquni me aq para sa do keni.

DEMI 21. prill - 21. maj
Do të jeni shumë falënderues dhe të kuptueshëm me personin që doni dhe kjo do t'ju lejojë të kaloni një fazë të kënaqshme, të pasur me pasion dhe erotizëm. Beqarëve do ju duhet të kërkojnë për personin ideal. Në planin financiar vështirësitë do jenë të mëdha.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Objektivat tuaja në marrëdhënien në çift do t'i arrihen me shumë lehtësi. Vetëm këshillohet që në dashuri të jeni shumë të sinqertë për të qenë mirë. Beqarët më mirë t'i marrin gjerat si t'iu vijjnë. Në planin financiar do jetë ditë e paqëndrueshme.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Lajme të reja do t'ju vijjnë me postë. Sqaroheni menjëherë një problem që keni me partnerin/en, sepse përndryshe gjërat mund të ndërlikohen. Beqarët do kenë një ditë premtuese dhe mund të hedhin themelet e një lidhjeje. Financat për fat të keq nuk do jenë shumë të mira.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Marrëdhëniet me partnerin/en do të jenë shumë të mira. Venera do t'ju bëjë tërheqës. Kujdesuni më shumë për njeriun tuaj të zemrës. Beqarët do kenë takime nga të cilat mund t'ju ndryshojë jeta. Në planin financiar duhet t'i bëni me kujdes llogaritë për shpenzime.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Raportet tuaja me partnerin/en nuk do të jenë shumë favorizuese sot. Mos prisni shumë nga ai/ajo dhe mësohuni të jeni më të kuptueshëm. Beqarët duhet të luftojnë fort në mënyrë që të gjejnë personin e ëndrrave. Financat nuk duhet t'i lini pas dore sepse mund të keni probleme.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Mos u entuziazmoni shumë kur t'ju bëhet një propozim pune, por përqendrohuni tek avantazhet konkrete. Kjo fazë do të jetë delikate edhe në marrëdhënien çift. Beqarët duhet të bëjnë atë që do ndiejnë pa menduar aspak se çfarë do ju thonë të tjerët. Buxheti do jetë delikat.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Një mbrëmje romantike për të dashuruarit e lindur në ditën e hënë dhe të mërkurë. Por bëni kujdes, mundohuni të jeni sa më të sinqertë me njeriun e zemrës. Beqarët nuk do jenë me fat në dashuri dhe do vazhdojnë të mbeten vetëm. Financat do jenë të qëndrueshme.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Nëse keni bërë fjalë me partnerin/en tuaj, sqarojini menjëherë keqkuptimet që ju kanë bërë jo tolerant dhe mjaft të irrituar. Situata që po jetoni është me të vërtetë e komplikuar. Beqarët nuk do e kenë të thjeshtë ta bëjnë për vete atë që pëlqejnë. Financat nuk do jenë shumë të mira.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Ndihmoni partnerin/en duke e dëgjuar, këshilluar, duke i qëndruar pranë. Kjo e mirë do t'ju kthehet një ditë, sepse edhe ju do ja ndjeni nevojën. Beqarët do jenë të kujdeshëm dhe do joshin personat e duhur. Financat do përmirësohen falë një menaxhimi të mirë.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Jupiteri ju fton që të përqendrohni në marrëdhënien tuaj në çift dhe garanton një sukses pothuajse të menjëhershëm, për aq kohë sa ju do të vini në përdorim inteligjencën. Beqarët nuk do jenë në humorin e duhur dhe do vazhdojnë të mbeten vetëm. Në planin financiar do përballemi me vështirësi.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Sot të lindurit në ditën e martë, të enjte dhe të shtunë do të jenë "hijerëndë" me partnerët e tyre. Dashuria duket se është venitur dhe çdo arsye është e "mirë"... për t'u grindur. Beqarët do vazhdojnë ende të jenë në kërkim të shpirtit të tyre binjak.

Mensur Mamuti	FUTBOLLISTI BRAZILIAN NË FOTO	ISH KLUBI I FUTBOLLISTIT NË FOTO	FËLLIQET, NDYHET	Ë. I.	TEMPERATURA
FINLANDEZËT					
BASHKIM QELIZASH TË NËLLOJTA (SHQ.)					VENDLINDJA E FUTBOLLISTIT NË FOTO
ZËRI I ULËT I GRAVE (MUJ.)					
A				BORI ERA E KEQE, GRAHMA	
I ETSHËM					
ANA E MËPREHTË E THIKËS					
ENERGJIA		KËNGËTARJA ANGLEZE, KETI DRU I VISEVE MESDHEITARE			
KILO BAJT			PËRËMËR VETOR ART (FRENGJ.)		
NDËRTIM MBI UJË				LITRI ISH KLUBI I FUTBOLLISTIT NË FOTO	
LLOJ GJELLE QË BËHET ME LLOJË TË NDRYSHME					NË NJË NGYJËSITË E ZODIAKUT (DASHI) ISH KLUBI I FUTB. NË FOTO, ... DA GAMA FITUESJA UKRAINA-SE E EUROVISIONIT
E PANJUHURA E PARE				QË LIDHET ME ARABET INTERNET RELAY CHAT	V BELGJIKA ISH KLUBI I FUTBOLLISTIT NË FOTO
NJËSI ADMINISTRATIVE			MIKROORGANIZËM QË SHKAKTON SEMUNDJE NGJITËSE QYTET NË PREVEZË		SUEDIA GRUAJA E XHON LENONIT, JOKO
OZONI		APARAT VROJTUES KAFSHË SHTEPIAKE (SH.)			
KOHA	KLUBI I FUTB. NË FOTO VEGËL GJIMNASTIKORE				
MARRE				NDAJFOLJE SASIE	O. NJ. A. P.
EMËRTIMI LATIN I REPUBLIKËS SË DUBROVNIKUT, RESPUBLICA...					OKSIGJENI ENERGJIA
ISH FUTBOLLISTI ARGJENTINAS, RUBEN				THIRRJE	



ZGJIDHJET: FINËT, INDI, ALTO, B, I ETUR, PRESA, E, TIZ, KB, AI, URA, L, TURLIY, IKSI, ARABE, NJA, VIRUS, S, O, PERISKOP, BARCELONA, TURP, SA, ONJ, RAGUSINA, O, AJALA, APEL.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

7					4	9				2		6		8	
						3	5			7	4	5			
5				3	8								7		6
		6	3		2	5			2	9		8		6	4
2									7		6		5	1	2
			1		7					8	5		6		3
3				5	9					4		8			
1	4											6	5	4	
		5	2				3		9		3	8		9	

Shumë i lehtë: 723615498, 698274135, 514938672, 976382541, 231459867, 485167923, 367591284, 149823756, 852746319. Mesatar: 749236185, 186745293, 523918746, 291387564, 364591827, 857462931, 478123659, 912654378, 635879412.

ÇUDISIN ARABËT, PRODHOJNË AEROPLANË PA DRITARE



Emirates Airlines po projekton aeroplanët e parë pa dritare. Në vend të dritareve, kjo kompani do të vendos kranet digjitale me të cilat do të tregoi pamjen e jashtme

të xhiruara live nga kamerat me fibra optike. Këto kamera do iu japin ndjenjat se jeni duke shikuar në dritare normale. Avionët pa dritare po shihen nga kompania si zgjidhje

edhe për ndotjen më të vogël të ajrit. Presidenti i Emirateve, Tim Klark ka thënë se aeroplanët pa dritare do të jenë në të gjitha linjat ajrore në të ardhmen e afërt.



Vëllai më i madh "ushqen" beben me vida

Një bebe pothuajse vdiq pasi vëllai i tij më i madh e ushqeu me tre vida metalike, kur iu la atij për mbikëqyrje. Mjekët duhej të bënin një endoskopi të rrezikshme në stomakun e foshnjës 37 ditëshe për të hequr objektet e huaja në Spitalin e Fëmijëve Zhengzhou në Kinë. Sipas nënës së djalit, pasi foshnja filloi të shkumojë në gojë, vëllai trevjeçar pranoi se i kishte dhënë vida. Doktor Li Xiaojin, kreu i gastroenterologjisë në spitalin e Provincës Henan të Kinës Qendrore, tha se refuzoi të kryente procedurën komplekse. Djali i vogël u transferua pastaj në kryeqytetin provincial të Zhengzhou, ku një ekip i vogël ekspertësh vendosën të punonin për shpëtimin e jetës së tij. Ata përdorën një gastroscope dhe një magnet për të rinxjerrë tre vida, të cilat ishin mbërthyer në stomakun e djalit.

Nuk është paranojë, celulari juaj dëgjon gjithçka që flisni

Ju nuk jeni paranojak, smartphone juaj me të vërtetë po ju dëgjon, kanë paralajmëruar ekspertët. Për vite me radhë përdoruesit e smartphone janë ankuar për ndjesinë që iu duket sikur aparati i tyre po regjistron çdo fjalë të tyre, madje edhe kur është në xhepin e tyre. Shumë prej përdoruesve kanë histori të ngjashme: Ata po bisedonin rreth një produkti ose pushime me miqtë dhe brenda pak kohësh panë një reklamë me të njëjtën temë të shfaqej në aplikacionet e tyre. Sipas një studiuesi, këto reklama të çuditshme nuk janë thjesht rastësi dhe telefoni juaj dëgjon rregullisht atë që thoni. Nuk dihet saktësisht se çfarë synon teknologjia nëpërmjet kësaj praktike, por

studiuesit pretendojnë se kjo teknikë është tërësisht e legjitime. Shumica e smartphone moderne janë të ngarkuara me aplikacione të cilat marrin komanda nëpërmjet zërit, si "Hey Siri" ose "Ok Google". Këto modele smartphone vazhdimisht dëgjojnë për fjalën ose frazën e caktuar dhe gjithçka tjetër. Megjithatë, një studiues pohon se fjalë kyçe dhe fraza të marra nga këto aplikacione mund të arrihen nga aplikacionet e tjera, si Instagram dhe Twitter. Kjo do të thotë se nëse ju bisedoni për një palë xhinse të reja ose bëni plane për pushime në Senegal, aplikacionet mund të t'ju sugjerojnë ju reklama për rroba dhe oferta mbi fluturimet.



Urdhri bëhet ligj! Franca ndalon celularët në shkolla



Urdhri bëhet ligj! Franca vendos të ndalojë përfundimisht telefonat celularë në shkollat fillore dhe tetë vjeçare. Ligji do të

aplikohet në fillim të vitit të ri shkollor. Asambleja Kombëtare e aprovoi propozimin e prezantuar nga maxhoranca qeveri-

tare, ndërkohë që opozita e kontestoi duke e cilësuar si të padobishëm dhe ndërmerret për publicitet. Ligji i ri parashikon ndalimin e përdorimit të telefonave celularë, përjashtohen rastet kur ato do të përdoren për qëllime pedagogjike. Deri më sot ishte në fuqi Kodi i Arsimit, sipas të cilit, që nga vitit 2010 ndalonte përdorimin e celularëve gjatë aktiviteteve të mësimin, por në përgjigje të kritikave të ngritura nga opozita, Ministri i Arsimit, Jean-Michel Blanquer ka mbrojtur idenë dhe nevojën e një baze ligjore më solide për të arritur qëllimin. Qeveria e ka quajtur ligjin e ri si një sinjal për mbarë shoqërinë.

1442 - Mbreti Alfonso V i Aragonisë okupon Napolin.

1714 - Prusia dhe Rusia nënshkruajnë marrëveshje të fshehtë.

1812 - Napoleoni pushton Rusinë.

1830 - Fillimi i kolonizimit francez të Algjerisë: 34,000 ushtarë francez zbarkojnë 27 km në perëndim të Algjerisë në Sidi Ferruh.

1839 - Luhet loja e parë e bejsbollit në SHBA.

1860 - Themelohet Banka Shtetërore e Perandorisë Ruse.

1867 - Themelohet Perandoria e Austro-Hungarisë

1942 - Hitleri urdhëron robërimin e popujve sllav.

1964 - Nelson Mandela dënohet me burg të përjetshëm në Afrikën e Jugut.

1967 - Izraeli fiton luftën gjashtë ditore.

1991 - Boris Jelcin zgjedhet kryetar i Federatës Ruse.

1999 - Lufta e Kosovës: Fillon Operacioni i Përbashkët i Mbrojtjes - trupat e NATO-s (KFOR) futen në Kosovë.

Çaji jeshil mund të jetë një aleat i rëndësishëm në shëndetin e zemrës. Kjo pasi ai është një antioksidant që mund të arrijë të shkrijë të gjitha yndyrat e grumbulluara në enët e gjakut. Sipas universitetit Lancaster, që ka publikuar studimin në revistën shkencore mbi Biologjikë Kimike, është një substancë e pranshme në gjethet e çajit jeshil, EGCG, që ka treguar se vepron mbi mbledhjet proteinike në enët e gjakut. Gjithashtu po kjo substancë është në studim edhe për një veprim pozitiv edhe mbi sëmundjen degenerative cerebrale të Alzheimer. Kjo proteinë, kur bie në veprim me një substancë të organizmit, eparinën, vepron pikërisht si shkrirës më i fortë ndaj yndyrave të këqija që janë të dëmshme për zemrën.



KOKOA DHE GRUAJA

- Grua, sot isha te mjeku. Ma fotografuan kokën, por nuk gjetën asgjë! - iu drejtua burri gruas.
- Këtë edhe e kam pritur! - i përgjigjet gruaja.



Kur i kulturuari hesht nga edukata, injoranti mendon se e la pa fjalë! (DINO SESSA)



KALENDARI HISTORIK 8 QERSHOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS